

MBROJTJA E SË DREJTËS PËR LIRINË E SHPREHJES SIPAS KONVENTËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT



Manual për praktikantët e ligjit

Dominika Bychawska-Siniarska

Reinforcing Judicial Expertise on Freedom of Expression and the Media in South-East Europe (JUFREX)

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

**MBROJTJA E SË DREJTËS
PËR LIRINË E SHPREHJES SIPAS
KONVENTËS EUROPIANE PËR TË
DREJTAT E NJERIUT**

**Manual për
praktikantët e ligjit**

Dominika Bychawska-Siniarska

Këshilli i Europës

Mendimet e shprehura në këtë punim janë të autorit dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Europës.

Të gjitha kërkesat në lidhje me riprodhimin ose përkthimin e këtij dokumenti ose një pjese të tij duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Komunikimit (F-67075 Strasburg Cedex ose publishing@coe.int). E gjithë korrespondenca tjetër në lidhje me këtë publikim duhet t'i drejtohet Divizionit për Zbatimin e Brendshëm të të Drejtave të Njeriut, Departamentit të Bashkëpunimit dhe Politikave për të Drejtat e Njeriut dhe Drejtorisë së të Drejtave të Njeriut, Drejtorisë së Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut dhe Shtetin Ligjor.

Versioni shqip u publikua në kuadër të programit të përbashkët të Bashkimit Europian dhe Këshillit të Europës, "Përforcimi i ekspertizës gjyqësore për lirinë e shprehjes dhe medias në Europën Juglindore (JUFREX)"

Dizajni dhe formatimi i kopertinës:
Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve dhe Publikimeve (DNDP),
Këshilli i Europës

Foto e kopertinës: Shutterstock

Përktheu: Koço BENDO
Redaktoi: Anila HARUNI
Botues: Onufri
Web: www.onufri.com
E-mail: onufribotime@gmail.com
Tiranë, 2018

©Këshilli i Europës, shtator 2018

Jeni të interesuar për të mësuar më shumë në lidhje me të drejtat e njeriut? Jeni të lutur të vizitoni faqen e internetit të Programit Europian për të Drejtat e Njeriut Edukimi Ligjor për Profesionistët e së Drejtës (HELP):

www.coe.int/help

Për më shumë informacion rreth Lirisë së Shprehjes dhe KEDNJ-së, shihni kursin online HELP:

<http://www.coe.int/en/web/help/help-training-platform>

www.coe.int/nationalimplementation

Përmbajtja

| | |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| RRETH AUTORIT | 5 |
| NENI 10 – LIRIA E SHPREHJES | 7 |
| HYRJE | 9 |
| KAPITULLI 1 – MENDIME TË PËRGJITHSHME PËR NENIN 10 | 11 |
| 1.1. Liria e mendimit | 13 |
| 1.2. Liria për të dhënë informacione dhe ide | 13 |
| 1.3. Liria për të marrë informacione dhe ide | 15 |
| 1.4. Aksesimi në informacion | 15 |
| 1.5. Llojet e mbrojtura të shprehjes | 17 |
| KAPITULLI 2 – DETYRIMET SIPAS NENIT 10 | 19 |
| KAPITULLI 3 – GJUHA E PAMBROJTUR – GJUHA E URREJTJES, NËNITJA E DHUNËS | 23 |
| 3.1. Nxitja e dhunës | 23 |
| 3.2. Gjuha e urrejtjes dhe racizmi | 25 |
| 3.3. Mohimi i holokaustit dhe referencat tek ideologjia naziste | 27 |
| KAPITULLI 4 – SISTEMI I KUFIZIMEVE BRENDA USHTRIMIT TË SË DREJTËS SË LIRISË SË SHPREHJES - PARAGRAFI I DYTË | 31 |
| 4.1. Kufizimet e lejuara | 31 |
| 4.2. Testi me tri pjesë | 32 |
| 4.3. Ndërhyrja në ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes | 33 |
| 4.4. Parashikuar me ligj | 39 |
| 4.5. Qëllimi legjitim | 43 |
| 4.6. I nevojshëm në një shoqëri demokratike | 44 |
| KAPITULLI 5 – KUFIZIMET PËR SHKAQE “PUBLIKE” | 47 |
| 5.1. Liria e shprehjes dhe siguria kombëtare | 47 |
| 5.2. Liria e shprehjes dhe integriteti territorial | 55 |
| 5.3. Liria e shprehjes dhe parandalimi i trazirave | 57 |
| 5.4. Liria e shprehjes dhe morali | 59 |
| NENI 6 – LIRIA E SHPREHJES DHE REPUTACIONI | 63 |
| 6.1. Reputacioni i figurave publike | 63 |
| 6.2. Kritikkat ndaj politikanëve | 64 |
| 6.3. Zyrtarët dhe drejtuesit e lartë të Shërbimit Civil | 66 |
| 6.4. Kritikkat ndaj subjekteve tregtare | 71 |
| 6.5. Mbrojtja e të miturve | 72 |
| 6.6. Autoriteti dhe paanësia e gjyqësorit | 72 |
| 6.7. Natyra e të shprehurit | 75 |

| | |
|-------------------------------------------------------------------|------------|
| 6.8. Dallimi ndërmjet fakteve dhe opinioneve | 77 |
| 6.9. Mirëbesimi dhe kujdesi i duhur | 89 |
| 6.10. Sanksionet | 80 |
| KAPITULLI 7 – TË DREJTAT E TË TJERËVE | 83 |
| KAPITULLI 8 – LIRIA E SHPREHJES DHE MEDIA | 87 |
| 8.1. Liria e shtypit | 87 |
| 8.2. Detyrimet e shtetit dhe mbrojtja e gazetarëve | 90 |
| 8.3. Liria e transmetimit radioteleviziv | 93 |
| 8.4. Detyrimet dhe përgjegjësitë e gazetarëve | 97 |
| 8.5. Mbrojtja e burimeve të gazetarëve | 99 |
| 8.6. Mbrojtja e sinjalizuesve | 102 |
| KAPITULLI 9 – LIRIA E SHPREHJES DHE TEKNOLOGJITË E REJA | 105 |
| 9.1. Mbikëqyrja elektronike | 105 |
| 9.2. Mendime të përgjithshme mbi lirinë e shprehjes dhe interneti | 106 |
| 9.3. Bllokimi i aksesit | 107 |
| 9.4. E drejta e aksesit në internet | 108 |
| 9.5. Arkivat në internet | 109 |
| 9.6. Përgjegjësia për përmbajtjen e gjeneruar nga përdoruesit | 110 |
| INDEKSI I ÇËSHTJEVE | 113 |

Rreth autorit

Dominika Bychawska-Siniarska është avokate për të drejtat e njeriut, e specializuar në lirinë e shprehjes në Poloni, Europën Qendrore e Lindore; anëtare e Bordit të Fondacionit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe Rrjetit European për Zbatim. Ajo është drejtoreshë e Observatorit të Lirisë së Medias në Poloni, një prej projekteve kryesore të Fondacionit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. Në vitin 2013, ka marrë Çmimin e Gazetarëve të nenit 54 nga Shoqata Polake e Gazetarëve për angazhimin e saj në nxitjen e standardeve të lirisë së shprehjes. Ajo gjithashtu ofron trajnime mbi lirinë e shprehjes në Programin European për të Drejtat e Njeriut Edukimi Ligjor për Profesionistët e së Drejtës (HELP). Dominika Bychawska-Siniarska ka punuar si konsulente në projektin e përbashkët të Bashkimit European dhe Këshillit të Europës për Fuqizimin e Kapacitetit të Gjyqësorit Turk mbi Lirinë e Shprehjes. Ka shkruar artikuj të shumtë akademikë dhe publicistikë për të drejtat e njeriut dhe Sistemin e Mbrojtjes së Këshillit të Europës. Ajo shkruan gjithashtu një kolonë të përvajshme mbi vendimet e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në *“Dziennik Gazeta Prawna”*.

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut **Neni 10 – Liria e shprehjes**

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të transmetimeve kinematografike ose televizive.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

Hyrje

Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore - Konventa për të Drejtat e Njeriut - është forma më e rëndësishme e shprehjes së angazhimit të shteteve anëtare të Këshillit të Europës për vlerat e demokra-cisë, paqes dhe drejtësisë dhe nëpërmjet tyre, për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të individëve që jetojnë në këto shoqëri¹.

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa) u nënshkrua më 4 nëntor 1950, në Romë. Gjatë 50 viteve të fundit Konventa është zhvilluar, si nëpërmjet interpretimit të teksteve të saj nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Gjykata), nga Komisioni European për të Drejtat e Njeriut (Komi-sioni)² dhe nëpërmjet punës së Këshillit të Europës. Ky i fundit ka miratuar protokolle që kanë zgjeruar objektin e Konventës, rezoluta dhe rekomandime drejtuar shteteve anëtare që kanë zhvilluar dhe propozuar standarde sjelljeje dhe ka vendosur sanksione për ato shtete që nuk kanë përmbushur dispozitat e Konventës.

Pothuaj të gjitha shtetet palë në Konventë e kanë përfshirë atë në legjislacionin e tyre të brendshëm. Konventa në këtë mënyrë është pjesë e sistemit të brendshëm ligjor dhe detyruese për gjykatat vendase dhe të gjitha auto-ritetet publike. Ajo vijon më tej, që të gjithë individët në shtetet përkatëse marrin të drejta dhe detyrime nga Konventa, në mënyrë që në procedurat e brendshme shtetet mund t'i referohen drejtpërdrejt tekstit të saj dhe prak-tikës ligjore, e cila duhet të zbatohet nga gjykatat e brendshme. Për më tepër, autoritetet e brendshme, duke përfshirë gjykatat, duhet t'i japin prioritet Kon-ventës përkundrejt çdo ligji të brendshëm në konflikt me Konventën dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës.

¹ *Hyrje në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut - Përmbledhje tekstesh, Botim i Këshillit të Europës, Strasburg, 1994.*

² Në pajtim me Protokollin nr. 11, që ka hyrë në fuqi më 1 nëntor 1998, Komisioni European për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut u bashkuan së bashku për të formuar një organ të vetëm, Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Teksti i Konventës nuk mund të lexohet i shkëputur nga praktika gjyqësore e Gjykatës. Konventa funksionon brenda sistemit *common law*. Vendimet e Gjykatës shpjegojnë dhe interpretojnë tekstin. Ato janë precedentë detyrues, statusi ligjor i të cilëve është ai i normave ligjore detyruese. Kështu, pas mira-timit të Konventës, autoritetet e brendshme të të gjitha shteteve nënshkruese, duke përfshirë ato që zbatojnë sistemin juridik kontinental, duhet t'i kon-siderojnë vendimet e Gjykatës legjisacion detyrues. Ky është shkaku që teksti i këtij manuali do t'i referohet gjerësisht praktikës gjyqësore të Gjykatës. Në këtë aspekt, duhet kuptuar që në ditët e sotme, edhe sistemet tradicionalisht ligjore kontinentale, zbatojnë një sistem të përzier të së drejtës *common law* dhe asaj kontinentale, ku praktikës gjyqësore i jepet vlerë e barabartë me atë të ligjeve të miratuara nga parlamenti.

Interpretimi i tekstit të Konventës është dinamik dhe evolues, duke e bërë Konventën një instrument të gjallë, që duhet të interpretohet duke pasur parasysh kushtet e ditëve të sotme. Për pasojë, Gjykata është (dhe duhet të jetë) e ndikuar nga zhvillimet dhe standardet gjerësisht të pranuar në shtetet anëtare të Këshillit të Europës.

Skema e përgjithshme e Konventës është që përgjegjësia parësore dhe fille-stare për mbrojtjen e të drejtave të parashikuara në të u takon shteteve kontraktore. Gjykata është për të mbikëqyrur veprimet e shteteve me anë të ushtrimit të kompetencës së kontrollit. Hapësira e vlerësimit të brendshëm në këtë mënyrë shkon paralelisht me mbikëqyrjen europiane. Dok-trina e hapë-sirës së vlerësimit zbatohet në mënyra të ndryshme dhe shkalla e diskrecionit që u jepet shteteve është e ndryshme në bazë të kontekstit. Një shteti i lejohet një shkallë e lartë diskrecioni në rastet e emergjencave publike, që dalin në pajtim me nenin 15 ose aty ku ka pak bazë të përbashkët ndërmjet shteteve kontraktore, ndërsa diskrecioni shuhet pothuaj në pikën zero në raste të tilla kur bëhet fjalë për mbrojtjen e lirisë së shprehjes.

Ky manual synon të ndihmojë gjyqtarët, prokurorët, avokatët dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut në të gjitha nivelet, për të garantuar që të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes të trajtohen në pajtim me detyrimet e shteteve sipas nenit 10 të Konventës, siç është e zhvilluar nga Gjykata e Strasburgut.

Kapitulli 1

Mendime të përgjithshme për nenin 10

Në kontekstin e një demokracie të efektshme dhe respektimit të të drejtave të njeriut të përmendura në preambulën e Konventës, liria e shprehjes është jo vetëm tepër e rëndësishme si një e drejtë, por ajo luan një rol kyç në mbrojtjen e të drejtave të tjera sipas Konventës. Pa një garanci të gjerë të së drejtës së lirisë së shprehjes të mbrojtur nga gjykata të pavarura dhe të paanshme, nuk ka vend të lirë, nuk ka demokraci. Ky deklaram i përgjithshëm është i padisku-tueshëm³.

Liria e shprehjes është një e drejtë në vetvete si dhe një përbërëse e të drejtave të tjera të mbrojtura sipas Konventës, si liria e tubimit. Në të njëjtën kohë, liria e shprehjes mund të bjerë në konflikt me të drejta të tjera të mbrojtura nga Konventa, si e drejta për një gjykim të drejtë, e drejta e respektimit të jetës private, e drejta e ndërgjegjes dhe fesë. Konflikti mund të lindë nëse autoriteteve u duhet të mbrojnë interesat ose vlerat e renditura në nenin 10, paragrafi 2 i Konventës, si siguria publike ose shëndeti publik. Nëse ndodh një përplasje e tillë, Gjykata gjen një baraspeshim me qëllim që të vendosë prioritetin e një të drejte ndaj një tjetre. Baraspeshimi i interesave konfliktuese, një prej të cilave është liria e shprehjes, merr parasysh rëndësinë e kësaj të fundit. Gjykata vazhdimisht është shprehur që liria e shprehjes “përbën një prej themeleve kryesore të një shoqërie demokratike dhe një prej kushteve bazë për përparimin e saj dhe të vetërealizimit⁴ të çdo individi”. Ose, “shtypi luan një rol parësor në një shtet të qeverisur sipas parimeve të shtetit ligjor”⁵.

³ Jochen Abr. Frowein, “Liria e shprehjes sipas Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut”, te Monitor/Inf (97) 3, Këshilli i Europës.

⁴ *Lingens kundër Austrisë*, 8 korrik 1986; *Şener kundër Turqisë*, 18 korrik 2000; *Thoma kundër Luksemburgut* 29 mars 2001; *Marônek kundër Sllovakisë*, 19 prill 2001; *Dichand dhe të Tjerë kundër Austrisë*, 26 shkurt 2002.

⁵ *Castells kundër Spanjës*, 23 prill 1992; *Prager dhe Oberschlick kundër Austrisë*, 26 prill 1995.

Mbrojtja e lirisë së shprehjes është thelbësore për procesin politik demokratik dhe zhvillimin e çdo qenieje njerëzore. Si çështje parimore, mbrojtja e dhënë nga neni 10 përfshin çdo shprehje, pavarësisht përmbajtjes së saj, të bërë nga çdo individ, grup ose kategori e medias. I vetmi kufizim përsa i takon përmbajtjes i zbatuar nga Gjykata ka të bëjë me përhapjen e ideve që nxisin racizmin dhe ideologjinë naziste, mohojnë holokaustin dhe nxitjen e urrejtjes dhe diskriminimit racial. Gjykata u mbështet në nenin 17 të Konventës dhe u shpreh se liria e shprehjes nuk mund të përdoret për të çuar në shkatërrimin e të drejtave dhe lirive të dhëna nga Konventa⁶. Këto vendime zbatojnë teorinë e paradoksit të tolerancës: një tolerancë absolute mund të çojë në tolerancën e ideve që nxisin mostolerancë dhe kjo e fundit mund të asgjësojë tolerancën.

Shtetet janë të detyruara të justifikojnë çdo ndërhyrje në çdo lloj shprehje. Me qëllim që të vendoset masa në të cilën duhet të mbrohet një formë e caktuar e shprehjes, Gjykata shqyrton llojin e shprehjes (politike, tregtare, artistike etj.), mjetet nëpërmjet të cilave realizohet shprehja (personale, media e shkruar, televizioni etj.) dhe audiencën e saj (të rritur, fëmijë, publik i gjerë, një grup i caktuar). Edhe “e vërteta” e shprehjes ka një kuptim të ndryshëm sipas këtyre kriterëve.

Gjykata e Strasburgut, në procesin e marrjes së vendimeve, i ka kushtuar vëmendje praktikave të brendshme kushtetuese, duke përfshirë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që ofrojnë një nivel të lartë të mbrojtjes së lirisë së shprehjes. Megjithatë, vendimet e brendshme - edhe ato me fuqi ligjore - kanë një përdorim të kufizuar për një organ ndërkombëtar siç është Gjykata, që zbaton dhe interpreton një traktat ndërkombëtar. Në disa raste, Komisioni dhe Gjykata i janë referuar Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike⁷ ose dokumenteve të tjera ndërkombëtare që mbrojnë lirinë e shprehjes.

Neni 10 i Konventës është i strukturuar në dy paragrafë:

- paragrafi i parë përkufizon liritë e mbrojtura;
- i dyti përcakton rrethanat në të cilat një shtet në mënyrë të legjitimuar mund të ndërhyjë tek ushtrimi i lirisë së shprehjes.

Neni 10, paragrafi 1:

Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i

⁶ *Garaudy kundër Francës*, 24 qershor 2003 (vendim).

⁷ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Konventa Ndërkombëtare e të Drejtave Civile dhe Politike, 16 dhjetor 1996 (hyrja në fuqi, 2 mars 1976).

ndalon shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve audiovizive, kinematografike ose televizive të transmetimit.

Kështu, paragrafi 1 parashikon tre komponentë të së drejtës së lirisë së shprehjes:

- Liria e mendimit;
- Liria për të marrë informacion dhe ide, dhe
- Liria për të dhënë informacion dhe ide.

Këto liri duhet të ushtrohen lirisht, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike⁸ dhe pavarësisht kufijve.

1.1. Liria e mendimit

Liria e mendimit është një parakusht për liritë e tjera të garantuara nga neni 10 dhe ajo gëzon një mbrojtje pothuajse absolute në kuptimin që kufizimet e mundshme të parashikuara në paragrafin 2 janë të pazbatueshme. Siç është theksuar nga Komiteti i Ministrave, “çdo kufizim i kësaj të drejte do të jetë në papajtueshmëri me natyrën e një shoqërie demokratike”⁹.

Shtetet nuk duhet të përpiqen të indoktrinojnë qytetarët e tyre dhe nuk duhet të lejohen të bëjnë dallim ndërmjet individëve që kanë një mendim apo një tjetër. Për më tepër, nxitja e informacionit të njëanshëm nga shteti mund të përbëjë një pengesë të rëndë dhe të papranueshme për lirinë e mendimit.

Në bazë të lirisë së mendimit, individët janë të mbrojtur edhe ndaj pasojave të mundshme negative në rastet kur atyre u atribuohen opinione të posaçme në vijim të shprehjeve të mëparshme publike. Liria e mendimit përfshin “lirinë negative” për të mos u detyruar për të komunikuar mendimet e veta¹⁰.

1.2. Liria për të dhënë informacion dhe ide

Liria për të dhënë informacion dhe ide është e një rëndësie të veçantë për jetën politike dhe strukturën demokratike të një vendi. Zgjedhjet e lira dhe të përshtatshme nuk mund të mbahen në mungesë të kësaj lirie. Për më tepër, një ushtrim i plotë i lirisë për të dhënë informacion dhe ide lejon kritikën e lirë të qeverisë, që është treguesi kryesor i një shoqërie të lirë dhe demokratike. Ashtu siç theksoi Gjykata që në vitin 1976:

⁸ Përveç sipas kërkesave të paragrafit 2.

⁹ Raport i Këshillit të Ministrave, në *“Teoria dhe praktika e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut”*, P. Van Dijk dhe G. Van Hoof, Kluwer, 1990, f. 413.

¹⁰ *Vogt kundër Gjermanisë*, 26 shtator 1995.

funkcionet e saj mbikëqyrëse e detyrojnë atë t'u kushtojë vëmendje të madhe parimeve që karakterizojnë një "shoqëri demokratike". Liria e shprehjes përbën një nga themelet kryesore të një shoqërie të tillë, një nga kushtet themelore për përparimin dhe për zhvillimin e çdo njeriu¹¹.

Liria për të kritikuar qeverinë është theksuar në mënyrë të veçantë nga Gjykata në vitin 1986: i takon shtypit "të japë informacion dhe ide për çështjet politike si për ato në fusha të tjera me interes publik. Jo vetëm që shtypi ka detyrën e dhënies së një informacioni dhe ideve të tilla: por edhe publiku ka gjithashtu të drejtën për t'i marrë ato"¹². Mesa duket, liria për të dhënë informacion dhe ide është plotësuese e lirisë për të marrë informacion dhe ide. Një gjë e tillë është e vërtetë në lidhje me medien e shkruar, si dhe me medien transmetuese. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata ka deklaruar se shtetet nuk mund të ndërhyjnë ndërmjet transmetuesit dhe marrësit, pasi këta kanë të drejtën të kenë kontakt të drejtpërdrejtë me njëri-tjetrin sipas vullnetit të tyre¹³.

Liria për të dhënë informacion dhe ide për çështjet ekonomike (e ashtu-quajtura e folura tregtare) është gjithashtu e garantuar sipas nenit 10. Megjithatë, Gjykata ka vendosur që në çështjet ekonomike autoritetet e brendshme të gëzojnë një hapësirë më të madhe vlerësimi¹⁴.

Krijimi dhe shfaqja artistike, si dhe përhapja e tyre konsiderohet nga Gjykata si një kontribut për shkëmbimin e ideve dhe mendimeve, një komponent thelbësor i një shoqërie demokratike. Duke theksuar se liria artistike dhe qarkullimi i lirë i artit kufizohen vetëm në shoqëritë jo-demokratike, Komisioni argumentoi:

nëpërmjet punës së tij krijuese, artisti shpreh jo vetëm një këndvështrim personal mbi botën, por gjithashtu edhe mendimin e tij për shoqërinë në të cilën jeton. Në këtë kuptim, arti jo vetëm ndihmon në formësimin e opinionit publik, por është gjithashtu një shprehje e tij dhe mund të ballafaqojë publikun me çështjet madhore të ditës¹⁵.

¹¹ *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 7 dhjetor 1976, paragrafi 49.

¹² *Lingens kundër Austrisë*, 8 korrik 1986, paragrafi 41; *Şener kundër Turqisë*, 18 korrik 2000; *Thoma kundër Luksemburgut*, 29 mars 2001; *Marônek kundër Sllovakisë*, 19 prill 2001; *Dichand dhe të Tjerë kundër Austrisë*, 26 shkurt 2002.

¹³ *Groppera Radio AG dhe të Tjerë kundër Zvicrës*, 28 mars 1990 dhe *Casado Coca kundër Spanjës*, 24 shkurt 1994.

¹⁴ *Marktintern Verlag Gmb Hand Klaus Beermann kundër Gjermanisë*, 20 nëntor 1989; *Krone Verlag GmbH&Co. KG kundër Austrisë* (Nr. 3), 11 dhjetor 2003, paragrafi 31.

¹⁵ *Müller dhe të Tjerë kundër Zvicrës*, 24 maj 1998, raport i Komisionit, paragrafi 70.

1.3. Liria për të marrë informacion dhe ide

Liria për të marrë informacion përfshin gjithashtu edhe të drejtën për të mblledhur dhe për të kërkuar informacione nëpërmjet të gjitha burimeve të mundshme të ligjshme. Liria për të marrë informacion mbulon gjithashtu programet televizive ndërkombëtare¹⁶.

Megjithëse liria për të marrë informacion dhe ide ka të bëjë me medien, për t'i mundësuar asaj përhapjen e këtij informacioni dhe ideve për publikun, Gjykata në këtë liri dallon të drejtën e publikut për t'u informuar në mënyrën e duhur, në mënyrë të veçantë për çështjet me interes publik.

1.4. Aksesit në informacion

Aksesit në informacion u zhvillua fillimisht në çështjet e lidhura me nenin 8, i cili kishte të bënte me problemet mjedisore¹⁷. Gjykata nuk e pranoi idenë e përfshirjes së aksesit në informacion në mbrojtjen e nenit 10. Në çështjen *Leander kundër Suedisë*, kërkuesi kërkoj informacion konfidencial nga dosjet zyrtare që i takonin qeverisë. Ai besonte se atij i ishte refuzuar një punë për shkak të informacionit që gjendej në dosjen përkatëse dhe donte ta kundërshtonte atë informacion. Gjykata vendosi se kërkuesi nuk gëzonte mbrojtje sipas nenit 10¹⁸.

Së fundmi, Gjykata ka interpretuar lirinë për të marrë informacion në mënyrë më të gjerë¹⁹. Në çështjen *Österreichische Vereinigung zur Erhaltung, Stärkung und Schaffung kundër Austrisë*²⁰, Gjykata shkoi drejt një interpretimi më të gjerë të konceptit të "lirisë së marrjes së informacionit", duke njohur një të drejtë për aksesin në informacion. Ndryshe nga qëndrimi i saj i mëparshëm, ajo konstatoi se refuzimi i aksesit të dokumentet e mbajtura nga autoritetet (Gjykata Kushtetuese) përbënte ndërhyrje tek e drejta e kërkuarit sipas nenit 10²¹. Një çështje tjetër e rëndësishme është *Youth Initiative for Human Rights kundër Serbisë*. Në këtë vendim, Gjykata theksoi përsëri se "liria për të marrë informacion" përfshin të drejtën e aksesit në informacion²².

¹⁶ *Autronic AG kundër Zvicrës*, 22 maj 1990.

¹⁷ *Gaskin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 7 korrik 1989.

¹⁸ *Leander kundër Suedisë*, 26 mars 1987.

¹⁹ *Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë*, 14 prill 2009, paragrafi 35.

²⁰ *Österreichische Vereinigung zur Erhaltung, Stärkung und Schaffung kundër Austrisë*, 28 nëntor 2013, paragrafi 41.

²¹ *Társaság a Szabadságjogokért*, cituar më sipër.

²² *Youth Initiative for Human Rights kundër Serbisë*, 25 qershor 2013. Aksesit në informacion përfshiu organizatat joqeveritare. Standardi u konfirmua të çështja *Österreichische Vereinigung zur Erhaltung, Stärkung und Schaffung kundër Austrisë*, 28 nëntor 2013.

Në çështjen *Kenedi kundër Hungarisë*, Gjykata unanimisht ishte e mendimit se kishte pasur shkelje të Konventës, për shkak të procedimit tepër të stërzgatur (mbi 10 vjet) gjatë të cilit kërkuesi kishte kërkuar të përfntonte dhe të realizonte aksesin e tij te dokumentet në lidhje me shërbimet sekrete hungareze. Gjykata gjithashtu përsëriti se “aksesi te burimet dokumentare origjinale për kërkime historike legjitime ishte një element thelbësor i ushtrimit të së drejtës së kërkuesit për të drejtën e shprehjes”²³. Gjykata vuri re se kërkuesi kishte marrë një vendim gjykate që i jepte atij akses te dokumentet në fjalë, dhe pas këtij gjykatat e brendshme kishin vendosur në mënyrë të përsëritur në favor të tij në procedimet pasuese të ekzekutimit. Megjithatë, autoritetet administrative kishin refuzuar në mënyrë të paepur përmbushjen e detyrimit për të respektuar vendimin e brendshëm, duke i penguar kështu kërkuesit aksesin në dokumentet që i duheshin për të shkruar studimin. Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet kishin vepruar në mënyrë arbitrare dhe në kundërshtim me ligjin e brendshëm. Ajo u shpreh, para së gjithash, se autoritetet kishin abuzuar me kompetencat e tyre duke vonuar ushtrimin nga kërkuesi të së drejtës së tij të lirisë së shprehjes, në shkelje të nenit 10.

Në çështjen *Roşianu kundër Rumanisë*, në të cilën kërkuesi ishte prezantues i një programi në një televizion rajonal, Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet rumune kishin shkelur nenin 10, duke refuzuar aksesin te dokumentet me natyrë publike që kërkuesi kishte kërkuar në Baia Mare, një qytet në veri të Rumanisë²⁴. Vendimi i Gjykatës sqaron se mekanizmat eficientë të ekzekutimit janë të nevojshëm për ta bërë praktike dhe efektive të drejtën e aksesit te dokumentet publike. Gjykata vuri re se z. *Roşianu* ishte i përfshirë në mbledhjen legjitime të informacionit për një çështje me rëndësi publike, siç janë aktivitetet e administratës bashkiake. Ajo u shpreh se duke pasur parasysh interesin e mbrojtur nga neni 10, ligji nuk mund të lejojë kufizime arbitrare, të cilat mund të bëhen një formë e censurës së tërthortë, nëse autoritetet krijojnë pengesa për mbledhjen e informacionit. Mbledhja e informacionit në gazetari është një hap thelbësor përgatitor dhe pjesë e brendshme, e mbrojtur e lirisë së shtypit. Duke ditur se synimi i gazetarit ishte komunikimi i informacionit në fjalë te publiku dhe në këtë mënyrë të kontribuonte në debatin publik për qeverisjen e mirë publike, e drejta e tij për dhënien e informacionit ishte cenuar qartazi. Gjykata konstatoi se nuk ka pasur ekzekutime të mjaftueshme të vendimeve gjyqësore në fjalë, duke i mundësuar gazetarit të ketë akses te dokumentet e kërkuara. Vihet re gjithashtu që kompleksiteti i informacionit të kërkuar dhe puna e konsiderueshme e bërë për të përzgjedhur ose përpiluar dokumentet e kërkuara ishin referuar si të vetmet

²³ *Kenedi kundër Hungarisë*, 26 maj 2009, paragrafi 43.

²⁴ *Roşianu kundër Rumanisë*, 24 qershor 2014.

për të shpjeguar pamundësinë e dhënies së atij informacioni shpejt, por nuk mund të ketë një argument të mjaftueshëm ose relevant për refuzimin e aksesit te dokumentet e kërkuara.

Edhe pse publiku ka të drejtën të marrë informacion me interes të përgjithshëm, neni 10 nuk garanton një të drejtë absolute aksesit të të gjitha dokumentet zyrtare²⁵. Megjithatë, pasi gjykata e brendshme lejon aksesin te dokumentet, autoritetet nuk mund të pengojnë ekzekutimin e urdhrimit të gjykatës. Në kontekstin e kërkimit historik, Gjykata ka konstatuar se aksesit te burimet dokumentare origjinale në arkivat e shtetit është një element thelbësor i ushtrimit të të drejtave sipas nenit 10²⁶. Gjykata u shpreh gjithashtu në favor të një gazetari, i cili donte të publikonte informacion për përdorimin e fondeve publike nga autoritetet bashkiake, duke theksuar se synimi i tij ishte të jepte një kontribut legjitim në debatin publik për qeverisjen e mirë²⁷.

Gjykata ka theksuar më tej rëndësinë e së drejtës për të marrë informacion nga individët privatë dhe subjektet juridike. Megjithëse njoftimet politike dhe sociale mund të jenë informacioni më i rëndësishëm i mbrojtur nga neni 10, liria për të marrë informacion nuk shtrihet vetëm te raportet e ngjarjeve me interes publik, por ajo përfshin gjithashtu shfaqjet kulturore dhe zbavitjen²⁸. Dhoma e Madhe ka theksuar rëndësinë e parimit të “shkëmbimit të lirë të mendimeve dhe ideve”²⁹.

1.5. Llojet e mbrojtura të shprehjes

“Shprehja” e mbrojtur sipas nenit 10 nuk është e kufizuar te fjalët, të folura apo të shkruara, por përfshin pamjet³⁰, imazhet³¹, veprimet³², madje edhe trashëgiminë³³ kulturore që synojnë të shprehin një ide ose të paraqesin informacion. Në rrethana të caktuara edhe veshja mund të përfshihet nën nenin 10³⁴. Gjykata nuk e ka përfshirë në praktikën e saj konceptin e “shprehjes simbolike”; megjithatë, sipas nenit 10, ajo mbron shfaqjen dhe përdorimin e

²⁵ *Sdružení Jihočeské Matky kundër Republikës Çeke*, 10 korrik 2006 (vetëm frëngjisht dhe çekisht), ku refuzimi i aksesit, i kërkuar nga një shoqatë mjedisore, te të dhënat teknike të ndërtimit të një impianti me fuqi bërthamore u konsiderua i justifikuar nga Gjykata.

²⁶ *Kenedi kundër Hungarisë*, 26 maj 2009.

²⁷ *Roşianu kundër Rumanisë*, 24 qershor 2014.

²⁸ *Khurshid Mustafa dhe Tarzibachi kundër Suedisë*, 16 dhjetor 2008.

²⁹ *Gillberg kundër Suedisë*, 3 prill 2012, paragrafi 95, (GC).

³⁰ *Müller dhe të Tjerë kundër Zvicrës*, 24 maj 1988.

³¹ *Chorherr kundër Austrisë*, 26 gusht 1993.

³² *Steel dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 23 shtator 1998.

³³ *Khurshid Mustafa dhe Tarzibachi kundër Suedisë*, 16 dhjetor 2008. Çështja ka të bëjë me dëbimin e qiramarrësve për shkak të refuzimit të tyre për heqjen e një antene satelitore që u lejonte të shihnin programe televizive në gjuhën arabe dhe farsi nga vendi i tyre i origjinës (Irak).

³⁴ *Stevens kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 9 shtator 1989 (vendim paraprak).

simboleve të ndryshme, si ylli i kuq në Hungari ose zambaku i Pashkëve në Irlandën e Veriut³⁵.

Për më tepër, neni 10 mbron jo vetëm përmbajtjen e informacionit dhe ideve, por edhe formën në të cilën janë shprehur ato³⁶. Kështu, dokumentet e shkruara³⁷, transmetimet në radio³⁸, pikturat³⁹, filmat⁴⁰, poezitë⁴¹, romanet⁴² ose sistemet e informacionit elektronik janë gjithashtu të mbrojtura sipas këtij neni. Shprehjes satirike i është dhënë gjithashtu mbrojtje e posaçme nga Gjykata⁴³. Satira është një formë e shprehjes artistike dhe e komentimit social dhe për shkak të tipareve të veta karakteristike të ekzagjerimit dhe deformimit të realitetit, natyrisht që synon të provokojë dhe sjellë zemërim. Çdo ndërhyrje tek e drejta e artistit për këtë shprehje duhet të shqyrtohet me kujdes të posaçëm⁴⁴. Për pasojë, mjetet e prodhimit dhe komunikimit, transmetimit ose shpërndarjes së informacionit dhe ideve mbulohen gjithashtu nga neni 10 dhe Gjykata duhet të jetë e ndërgjegjshme për zhvillimet e shpejta në këto mjete në shumë fusha.

Në mbështetje të nenit 10, Gjykata prezantoi edhe konceptin e “trashëgimisë letrare europiane” dhe në këtë kuptim ka vendosur kritere për dhënien e mbrojtjes: njohjen ndërkombëtare të autorit; datën e publikimit të parë; numrin e vendeve dhe gjuhëve në të cilat është bërë publikimi; botimin në formë libri ose në internet; dhe botimin në një përmbledhje prestigjioze në vendin e lindjes së autorit⁴⁵.

Liria e shprehjes përfshin lirinë negative të shprehjes – të drejtën për të mos folur. Komisioni iu referua kësaj të drejte në çështjen *K kundër Austrisë*⁴⁶, në mbrojtje të kërkuarit ndaj vetë diskriminimit në lidhje me procedimet penale.

E drejta e votës nuk mbrohet sipas nenit 10. Konsiderohet të jetë pjesë e detyrimit të shteteve për të zhvilluar “zgjedhje të lira në intervale të arsyeshme me votë të fshehtë, në kushtet që të garantojnë lirinë e shprehjes së mendimit të njerëzve në zgjedhjen e legjislativit”⁴⁷.

³⁵ *Vajnai kundër Hungarisë*, 8 korrik 2008 dhe *Donaldson kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 25 janar 2011 (vendim paraprak).

³⁶ *Oberschlick kundër Austrisë*, 23 maj 1991; *Thoma kundër Luksemburgut*, 29 mars 2001; *Dichand dhe të Tjerë kundër Austrisë*, 26 shkurt 2002; *Nikula kundër Finlandës*, 21 mars 2002.

³⁷ *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 7 dhjetor 1976.

³⁸ *Gropper Radio AG dhe të Tjerë kundër Zvicrës*, 28 mars 1990.

³⁹ *Müller dhe të Tjerë kundër Zvicrës*, 24 maj 1988.

⁴⁰ *Otto-Preminger-Institut kundër Austrisë*, 20 shtator 1994.

⁴¹ *Karataş kundër Turqisë*, 8 korrik 1999.

⁴² *Akdaş kundër Turqisë*, 16 shkurt 2010.

⁴³ *Oberschlick kundër Austrisë*, 23 maj 1991; *Thoma kundër Luksemburgut*, 29 mars 2001; *Dichand dhe të Tjerë kundër Austrisë*, 26 shkurt 2002; *Nikula kundër Finlandës*, 21 mars 2002.

⁴⁴ *Vereinigung Bildender Künstler kundër Austrisë*, 25 janar 2007.

⁴⁵ *Akdaş kundër Turqisë*, 16 shkurt 2010.

⁴⁶ *K kundër Austrisë*, 13 tetor 1992 (raport i Komisionit).

⁴⁷ Neni 3 i Protokollit të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, 20 mars 1952.

Kapitulli 2

Detyrimet sipas nenit 10

” Ushtrimi i këtyre lirive mbart me vete detyrime dhe përgjegjësi ...

Ideja që ushtrimi i lirisë së shprehjes mbart me vete detyrime dhe përgjegjësi është unike në Konventë dhe nuk mund të gjendet në asnjë nga dispozitat e tjera që rregullojnë të drejtat dhe liritë e njeriut.

Ky tekst nuk është interpretuar si një rrethanë e veçantë që kufizon automatikisht lirinë e shprehjes së individëve që u përkasin kategorive të caktuara profesionale që mund të mbartin me vete “detyrime dhe përgjegjësi”⁴⁸. Vendimet përfundimtare të gjykatës reflektojnë mendime të ndryshme në lidhje me “detyrimet dhe përgjegjësitë” e disa punonjësve të shërbimit civil në ushtrim të lirisë së tyre të shprehjes. Përveç kësaj, praktika gjyqësore është zhvilluar nga një qëndrim tepër konservator që u jepte shteteve kompetenca më të forta, të një qëndrim më liberal, ku shtetet gëzojnë më pak diskrecion.

Për shembull, në çështjen *Engel dhe të Tjerë kundër Holandës*, ndalimi i publikimit dhe shpërndarjes tek ushtarët i një dokumenti që kritikonte disa oficerë më të lartë u konsiderua nga Gjykata ndërhyrje e justifikuar në lirinë e shprehjes. Megjithatë, Gjykata gjithashtu u shpreh se “nuk ishte fjala për t’i privuar ata nga liria e shprehjes, por vetëm për të dënua ushtrimin abuziv të asaj lirie nga ana e tyre”⁴⁹. Në *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, një oficer u dënua pasi kishte zbuluar një informacion që ishte klasifikuar sekret. Ai kishte zbuluar informacion në lidhje me një armë të caktuar dhe njohuritë përkatëse teknike që kishin potencialin për të shkaktuar dëm të konsiderueshëm në sigurinë kombëtare. Gjykata vendosi se dënimi ishte ndërhyrje në lirinë e shprehjes së

⁴⁸ Detyrat dhe përgjegjësitë e gazetarëve diskutohen në kapitujt 6 dhe 8.

⁴⁹ *Engel dhe të Tjerë kundër Holandës*, 8 qershor 1976, paragrafi 101.

oficerit, që megjithatë ishte e justifikuar sipas nenit 2:

Është e nevojshme të merren parasysh kushtet e veçanta të jetës ushtarake dhe “detyrimet” e “përgjegjësitë” e posaçme që u përkasin anëtarëve të forcave të armatosura... Kërkuesi, si oficer te KETA, i ngarkuar me një program eksperimental raketash, i nënshtrohej detyrimit të heshtjes në lidhje me çdo gjë që i përkiste përbushjes së detyrave të tij⁵⁰.

Pothuajse 20 vjet pas vendimit në çështjen *Engel dhe të Tjerë*, në një çështje të ngjashme, Gjykata e ndryshoi mendimin e saj dhe doli me një vendim të kundërt. Në çështjen *Vereinigung demokratischer Soldaten Österreichs dhe Gubi kundër Austrisë*, autoritetet ndaluan shpërndarjen tek ushtarakët në detyrë të një reviste periodike private, që kritikonte administratën ushtarake. Qeveria austriake argumentoi se organi periodik i kërkuesve kërcënonte sistemin e mbrojtjes së vendit dhe efektivitetin e ushtrisë. Gjykata nuk ra dakord me parashtrimet e qeverisë dhe u shpreh se pjesa më e madhe e artikujve në periodik:

shprehnin ankesa, paraqisnin propozime për reforma ose inkurajonin lexuesit të bënin ankime gjyqësore ose të ankimonin vendimet. Megjithatë, me gjithë pjesën urdhëruese shpesh polemike, nuk duket se ata e kaluan kufirin e asaj që është e lejueshme në një diskutim të thjeshtë të ideve, që duhet të tolerohet në ushtrinë e një shteti demokratik, siç duhet të jetë edhe në shoqërinë ku shërben një ushtri e tillë⁵¹.

Në çështjen *Rommelfanger kundër Republikës Federale të Gjermanisë*⁵², Komisioni u shpreh se shtetet kishin detyrimin pozitiv për të garantuar që ushtrimi i lirisë së shprehjes nga një punonjës i shërbimit civil të mos i nënshtrohet kufizimeve që do të ndikonin në thelbin e kësaj të drejte. Edhe kur pranohet ekzistenca e një kategorie të punonjësve të shërbimit civil me “detyrime dhe përgjegjësi” të posaçme, kufizimet e zbatuara mbi të drejtën e tyre të lirisë së shprehjes duhet të shqyrtohen sipas të njëjtave kritere si shkeljet e lirisë së shprehjes së të tjerëve.

Në çështjen *Vogt kundër Gjermanisë*, Gjykata u shpreh se mënyra se si është vendosur detyrimi për besnikëri mbi një punonjës të shërbimit civil është në shkelje të nenit 10. Në vitin 1987, kërkuesja u pushua nga shkolla ku kishte dhënë mësim për rreth 12 vjet për shkak se ishte aktiviste e Partisë Komuniste gjermane dhe ajo refuzoi të largohej nga kjo parti. Detyrimi i besnikërisë ishte vendosur në vijim të eksperiencës së Republikës së Vajmarit dhe justifikohej

⁵⁰*Hadjianastassiou kundër Greqisë*, 16 dhjetor 1992, paragrafi 46.

⁵¹*Vereinigung demokratischer Soldaten Österreichs dhe Gubi kundër Austrisë*, 19 dhjetor 1994, paragrafi 38.

⁵²*Rommelfanger kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, 6 shtator 1989 (vendim paraprak).

nga nevoja për të ndaluar punonjësit e shërbimit publik të merrnin pjesë në aktivitetet politike në kundërshtim me dispozitat kushtetuese. Eprorët e kërkueses vendosën që ajo nuk e kishte respektuar detyrimin që kishte çdo punonjës i shërbimit civil për të ruajtur sistemin e lirë demokratik brenda kuadrit të kushtetutës dhe kështu e pushuan nga puna. Gjykata ishte e mendimit se “megjithëse është e ligjshme për një shtet të vendosë punonjësit e shërbimit civil, për sa u takon statusit të tyre, nën detyrimin e konfidencialitetit, këta punonjës janë individë dhe, si të tillë, kualifikohen për mbrojtjen e nenit 10 të Konventës”⁵³. Për më tepër, Gjykata u shpreh se ishte e ndër-gjegjshme për argumentet në lidhje me historinë e Gjermanisë; megjithatë, duke marrë parasysh natyrën absolute të detyrimit të besnikërisë, zbatueshmërinë e përgjithshme të tij për të gjithë punonjësit e shërbimit civil dhe mungesën e një dallimi ndërmjet sferave private dhe profesionale, autoritetet gjermane kishin shkelur si lirinë e shprehjes ashtu edhe lirinë e pjesëmarrjes në shoqata.

“Detyrimet dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve u shqyrtuan nga Gjykata në çështjen *Wille kundër Lihtenshteinit*, ku kërkuesi, një gjyqtar i lartë, mori një letër nga princi i Lihtenshteinit që kritikonte deklarinë e kërkuesit gjatë një leksioni akademik në lidhje me një çështje kushtetuese dhe duke i bërë të ditur synimin e tij për të mos e emëruar kërkuesin në një post publik në vijim të një deklarimi të tillë. Në fillim të vlerësimit të saj, Gjykata u shpreh se:

duhet mbajtur parasysh që, kurdoherë kur bëhet fjalë për lirinë e shprehjes së personave në këto pozicione, “detyrimet dhe përgjegjësitë” e referuara në nenin 10, paragrafi 2, kanë një rëndësi të posaçme, meqenëse mund të pritet nga punonjësit e shërbimit publik që shërbejnë në gjyqësor që të tregojnë vetëpërmbytje në ushtrimin e lirisë së tyre të shprehjes në të gjitha çështjet kur mund të vihet në pikëpyetje autoriteti dhe paanësia e gjyqësorit⁵⁴.

Gjykata më tej theksoi se megjithëse çështja kushtetuese e ngritur nga kërkuesi kishte ndikime politike, vetëm ky element nuk duhet ta pengonte kërkuesin në diskutimin e kësaj çështjeje. Në konstatimin e shkëljes së nenit 10, Gjykata vuri re se në një ngjarje të mëparshme, qeveria e Lihtenshteinit kishte pasur një mendim të ngjashëm me atë të kërkuesit dhe që mendimi i shprehur nga kërkuesi mbështetej nga një numër i konsiderueshëm njerëzish në vend dhe në këtë mënyrë nuk ishte një propozim i papabuar.

Kjo do të thotë se çdo ligj ose rregullim tjetër i brendshëm që vendos një besnikëri të pakufizuar ose kufizime konfidencialiteti për kategori të caktuara të punonjësve të shërbimit civil, si ata që janë punësuar nga shërbimet e inte-

⁵³*Vogt kundër Gjermanisë*, 26 shtator 1995, paragrafi 53.

⁵⁴*Wille kundër Hungarisë*, 28 tetor 1999, paragrafi 64.

ligjencës, ushtria etj., ose anëtarët e gjyqësorit, do të shkelnin nenin 10. Këto kufizime mund të vendosen nga shtetet anëtare vetëm nëse nuk kanë një karakter të përgjithshëm, por janë të kufizuara te një kategori e caktuar informacioni, fshehtësia e të cilit, duhet të shqyrtohet periodikisht, për kategori të posaçme të punonjësve të shërbimit civil ose vetëm për disa individë që u përkasin këtyre kategorive dhe nëse janë të përkohshme. Në argumentimin që detyrimet e besnikërisë ose konfidencialitetit janë në interes të mbrojtjes së “sigurisë kombëtare”, shtetet anëtare duhet të përkufizojnë konceptin e fundit në një mënyrë të ngushtë dhe rigoroze, duke shmangur përfshirjen e sferave që dalin jashtë objektit të vërtetë të sigurisë kombëtare. Në të njëjtën mënyrë, shtetet duhet të provojnë ekzistencën e një rreziku real për interesin e mbrojtur, siç është siguria kombëtare dhe duhet të marrin parasysh gjithashtu interesin e publikut në pasjen e aksesit tek informacione të caktuara. Nëse injorohen të gjithë këta faktorë, këto kufizime për lirinë e shprehjes kanë natyrë absolute dhe janë në mospërputhje me nenin 10, paragrafi 2.

Kapitulli 3

Gjuha e pambrojtur - gjuha e urretjtjes, nxitja e dhunës

3.1. Nxitja e dhunës

Nxitja e dhunës del jashtë mbrojtjes së dhënë nga neni 10, kur ka një përdorim të qëllimshëm dhe të drejtpërdrejtë të fjalëve për ta nxitur atë dhe kur ka një mundësi reale që dhuna të ndodhë. Në çështjen *Sürek kundër Turqisë*, megjithëse përshkruhet lufta çlirimtare e kurdëve si një “luftë e drejtuar kundër forcave të armatosura të Republikës së Turqisë”, artikulli thekson se “ne duam të zhvillojmë një luftë të përgjithshme çlirimtare”. Sipas mendimit të Gjykatës, “neni i diskutuar lidhej vetëm me PKK-në dhe shprehte një thirrje për përdorimin e forcës së armatosur si mjet për të arritur pavarësinë kombëtare të Kurdistanit”⁵⁵. Gjykata më tej vuri re se neni ishte publikuar në kontekstin e trazirave serioze ndërmjet forcave të sigurisë dhe anëtarëve të PKK-së, që kishte të bënte me humbje të konsiderueshme jetësh dhe vendosjen e gjendjes së emergjencës në një pjesë të madhe të Turqisë Juglindore. Në këtë kontekst:

përmbajtja e artikullit duhet të shihet si nxitëse e dhunës së mëtejshme në rajon. Në fakt mesazhi që i komunikohet lexuesit ishte që përdorimi i dhunës është një masë e nevojshme dhe e justifikuar vetëmbrojtjeje përballë agresorit⁵⁶.

Në vijim të këtij vlerësimi, Gjykata konstatoi se dënimi i kërkuesit nuk ishte në kundërshtim me nenin 10.

Gjykata arriti përfundime të ngjashme në çështjen *Leroy kundër Francës*⁵⁷. Në vitin 2002, karikaturisti francez u dënua për bashkëpunim në tolerimin e terrorizmit për shkak të një karikature në një gazetë javore baske, “*Ekaitza*”.

⁵⁵ *Sürek kundër Turqisë* (Nr. 3), 8 korrik 1999 (GC), paragrafi 40.

⁵⁶ *Sürek kundër Turqisë* (Nr. 1), 8 korrik 1999, paragrafi 62.

⁵⁷ *Leroy kundër Francës*, 2 tetor 2008.

Më 11 shtator 2001, karikaturisti i paraqiti ekipit redaksional të revistës një skicë që përfaqësonte sulmin mbi dy kullat binjake të Qendrës Botërore të Tregtisë, me një diçiturë që parodizonte sloganin e reklamës së një marke të famshme: “Ne të gjithë kemi ëndërruar për të... Hamasi ia arriti” (krahaso “Sony ia arriti”). Gjykata theksoi se ngjarjet tragjike të datës 11 shtator 2001, që ishin në fillësë të shprehjes së kundërshtuar, ishin bërë shkak për kaos në mbarë botën dhe se çështjet e nxjerra nga kjo ngjarje i nënshtroheshin diskutimit si një çështje me interes publik. Megjithatë, Gjykata ishte e mendimit se skica nuk ishte e kufizuar te kritika për imperializmin e SHBA-së, por mbështeste dhe lavdëronte shkatërrimin e dhunshëm të këtij të fundit. Ajo e bazonte konstatimin e saj në diçiturën që shoqëronte skicën dhe vuri re se kërkuesi kishte shprehur mbështetjen e tij morale për ata që ai i prezumonte të ishin autorët e sulmeve të 11 shtatorit 2001. Nëpërmjet zgjedhjes gjuhësore, kërkuesi komentonte duke miratuar dhunën e ushtruar ndaj mijëra civilëve dhe ulte dinjitetin e viktimave, siç kishte pranuar ai për skicën në ditën e sulmeve dhe ajo ishte publikuar më 13 shtator, pa marrë asnjë masë nga ana e tij në lidhje me gjuhën e përdorur. Sipas mendimit të Gjykatës, ky faktor - data e publikimit - ishte i tillë që rriste përgjegjësinë e karikaturistit për shprehjen, si dhe mbështetjen, e një ngjarjeje tragjike, qoftë kjo e parë nga një këndvështrim artistik ashtu edhe nga ai gazetaresk. Gjithashtu, ndikimi i një mesazhi të tillë në një rajon politikisht të ndjeshëm, siç është Vendi Bask, nuk duhej anashkaluar. Sipas Gjykatës, karikatura kishte provokuar një reagim të caktuar publik, në gjendje, të shkaktonte dhunë dhe të demonstronte një ndikim konkret mbi rendin publik në rajon. Shkaqet e paraqitura nga gjykatat e brendshme në dënimin e kërkuesit ishin “relevante dhe të mjaftueshme”. Duke pasur parasysh natyrën modeste të gjobës dhe kontekstin në të cilën ishte publikuar skica e kundërshtuar, Gjykata konstatoi se masa e vendosur mbi karikaturistin nuk ishte disproporcionale në lidhje me qëllimin e ligjshëm të ndjekur. Për pasojë, nuk kishte pasur shkelje të nenit 10 të Konventës.

Nga ana tjetër, në çështjen *Sürek kundër Turqisë (Nr. 4)*, ku artikujt e diskutuar e përshkruanin Turqinë si “terroristen e vërtetë” dhe si “armike”, Gjykata konstatoi se:

kritika e fortë ndaj autoriteteve turke ... është më shumë një reflektim i qëndrimit të fortë të një pale në konflikt, se sa një thirrje për dhunë.

Në tërësi, përmbajtja e artikujve nuk mund të interpretohet si nxitëse e dhunës.

Gjykata argumentoi gjithashtu se publiku ka të drejtë të “informohet në lidhje me një këndvështrim tjetër të situatës në Turqinë Juglindore, pavarësisht sesa

i papranueshëm mund të jetë ky këndvështrim për ta⁵⁸. Gjykata arriti në përfundimin se fajësimi dhe dënimi i kërkuesit ishte në kundërshtim me nenin 10. Po ashtu, në çështjen *Karataş kundër Turqisë*, Gjykata konstatoi se:

edhe pse disa prej pasazheve të vjershave duket se kanë një ton shumë agresiv dhe sikur bëjnë thirrje për përdorimin e dhunës... fakti që ato ishin artistike në natyrë dhe me ndikim të kufizuar i bënte ato më shumë një shprehje të një shqetësimi të thellë për një situatë të vështirë politike sesa një thirrje për kryengritje⁵⁹.

3.2. Gjuha e urrejtjes dhe racizmi

Gjuha e urrejtjes e drejtuar kundër minoriteteve të ndryshme nuk mbrohet nga neni 10. Në çështjen *Vejdeland dhe të Tjerë kundër Suedisë*⁶⁰, kërkuesit u dënuan për shpërndarjen e afërsisht 100 fletëpalosjeve në shkollat e mesme që u konsideruan nga gjykata si fyerje për homoseksualët. Kërkuesit i kishin shpërndarë fletëpalosjet nëpërmjet një organizate të quajtur "*Rinia Kombëtare*", duke i lënë ato brenda ose mbi sirtarët e nxënësve. Deklarimet në fletëpalosje ishin, veçanërisht, pretendime se homoseksualiteti ishte një "prirje seksuale perverse", kishte "një efekt moralisht shkatërrues mbi thelbin e shoqërisë" dhe ishte shkak për përhapjen e HIV-it dhe AIDS-it. Kërkuesit pretendonin se nuk kishin si synim të shprehnin përbuzje për homoseksualët si një grup dhe deklaruan që qëllimi i aktivitetit të tyre ishte të fillonin një debat në lidhje me mungesën e objektivitetit në edukimin në shkollat suedeze. Gjykata konstatoi se këto deklarime përbënin akuza të rënda dhe paragjykuese, edhe nëse nuk përbënin një thirrje të drejtpërdrejtë për veprime urrejtjeje. Gjykata theksoi se diskriminimi i bazuar në orientimin seksual ishte një diskriminim po aq i rëndë sa edhe ai i bazuar në racë, origjinë ose ngjyrë. Ajo arriti në përfundimin se nuk kishte pasur shkelje të nenit 10 të Konventës, pasi ndërhyrja tek ushtrimi prej kërkuesve i së drejtës së lirisë së shprehjes ishte konsideruar në mënyrë të arsyeshme nga autoritetet suedeze e nevojshme në një shoqëri demokratike për mbrojtjen e reputacionit dhe të drejtave të të tjerëve.

Në çështjen *Norwood kundër Mbretërisë së Bashkuar*⁶¹, kërkuesi kishte varur në dritaren e tij një poster të dhënë nga Partia Kombëtare Britanike, anëtar i së cilës ishte, që tregonte Kullat Binjake në flakë. Pamja ishte e shoqëruar me fjalët: "Islami jashtë Britanisë - Mbroni Popullin Britanik". Për pasojë, ai u

⁵⁸ *Sürek kundër Turqisë* (Nr. 4), 8 korrik 1999 (GC), paragrafi 58.

⁵⁹ *Karataş kundër Turqisë*, 8 korrik 1999, paragrafi 52.

⁶⁰ *Vejdeland dhe të Tjerë kundër Suedisë*, 9 shkurt 2012.

⁶¹ *Norwood kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 16 nëntor 2004 (vendim).

dënua për armiqësi të theksuar përkundrejt një grupi fetar. Gjykata e deklaroi ankimin të papranueshëm, duke iu referuar nenit 17 të Konventës, i cili ndalon çdo aktivitet “që synon asgjësimin e çdo të drejte dhe lirie të parashikuar në të”. Gjykata vërejt se liria e shprehjes nuk mund të përdoret për asgjësimin e të drejtave dhe lirie të parashikuara në Konventë. Ajo konstatoi se një sulm i tillë i përgjithshëm dhe i fuqishëm kundër një grupi fetar, duke e lidhur këtë grup si një të tërë me një akt të rëndë terrorizmi, ishte në papajtueshmëri me vlerat e proklamuar dhe të garantuara në Konventë, siç janë toleranca, paqja sociale dhe mosdiskriminimi. Çdo shprehje që përmban elementet e diskriminimit racial dhe fetar del jashtë objektit të nenit 10⁶².

Gjykata gjithashtu ka pasur mundësinë të shqyrtojë deklaratimet raciste të transmetuara në televizion, të cilat janë bërë në kontekstin e informimit të publikut në lidhje me një grup të rinjsh që shprehin mendime raciste. Në çështjen *Jersild kundër Danimarkës*⁶³, kërkuesi ishte një gazetar televizioni, i cili u dënua nga gjykatat vendase për shkak të ndihmës dhe nxitjes së shpërndarjes së deklaratimeve raciste. Ai kishte marrë iniciativën e përgatitjes së një programi në të cilin u intervistuan tre anëtarë të një grupi të rinjsh me pikëpamje raciste. Gazetari e dinte paraprakisht që mund të bëheshin deklaratime raciste gjatë intervistimit dhe i kishte inkurajuar këto deklaratime. Ai i përfshiu edhe deklaratimet fyese gjatë redaktimit të intervistave. Intervistat pastaj u paraqitën në një program televiziv serioz, të synuara për dëgjues të mirinformuar, që trajtonin një gamë të gjerë çështjesh sociale dhe politike, duke përfshirë ksenofobinë dhe imigrimin. Dëgjuesit mund të dëgjonin deklaratime të tilla, si: “Është mirë të jesh racist”. “Ne besojmë që Danimarka është për danezët”; “Njerëzit duhet të lejohen të mbajnë skllëvër”; “Bëji një foto një gorille.. dhe pastaj shiko një zezak, është e njëjta strukturë trupore dhe gjithçka... ballë i sheshtë”; “Zezakët nuk janë njerëz, janë kafshë, dhe kjo mund të thuhet edhe për punëtorët e tjerë të huaj, turq, jugosllavë apo sido që të quhen” etj. Të rinjve iu bënë pyetje edhe për shtëpitë e tyre, vendet e punës, si dhe dëshmitë e penaltetit. Arsyeja kryesore se pse gjykatat e brendshme e fajësuan gazetarin për ndihmën dhe nxitjen e thënieve raciste ishte mungesa e një deklarimi përfundimtar nëpërmjet të cilit, sipas mendimit të gjykatës, ai duhej të kritikonte shprehimisht këndvështrimet raciste të shprehura gjatë intervistave.

Para Gjykatës së Strasburgut, qeveria e justifikoi dënimin me nevojën për të mbrojtur të drejtat e personave të fyer nga deklaratimet raciste. Gjykata theksoi rëndësinë jetike të luftës kundër diskriminimit racial, duke theksuar se çështja

⁶² *Kühnen kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, 12 maj 1989 (vendim).

⁶³ *Jersild kundër Danimarkës*, 23 shtator 1994 (GS)

e transmetuar nga kërkuesi ishte me interes të madh publik. Duke trajtuar mënyrën se si ishte përgatitur dhe paraqitur programi, Gjykata konstatoi se ai:

objektivisht nuk mund të shfaqej sikur kishte qëllimin e tij propagandimin e mendimeve dhe ideve raciste. Përkundrazi, nëpërmjet intervistës, ai u përpoq të ekspozonte, analizonte dhe shpjegonte këtë grup të rinjsh, të kufizuar dhe të mbetur pa shpresë nga gjendja e tyre sociale dhe me dëshmi penaliteti dhe sjellje të dhunshme.

Duke kritikuar qëndrimin e gjykatave vendase në lidhje me mënyrën se si duhej të kishte kundër-balancuar deklaramet raciste gazetari, Gjykata u shpreh se:

metodat e raportimit objektiv dhe të balancuar mund të ndryshojnë në masë të konsiderueshme, në varësi, ndërmjet të tjerash, të medias në fjalë. Nuk i takon kësaj Gjykate dhe as gjykatave vendase të zëvendësojnë mendimet e tyre me ato të shtypit në lidhje me teknikën e raportimit që duhet të zbatohet nga gazetarët.

Gjykata, duke diskutuar raportimin e lajmeve bazuar në intervista, qofshin të redaktuara apo jo, ishte e mendimit se:

dënimi i një gazetari për ndihmën në shpërndarjen e deklarameteve të bëra nga një person tjetër në një intervistë do të pengonte seriozisht kontributin e shtypit në diskutimet e çështjeve me interes publik dhe nuk duhet të imagjinohet, përveç kur ka shkaqe tepër të forta për ta bërë këtë⁶⁴.

Për këtë shkak, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 10.

3.3. Mohimi i holokaustit dhe referencat tek ideologjia naziste

Gjuha që propagandon ideologjinë naziste dhe mohon holokaustin del jashtë mbrojtjes së nenit 10. Përdorimi i imazheve që i referohen holokaustit në fushata sociale gjithashtu nuk mbrohet nga neni 10. Një mbrojtje e tillë u refuzua në çështjen *PETA Deutschland kundër Gjermanisë*⁶⁵, ku një urdhër gjyqësor nga Gjykata Rajonale e Berlinit në vitin 2004 e pengoi organizatën për të drejtat e kafshëve (Njerëz për Trajtimin Etik të Kafshëve) të publikonte një fushatë sensibilizimi që shfaqte postera me foto të viktimave të dobëta dhe lakuriq të kampeve të përqendrimit ose grumbujve të trupave të vdekur së bashku me pamje të kafshëve të mbajtura në kope masive. Pamjet shoqëroheshin me tekste të shkurtra, si “poshtërimi përfundimtar”, “kur bëhet fjalë për kafshë, kushdo bëhet nazist” dhe “holokausti në pjatën tuaj”. Gjykata arriti një përfundim të ndryshëm në një vendim të fundit në lidhje me një fushatë kundër abortit⁶⁶.

⁶⁴*Jersild kundër Danimarkës*, 23 shtator 1994, paragrafët 31-35.

⁶⁵*PETA Deutschland kundër Gjermanisë*, 8 nëntor 2012.

⁶⁶*Annen kundër Gjermanisë*, 26 nëntor 2015.

Mohimit të holokaustit⁶⁷, si një subjekt diskutimi publik, iu refuzua gjithashtu mbrojtja e nenit 10. Në çështjen *D.I kundër Gjermanisë*, kërkuesi, i cili ishte historian, u gjobit për shkak të deklarimeve në një takim publik ku ai kishte mohuar ekzistencën e dhomave të gazit në Aushvic, duke deklaruar se këto dhoma gazi ishin të rreme, të ndërtuara që në vitet e para pas Luftës së Parë dhe taksapaguesit gjermanë kishin paguar rreth 16 miliardë marka gjermane për të rremet. Komisioni e konsideroi ankimin të papranueshëm, duke vënë re që deklarimet e kërkuetit ishin në kundërshtim me parimet e paqes dhe drejtësisë të shprehura në Preambulën e Konventës, dhe ato propagandonin diskriminim racor dhe fetar. Komisioni u shpreh:

Interesi publik në parandalimin e krimit dhe mungesës së rendit në popullatën gjermane për shkak të sjelljes fyese ndaj çifutëve dhe veprave penale të ngjashme dhe kërkesat për mbrojtjen e reputacionit dhe të drejtave të tyre në një shoqëri demokratike mbizotërojnë mbi lirinë e kërkuetit për të bërë publikime që mohojnë ekzistencën e vrasjes me gaz të çifutëve nën regjimin nazist⁶⁸.

Komisioni arriti në përfundime të ngjashme në çështjen *Honsik kundër Austrisë*⁶⁹ dhe *Ochensberger kundër Austrisë*⁷⁰, ku kërkuetit gjithashtu kishin mohuar ekzistencën e holokaustit dhe kishin nxitur urrejtjen raciale.

Po ashtu, gjykata nuk i dha mbrojtje *Dieudonné M' Bala M'Bala*, një komediani, i cili u përfshi në aktivitete politike, për fyerje publike drejtuar një personi ose grupi personash për shkak të origjinës së tyre ose të përkatësisë në një komunitet të caktuar etnik, kombi, race ose feje, veçanërisht në rastin e personave të origjinës së besimit çifut⁷¹. Në fund të një shfaqje në dhjetor të vitit 2008, të "*Zénith*" në Paris, kërkuesi ftoi *Robert Faurisson-in*, një akademik, i cili kishte marrë një numër dënimesh në Francë për mendimet e tij mohuese dhe revizioniste, kryesisht për mohimin e tij të ekzistencës së dhomave të gazit në kampet e përqendrimit, për t'u bashkuar me të në skenë për të marrë një "çmim për aftësi dhe paturpësi - të pashpeshtë". Çmimi, që kishte formën e një mbajtëseje qirinsh me tre degë me një mollë në çdo degë, iu dha atij nga një aktor që kishte veshur atë që u përshkrua si "rroba e dritës" - një palë

⁶⁷Holokausti përkufizohet si "përndjekje dhe asgjësim i sponsorizuar nga shteti i çifutërisë europiane, nga Gjermania naziste dhe bashkëpunëtorët e saj, ndërmjet viteve 1933 dhe 1945. Çifutët ishin viktimat e para - gjashtë milionë u vranë. Romët (evgjitët), personat me paaftësi fizike ose mendore dhe polakët ishin projektuar për asgjësim ose dëmtim për arsye racore, etnike ose kombëtare. Miliona të tjerë, duke përfshirë homoseksualët, dëshmitarët e Jehovahit, të burgosurit sovjetikë të luftës dhe disidentët politikë gjithashtu vuajtën nga shtypja e rëndë dhe vdekja nën tiraninë naziste." www.ushmm.org/education/foreducators/guidelines.

⁶⁸*D.I. kundër Gjermanisë*, 26 qershor 1996 (vendim).

⁶⁹*Honsik kundër Austrisë*, 18 tetor 1995 (vendim).

⁷⁰*Ochensberger kundër Austrisë*, 2 shtator 1994 (vendim).

⁷¹*M'BalaM'Bala kundër Francës*, 20 tetor 2015 (vendim).

pizhame me shirita me një yll të verdhë të ngjitur që kishte fjalën “çifut” - i cili luante pjesën e një të dëbuarit çifut në një kamp përqendrimi. Gjykata e deklaroi kërkesën të papranueshme (të papajtueshme *ratione materiae*), në pajtim me nenin 35 (kriteret e pajtueshmërisë) së Konventës, duke konstatuar që sipas nenit 17 (ndalimi i abuzimit me të drejtat), kërkuesi nuk e kishte të drejtën e mbrojtjes së nenit 10 (liria e shprehjes). Gjykata ishte e mendimit se, veçanërisht gjatë skenës fyese, performanca nuk mund të vazhdonte të shihej më si argëtim, por më shumë ngjante si një mbledhje politike, që, me pretekstin e komedisë, nxiste mohimin nëpërmjet pozicionit kyç të dhënë shfaqjes së *Robert Faurisson-it* dhe portretizimit degradues të viktimave të dëbimit të çifutëve që përballëshin me një njeri që kishte mohuar zhdukjen e tyre. Sipas mendimit të Gjykatës, kjo nuk ishte një performancë që, edhe nëse është satirike ose provokative, futet nën mbrojtjen e nenit 10, por në rrethanat konkrete, në realitet ishte një demonstrim i urrejtjes dhe anti-semitizmit dhe mbështetje për mohimin e holokaustit. E kamufluar si një prodhim artistik, ishte një fakt po aq i rrezikshëm sa edhe një sulm i papritur dhe i drejtpërdrejtë, dhe përbënte një platformë për një ideologji që binte në kundërshtim me vlerat e Konventës. Kështu, Gjykata nxori përfundimin se kërkuesi kërkonte të devijonte nenin 10 nga qëllimi i tij real, duke përdorur të drejtën e tij të lirisë së shprehjes për qëllime që ishin në papajtueshmëri me tekstin dhe frymën e Konventës dhe që, nëse prezantohej, do të kontribuonte në shkatërrimin e të drejtave dhe lirive të Konventës.

Ndryshe nga mohimi i holokaustit, mohimit të gjenocidit armen, si një temë e diskutimit historik dhe publik, i është dhënë mbrojtje nga neni 10. Në çështjen *Perinçek kundër Zvicrës*, z. *Perinçek*, një politikan turk, shprehu publikisht mendimin në Zvicër se dëbimet masive dhe masakrat e pësuar nga armenët në Perandorinë Osmane në vitin 1915 dhe në vitet në vazhdim nuk ishin gjenocid⁷². Gjykatat zvicerane ishin të mendimit se veçanërisht motivet e tij dukeshin raciste dhe nacionaliste dhe që deklarimet e tij nuk kontribuonin në debatin historik. Kërkuesi u ankua se fajësimi dhe ndëshkimi i tij penal kishin shkelur të drejtën e tij për lirinë e shprehjes. Gjykata ishte e mendimit se kishte pasur shkelje të nenit 10 të Konventës. Duke qenë e ndërgjegjshme për rëndësinë e madhe që i jepej nga komuniteti armen çështjes nëse duhej të konsideroheshin si gjenocid ato dëbime masive dhe masakra, ajo konstatoi se dinjiteti i viktimave dhe dinjiteti i identitetit të armenëve të kohëve moderne mbroheshin nga neni 8. Rrjedhimisht, Gjykata duhej të gjente një balancë ndërmjet dy të drejtave të Konventës, së drejtës së lirisë së shprehjes dhe të drejtës së respektimit të jetës private, duke marrë parasysh rrethanat specifike të çështjes dhe të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe

⁷²*Perinçek AG kundër Zvicrës*, 15 tetor 2015.

qëllimit që synohet të arrihet. Në një çështje të tillë, Gjykata nxori përfundimin që nuk ka qenë e nevojshme, në një shoqëri demokratike, që kërkuesi t'i nënshtrohej ndëshkimit penal me qëllim që të mbrohen të drejtat e komunitetit armen në fjalë në këtë çështje. Posaçërisht, Gjykata mori parasysh elementet e mëposhtme: deklaratimet e kërkuesit përmbanin një çështje me interes publik dhe nuk përbënin thirrje për urrejtje dhe intolerancë; konteksti në të cilin ishin bërë ato nuk karakterizohej nga tensione të larta ose tone të posaçme historike në Zvicër; deklaratimet nuk mund të konsideroheshin sikur preknin dinjitetin e anëtarëve të komunitetit armen deri në atë pikë sa të kërkojë një përgjigje sipas së drejtës penale të Zvicrës; nuk kishte asnjë detyrim sipas së drejtës ndërkombëtare për Zvicrën të penalizojë këto deklarime; gjykatat zvicerane duket se kanë censuruar kërkuesin thjesht për shprehjen e një mendimi që nuk ishte i njëjtë me ata të konsoliduar në Zvicër; dhe ndërhyrja te kjo e drejtë e lirisë së shprehjes kishte marrë formën e rëndë të ndëshkimit penal.

Kapitulli 4

Sistemi i kufizimeve brenda ushtrimit të së drejtës së lirisë së shprehjes - paragrafi i dytë

4.1. Kufizimet e lejuara

Paragrafi 2 i nenit 10 thotë:

Ushtrimi i këtyre lirive që përmbajnë detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar zbulimin e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

Qëllimi kryesor i sistemit të Konventës është që gjykatat e brendshme të zbatojnë tekstin e Konventës siç zhvillohet nga praktika gjyqësore e Gjykatës. Gjykata duhet të jetë mjeti i fundit. Kjo është arsyeja që gjykatat e brendshme janë shkalla e parë dhe më e rëndësishme për të garantuar ushtrimin e lirë të lirisë së shprehjes dhe për të garantuar që kufizimet e mundshme të ndjekin kërkesat e përcaktuara në paragrafin 2, siç shpjegohen dhe zhvillohen nga Gjykata.

” Ushtrimi i këtyre lirive ... mund t'i nënshtrohet ...

Çdo kufizim, kusht ose formë ndërhyrjeje në lirinë e shprehjes mund të zbatohet vetëm te një ushtrim i posaçëm i kësaj lirie. Brendia e të drejtës së lirisë së shprehjes nuk mund të preket asnjëherë. Në këtë aspekt, neni 17 thotë:

Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se i jep një shteti, grupimi ose individi, të drejtën që të përfshihet në ndonjë veprimtari ose të kryejë ndonjë akt që synon cenimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të ose kufizime më të gjera të këtyre të drejtave ose lirive sesa është parashikuar në Konventë.

Me sa duket, një kufizim i brendisë së një të drejte është e ngjashme me kufizimin e asaj të drejte.

Po ashtu, autoriteteve të brendshme nuk u kërkohet të ndërhyjnë tek ushtrimi i lirisë së shprehjes kurdoherë që del një nga shkaqet e renditura në paragrafin 2, pasi kjo do të çonte në një kufizim të brendisë së asaj të drejte. Për shembull, cenimi i reputacionit ose nderit të dikujt nuk duhet të shihet si kriminale dhe/ose shkak për zhdëmtim civil në të gjitha rastet. Po ashtu, një deklaratë publike që vendos në rrezik autoritetin e gjyqësorit nuk duhet të dënohet kurdoherë që ndodh një kritikë e tillë. Me fjalë të tjera, autoritetet publike kanë vetëm mundësinë dhe jo detyrimin për të urdhëruar dhe/ose ekzekutuar një masë kufizuese ose ndëshkuese në lidhje me ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes. Një qëndrim tjetër do të çonte në një hierarki të drejtash dhe vlerash ose interesash, duke e vendosur lirinë e shprehjes në fund të listës, për shembull, pas së drejtës së dinjitetit dhe nderit ose mbrojtjes së moralit ose rendit publik. Një hierarki e tillë do të ishte në kundërshtim me të gjitha traktatat ndërkombëtare që parashikojnë barazinë e të drejtave dhe nuk lejojnë kufizimet e përhershme për ushtrimin e një të drejte, pasi kjo do të ishte e barabartë me mohimin e asaj të drejte.

4.2. Testi me tri pjesë

Gjykata, gjatë vlerësimit të ndërhyrjes së lirisë së shprehjes, përdor testin me tri pjesë që përdoret edhe në çështjet në lidhje me nenet 8, 9 dhe 11 të Konventës. Në pajtim me nenin 10, paragrafi 2, autoritetet e brendshme në secilën prej shteteve kontraktuese mund të ndërhyjnë në ushtrimin e lirisë së shprehjes nëse përmbushen tri kushte kumulative:

- ndërhyrja (d.m.th., “formaliteti”, “kushti”, “kufizimi” ose “dënimi”) të jetë e parashikuar me ligj⁷³;
- ndërhyrja synon mbrojtjen e një ose më shumë prej interesave ose vlerave të mëposhtme: sigurinë kombëtare, integritetin territorial; sigurinë publike; parandalimin e trazirave ose kriminimit; mbrojtjen e shëndetit; moralin; reputacionin ose të drejtat e të tjerëve; parandalimin e deklarimit të informacionit të marrë në mirëbesim; dhe ruajtjen e autoritetit

⁷³ *Gawęda kundër Polonisë*, vendim i datës 14 mars 2002 dhe *The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 26 prill 1979.

- dhe paanësisë së gjyqësorit⁷⁴;
- ndërhyrja është e nevojshme në një shoqëri demokratike⁷⁵.

Roli kryesor i nenit 10 është mbrojtja e lirisë së shprehjes për gjithsecilin. Kështu, Gjykata ka vendosur rregulla për interpretimin rigoroz të kufizimeve të mundshme të parashikuara në paragrafin 2. Në çështjen *The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Komisioni u shpreh se:

Interpretim i ngushtë do të thotë se në bazë të çdo kufizimi nuk duhet të ketë asnjë kriter tjetër përveç atyre të përmendura në dispozitën përjashtuese dhe këto kritere, nga ana tjetër, duhet të kuptohen në mënyrë të tillë që gjuha të mos dalë tej kuptimit të saj të zakonshëm...

Në rastin e dispozitave përjashtimore parimi i interpretimit të ngushtë has vështirësi të caktuara për shkak të tekstit të gjerë të vetë dispozitës. Megjithatë, ajo vendos një numër detyrimesh të përcaktuara në mënyrë të qartë për autoritetet⁷⁶.

Faktikisht ajo vendosi standardin ligjor që, në çdo rast ekstrem, liria e individit duhet të balancohet në mënyrë të favorshme përkundrejt pretendimit nga ana e shtetit të interesit mbizotërues⁷⁷.

Nëse Gjykata konstaton se janë të përmbushura të tri kërkesat, ndërhyrja e shtetit konsiderohet të jetë legjitime. Barra e provës që të tri këto kërkesa janë përmbushur i takon shtetit. Gjykata i shqyrton të tria këto kushte sipas renditjes së përcaktuar më sipër. Nëse Gjykata konstaton se shteti nuk ka mundur të provojë një prej këtyre tri kërkesave, ajo nuk e vazhdon më tej shqyrtimin e çështjes dhe vendos që ndërhyrja përkatëse nuk është e justifikuar dhe në këtë mënyrë liria e shprehjes është shkelur.

4.3. Ndërhyrja në ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes

” Ndërhyrja: “formalitetet, kushtet, kufizimet ose penaltetet”

“Ndërhyrja e shtetit” si çdo formë e ndërhyrjes që vjen nga çdo autoritet që ushtron pushtet publik dhe përmbush detyra publike, ose nga qenia në shërbimin publik, si: gjykatat, zyrat e prokurorive, policia, çdo organ i zbatimit të ligjit, shërbimet e fshehta, këshillat qendrore ose lokale, departamentet qe-

⁷⁴ *Observer dhe Guardian kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 26 nëntor 1991.

⁷⁵ *Długołęcki kundër Polonisë*, 24 shkurt 2009 dhe *Tolstoy Miloslavsky kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 13 korrik 1995.

⁷⁶ *The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 18 maj 1977, raporti i Komisionit, paragrafi 194.

⁷⁷ A. Rzeplinski, “Kufizimet e shprehjes së opinioneve ose deklarimit të informacionit mbi politikën e brendshme ose të jashtme të shtetit”, Budapest, 1997, te *Monitor/Inf (97) 3*, Këshilli i Europës.

ritare, organet vendimmarrëse të ushtrisë, ose strukturat profesionale publike. Duke mos qenë aspak shterues, listimi i mësipërm përpiqet vetëm të tregojë autoritetet e mundshme qeveritare që do të ishin në gjendje të kufizonin ushtrimin e lirisë së shprehjes. Nuk ka asnjë rëndësi për Gjykatën se cili autoritet konkretisht ndërhyt tek e drejta; qeveria do të konsiderohet si palë e paditur në të gjitha çështjet e sjella para Gjykatës së Strasburgut.

Gama e ndërhyrjeve të ndryshme (formalitetet, kushtet, kufizimet ose ndëshkimet) tek ushtrimi i së drejtës së lirisë së shprehjes është shumë e gjerë dhe nuk ka kufizime të paracaktuara. Gjykata shqyrton dhe vendos në çdo rast të posaçëm nëse ekziston ndërhyrja, duke parë ndikimin kufizues mbi ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes të masës specifike të zbatuar nga autoritetet e brendshme. Një ndërhyrje e tillë mund të jetë: ndëshkim penal⁷⁸ (gjobë ose burgim), një urdhër për të paguar dëmshpërblimet civile⁷⁹, ndalimi i botimit⁸⁰ ose i botimit të fotografisë së dikujt në gazetë⁸¹, konfiskimi i botimeve ose i çdo mjeti tjetër nëpërmjet të cilit shprehet një opinion ose jepet një informacion⁸², refuzimi për dhënien e një licence transmetimi⁸³, ndalimi i ushtrimit të profesionit të gazetarisë⁸⁴, ndëshkimi disiplinor, një urdhër gjykate ose i një organi tjetër për të treguar burime gazetareske dhe/ose ndëshkimi nëse kjo nuk ndodh⁸⁵, deklarimi nga kreu i një shteti që një punonjës i shërbimit civil nuk do të emërohet në një post publik në vijim të një deklarimi në publik të bërë nga punonjësi i shërbimit publik⁸⁶ etj.

Ndërmjet formave të ndryshme të ndërhyrjes, censura para publikimit konsiderohet nga Gjykata si më e rrezikshmja, pasi kjo pengon dhënien e informacionit dhe ideve tek ata që duan t'i marrin ato. Kjo është arsyeja se pse masat e marra para publikimit, si licencimi i gazetarëve, shqyrtimi i një artikulli nga një zyrtar para publikimit të tij, ose ndalimi i publikimit i nënshtrohen nga Gjykata një kontrolli shumë rigoroz⁸⁷. Nëse këto kufizime janë të përkohshme, ato mund të ulin vlerën e informimit. Gjatë përbaljes me ndalimin e publikimit

⁷⁸*Barfod kundër Danimarkës*, 22 shkurt 1989; *Lingens kundër Austrisë*, 8 korrik 1986; *Dalban kundër Rumanisë*, 28 shtator 1999.

⁷⁹*Müller dhe të Tjerë kundër Zvicrës.*, 24 maj 1988.

⁸⁰*The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar (Nr. 2)*, 26 nëntor 1991; *Observer dhe Guardian kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 26 nëntor 1991.

⁸¹*News Verlags GmbH&Co.KG kundër Austrisë*, 11 janar 2000.

⁸²*Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 7 dhjetor 1976; *Müller dhe të Tjerë kundër Zvicrës*, 24 maj 1988.

⁸³*Autronic AG kundër Zvicrës*, 22 maj 1990.

⁸⁴*Wojtas-Kaleta kundër Polonisë*, 16 korrik 2009; *Frankowicz kundër Polonisë*, 16 dhjetor 2008.

⁸⁵*Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 27 mars 1996 (GC).

⁸⁶*Wille kundër Lihtensheinit*, 28 tetor 1999.

⁸⁷*RTBF kundër Belgjikës*, 29 mars 2011, paragrafi 114.

të artikujve në një gazetë, Gjykata shprehu mendimin se neni 10:

nuk ndalon shprehimisht vendosjen e kufizimeve paraprake për publikimet si të tilla.... Nga ana tjetër, rreziqet që fshihen në kufizimet paraprake janë të tilla që të kërkojnë një kontroll tepër të kujdesshëm nga ana e Gjykatës. Kjo vlen posaçërisht nëse bëhet fjalë për shtypin, pasi lajmet janë një mall që priset dhe vonesa e publikimit të tij, edhe për një periudhë të shkurtër, mund t'i heqë atij të gjithë vlerën dhe interesin⁸⁸.

Kufizimet paraprake mund të vendosen vetëm për një kohë të kufizuar, pas një shqyrtimi dhe justifikimi të detajuar dhe bazuar në rregullimet e qarta dhe të parashikueshme të brendshme⁸⁹.

Kërkesa për autorizim paraprak para publikimit, tipike për diktaturat, nuk është pranuar asnjëherë në shoqëritë demokratike dhe është në përgjithësi në papajtueshmëri me nenin 10⁹⁰.

Refuzimi për regjistrimin e një titulli të një organi periodik është një shembull i qartë i censurës para publikimit. Siç ka deklaruar Komisioni në çështjen *Gawęda kundër Polonisë*, një masë e tillë “është e barasvlershme me refuzimin e publikimit të saj⁹¹. Gjykatat vendase kishin refuzuar të regjistronin dy prej publikimeve të kërkuesve për shkak se titujt e tyre “do të ishin në konflikt me realitetin”. Gjykata konstatoi një shkelje të nenit 10 mbi bazën që ligji që rregullon regjistrimin e periodikëve nuk ishte i qartë dhe i parashikueshëm në masë të mjaftueshme. Në këtë kontekst, Gjykata u shpreh:

Ligji përkatës duhet të ketë një tregues të qartë të rrethanave kur këto kufizime janë të lejueshme dhe, *a fortiori*, kur pasojat e kufizimit janë për bllokimin e një publikimi tërësisht, siç është rasti konkret. Kjo ndodh për shkak të kërcënimit potencial që këto kufizime paraprake, për vetë natyrën e tyre, përbëjnë për lirinë shprehjes të garantuar nga neni 10⁹².

Në larminë e ndërhyrjeve të liria e shprehjes pasi të ketë ndodhur shprehja, fajësimi dhe dënimi penal janë mbase më të rrezikshmit. Në çështjen *Castells kundër Spanjës*, kërkuesi, anëtar i opozitës parlamentare, u dënua me burgim për shkak të fyerjes së qeverisë spanjolle, që ai e kishte akuzuar në gazetë si “kriminale” dhe që fshihte autorët e krimit kundër Rajonit Bask. Përkundrejt këtij sfondi faktik, Gjykata u shpreh se:

⁸⁸ *The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Nr. 2), 26 nëntor 1991; paragrafi 51; *Observer dhe Guardian kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 26 nëntor 1991.

⁸⁹ *RTBF kundër Belgjikës*, 29 mars 2011.

⁹⁰ Detyrimi ligjor për rishikimin para publikimit të intervistave u kritikua nga Gjykata në çështjen *Wizerkaniuk kundër Polonisë*, 5 korrik 2011.

⁹¹ *Gawęda kundër Polonisë*, raport i Komisionit, 4 dhjetor 1998, paragrafi 39.

⁹² *Gawęda kundër Polonisë*, vendim i datës 14 mars 2002, paragrafi 40.

Pozicioni dominues që ka Qeveria e bën të nevojshme që ajo të demonstrojë vetëpërbajtje në zbatimin e procedimeve penale, posaçërisht kur ka mjete të tjera për të kundërvepruar ndaj sulmeve të pajustificuara dhe kritikave të kundërshtarëve të saj në media⁹³.

Dëmshpërblimi civil i dhënë për dëmet e shkaktuara ndaj dinjitetit ose nderit të të tjerëve mund të përbëjë ndërhyrje të qartë tek ushtrimi i lirisë së shprehjes, pavarësisht nga një dënim penal.

Procedimet disiplinore që rezultojnë në ndalimin e çdo shprehjeje kritike në profesionin e mjekut nuk janë në pajtueshmëri me lirinë e shprehjes⁹⁴. Kritika disiplinore e një mjeku, i cili ka shkaktuar shqetësime publike në lidhje me vendimet e marra nga eprori i tij/saj dhe cilësinë e kujdesit mjekësor të dhënë pacientëve të tij, mund të rezultojë gjithashtu në shkeljen e nenit 10⁹⁵.

Konfiskimi ose sekuestrimi i mjeteve nëpërmjet të cilave është shpërndarë informacioni ose idetë është një ndërhyrje tjetër e mundshme. Momenti se kur janë vendosur ose ekzekutuar këto masa, para apo pas momentit të shpërndarjes, nuk ka rëndësi. Kështu, Gjykata ka vendosur që konfiskimi i përkohshëm i pikturave të konsideruara si të pahijshme nga gjykatat e brendshme përbënte ndërhyrje të liria e shprehjes së piktorit⁹⁶. Po ashtu, sekuestrimi i një filmi të konsideruar nga autoritetet e brendshme se përmbante skena të pahijshme u përkufizua nga Gjykata si ndërhyrje në lirinë e shprehjes⁹⁷. Sekuestrimi i librave të konsideruar se përmbajnë fragmente të pahijshme mori një trajtim të njëjtë nga Gjykata⁹⁸.

Ndalimi i reklamës, në rrethana të caktuara, është konsideruar nga Gjykata si ndërhyrje në të drejtën e shprehjes. Në çështjen *Barthold kundër Gjermanisë*, kërkuesi ishte kirurg veterinar i mundësisë së fundit për pronarët e një maceje të sëmurë, për shkak se vetëm ai kishte shërbim emergjence në Hamburg. Ai u intervistua nga një gazetar, i cili pastaj shkroi një artikull në lidhje me këtë boshllëk që ndikon në mirëqenien e kafshëve në rajon. Kolegët veterinerë të dr. *Barthold-it* filluan procedimin ligjor ndaj tij në pajtim me ligjin e konkurrencës së pandershme duke pretenduar se ai kishte nxitur ose toleruar publicitetin në emër të vet. Gjykata konstatoi se kjo çështje ishte në lidhje me diskutimin publik të një çështjeje problematike dhe jo të reklamës tregtare dhe konstatoi se dënimi i kërkuesit ishte i pajustificuar:

⁹³ *Castells kundër Spanjës*, 23 prill 1992, paragrafi 46.

⁹⁴ *Frankowicz kundër Polonisë*, 16 dhjetor 2008, paragrafi 51.

⁹⁵ *Sosinowska kundër Polonisë*, 18 tetor 2011.

⁹⁶ *Müller dhe të Tjerë kundër Zvicrës*, 24 maj 1988.

⁹⁷ *Otto-Preminger-Institut kundër Austrisë*, 20 shtator 1994.

⁹⁸ *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 7 dhjetor 1976.

(Dënimi i dr. Barthold-it) rrezikon dekurajimin e anëtarëve të tjerë të profesioneve liberale për të kontribuar në debatin publik për tema që prekin jetën e komunitetit, nëse ekziston edhe mundësia më e vogël që deklarimet e tyre të trajtohen sikur shkaktajnë një efekt reklamues në një shkallë të caktuar. Me të njëjtën njësi matëse, zbatimi i një kriteri si ky mund të pengojë shtypin në përbushjen e detyrave të tij si shpërndarës i informacionit dhe si rojtar publik⁹⁹.

Gjykata ka një praktikë të gjerë gjyqësore në lidhje me reklamimin e paguar politik. Në disa raste, Gjykata ka vendosur se ndalimi i reklamimit të paguar politik përbën shkelje të lirisë së shprehjes sipas nenit 10 dhe mund të shkelë lirinë e shprehjes për partitë e vogla politike, pasi ato marrin mbulimin minimal në medien e redaktuar dhe në këtë mënyrë reklama e paguar mund të jetë e vetmja mënyrë për to për të përfutur mbulim. Megjithatë, në një vendim të mëvonshëm, Gjykata e zbuti vendimin e saj, duke vendosur që një ndalim mbi reklamën politike përbën një përpjekje të lejuar për të “mbrojtur debatin dhe procesin demokratik nga deformimi i grupeve të fuqishme financiare me akses të privilegjuar në medien e fuqishme”¹⁰⁰.

Natyrisht që një artikull në gazetë mund të jetë i barasvlershëm me reklamën. Objektet që bazohen në profilet e marrëdhënieve me publikun do të shiheshin më shumë si shprehje komerciale. Për shembull, në çështjen *Casado Coca kundër Spanjës*, shpërndarja e materialit të reklamës nga një avokat që ishte bërë shkak për procedim disiplinor ndaj tij u konsiderua nga Gjykata si shprehje komerciale¹⁰¹. Njoftimet e publikuara nga avokati jepnin vetëm emrin, profesionin, adresën dhe numrin e telefonit të kërkuesit. Ato u publikuan me synim reklame dhe i jepnin personave që kërkonin ndihmë juridike informacion të dobishëm, që mund të lehtësonte aksesin e tyre në drejtësi. Masa disiplinore u bazua në ndalimin e reklamës së vendosur nga statuti i Dhomës spanjolle, Dhoma e Barcelonës dhe vendimet e këshillit të saj. Megjithatë, Gjykata konstatoi se shtetet anëtare kanë një hapësirë të gjerë vlerësimi në lidhje me ndalimin e llojeve të caktuara të reklamës.

Shprehja komerciale, megjithëse e mbrojtur nga neni 10, i nënshtrohet standardeve të ndryshme të kontrollit nga ato të llojeve të shprehjes. Për shembull, në çështjen *Markt Intern Verlag GmbH dhe Klaus Beermann kundër Gjermanisë*, Gjykata la në fuqi një masë ndaj një reviste tregtare duke e ndaluar atë në publikimin e informacionit në lidhje me ndërmarrjet që operonin në tregun e saj. Duke argumentuar se kjo ishte një ndërhyrje në lirinë e shprehjes komerciale, Gjykata u lejoi autoriteteve vendase një hapësirë më të

⁹⁹ *Barthold kundër Gjermanisë*, 25 mars 1985, paragrafi 58.

¹⁰⁰ *Animal Defenders International kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 22 prill 2013 dhe *TV Vest AS & Rogaland Pensjonistparti kundër Norvegjisë*, 11 dhjetor 2008 (GC).

¹⁰¹ *Casado Coca kundër Spanjës*, 24 shkurt 1994.

gjerë vlerësimi dhe e konsideroi masën mbrojtëse në pajtim me kërkesat e paragrafit 2 të nenit 10:

edhe publikimi i objekteve që janë të vërtetë dhe përshkruajnë ngjarje reale mund të ndalohen në rrethana të caktuara: detyrimi për të respektuar jetën private të të tjerëve ose detyrimi për të respektuar konfidencialitetin e informacionit të caktuar tregtar janë disa shembuj¹⁰².

Megjithatë, disa mendime të pakicës argumentuan se nuk kishte shkak për të zgjeruar hapësirën e vlerësimit të shtetit.

Vetëm në raste të rralla mund të pranohet një censurë ose ndalim i publikimeve. Kjo është posaçërisht e vërtetë në lidhje me reklamën tregtare ose çështjet e politikës ekonomike ose tregtare ... Mbrojtja e interesave të përdoruesve ose konsumatorëve përballë pozicioneve dominuese varet nga liria e publikimit të kritikave më të ashpra për produktet¹⁰³.

Pavarësisht nga vendimi i bazuar në paragrafin 2, shprehja komerciale mund të mbrohet sipas nenit 10 dhe në këtë mënyrë ndalimi ose sanksioni përbën ndërhyrje të liria e shprehjes.

Një urdhër për të treguar burimet gazetareske dhe dokumentet si dhe ndëshkimi i dhënë nëse kjo refuzohet, konsiderohet nga Gjykata si një ndërhyrje në ushtrimin e lirisë së shprehjes. Në çështjen *Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, gjykata vuri re se këto masa pa diskutim që ndërhyjnë në lirinë e shtypit dhe vendosi në favor të gazetarit¹⁰⁴.

Kontrolli i mjediseve të një gazete ose transmetuesi është një formë tjetër ndërhyrjeje të liria e shtypit. Pavarësisht nëse bazohet në një urdhër të ligjshëm apo jo, një kontroll i tillë nuk do të rrezikonte vetëm konfidencialitetin e burimeve gazetareske, por do të vinte në rrezik të gjithë medien dhe do të funksiononte si censurë për të gjithë gazetarët në vend¹⁰⁵.

¹⁰² *Markt intern Verlag GmbH dhe Klaus Beermann kundër Gjermanisë*, 20 nëntor 1989, paragrafi 35.

¹⁰³ Gjyqtar *Pettiti*, mendim pakice.

¹⁰⁴ *Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 27 mars 1996 (GC); informacioni më tejshëm në lidhje me çështjen dhe mbrojtjen e burimeve gazetareske del në seksionin mbi "Mbrojtjen e burimeve gazetareske".

¹⁰⁵ *Sanoma Uitgevers B.V kundër Holandës*, 14 shtator 2010 (GC).

4.4. Parashikuar me ligj

” Ushtrimi i këtyre lirive mund t’u nënshtrohet ... kufizimeve ose ndëshkimeve sipas parashikimit në ligj

Në pajtim me këtë kërkesë, çdo ndërhyrje në ushtrimin e lirisë së shprehjes duhet të ketë në bazë një ligj të brendshëm. Si rregull, ky do të ishte një ligj i shkruar dhe publik i miratuar nga parlamenti. Një parlament i brendshëm duhet të vendosë nëse do të mund të jetë i mundur një kufizim i tillë. Për shembull, në një çështje në lidhje me një gazetar të dënuar për shpifje, krimi i shpifjes duhet të jetë i parashikuar në ligjin e brendshëm. Ose, nëse urdhërohet apo ekzekutohet ndalimi i publikimit ose sekuestrimi i mjeteve nëpërmjet të cilave mbartet kjo shprehje – si: librat, gazetat ose kamerat - këto masa duhet të mbështeten në dispozita ligjore të brendshme. Po ashtu, nëse kontrollohen mjediset e një gazete ose mbyllet një stacion transmetimi, dispozitat ligjore në ligjin e brendshëm duhet të jenë si bazë për këto masa.

Gjykata ka pranuar në vetëm pak raste se rregullat *common law* ose parimet e së drejtës ndërkombëtare përbëjnë një bazë për ndërhyrje në lirinë e shprehjes. Për shembull, në çështjen *The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata konstatoi se dispozitat e *common law* në Britani në lidhje me mosbindjen e gjykatës ishin të sakta në një masë të mjaftueshme për t’u përfshirë nën kërkesën e “parashikuar me ligj”¹⁰⁶. Pra, në çështjen *Groppera Radio AG dhe të Tjerë kundër Zvicrës*¹⁰⁷ dhe *Autronic AG kundër Zvicrës*¹⁰⁸, Gjykata e lejoi shtetin të mbështetej në rregullat e zbatuara brenda vendit të së drejtës ndërkombëtare me qëllim që të përmbushej kjo kërkesë. Megjithëse nuk mund të përjashtohet se rregullat *common law* ose të së drejtës zakonore mund të kufizojnë lirinë e shprehjes, ky duhet të jetë më shumë një përjashtim i rrallë. Liria e shprehjes është një vlerë kaq e rëndësishme sa kufizimi i saj duhet të marrë gjithmonë legjitimitetin e debateve dhe zgjedhjeve parlamentare.

Kjo kërkesë i referohet gjithashtu cilësisë së ligjit, edhe nëse miratohet nga parlamenti; Gjykata është shprehur në mënyrë të qëndrueshme që një ligj duhet të jetë publik, i aksesueshëm, i arsyeshëm dhe i parashikueshëm. Siç theksohet në çështjen *The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar*:

së pari, ligji duhet të jetë i aksesueshëm në mënyrë të përshtatshme: një qytetar duhet të jetë në gjendje të ketë një tregues që të jetë i përshtatshëm në

¹⁰⁶ Megjithatë, pas vendimit të Gjykatës, legjislati formali është miratuar për këtë fushë.

¹⁰⁷ *Groppera Radio AG dhe të Tjerë kundër Zvicrës*, 28 mars 1990.

¹⁰⁸ *Autronic AG kundër Zvicrës*, 22 maj 1990.

rrethanat e rregullave ligjore të zbatueshme në një çështje të caktuar. Së dyti, një normë nuk mund të konsiderohet si “ligj”, përveç kur është e formuluar në mënyrë të tillë që bën të mundur rregullimin e sjelljes së qytetarit: ai duhet të jetë në gjendje – nëse është e nevojshme me këshillim të përshtatshëm - të parashikojë, në një shkallë të arsyeshme në rrethanat përkatëse, pasojat që mund të sjellë një veprim i caktuar. Këto pasoja nuk janë të domosdoshme të parashikohen me saktësi absolute: eksperiencia tregon se një gjë e tillë është e paarritshme. Po ashtu, megjithëse saktësia është tepër e dëshirueshme, ajo në vetvete mund të sjellë një ngurtësim të tepërt dhe ligji duhet të jetë në gjendje të ndjekë rrethanat që ndryshojnë. Për pasojë, shumë ligje shprehen në terma të tillë që, pak a shumë, janë të përcaktuar dhe interpretimi dhe zbatimi i tyre është çështje e praktikës¹⁰⁹.

Megjithëse në çështjen *The Sunday Times* Gjykata konstatoi se dispozitat e *common law* e përmbushnin kërkesën e “të qenit ligj”, duke pasur parasysh këshillimin ligjor të marrë nga kërkuesi, në çështjen *Rotary kundër Gjermanisë*, Gjykata konstatoi se ligji i brendshëm nuk ishte “ligj” për shkak se nuk ishte “formuluar me saktësi të mjaftueshme për t’i dhënë mundësi individit - eventualisht me këshillim të përshtatshëm - të rregullonte sjelljen e tij”¹¹⁰. Në çështjen *Petra kundër Rumanisë*¹¹¹, Gjykata vendosi që “dispozitat e brendshme të zbatueshme për monitorimin e korrespondencës së të burgosurve ... u linin autoriteteve të brendshme shumë liri veprimi” dhe rregullimet për respektimin e konfidencialitetit “nuk përmbushnin kërkesën e aksesueshmërisë... dhe ligji rumun nuk e tregonte qartë objektin dhe mënyrën e ushtrimit të diskrecionit që u ishte dhënë autoriteteve publike”. Megjithëse te vendimet *Rotaru dhe Petra* Gjykata shqyrtoi dhe konstatoi shkelje të nenit 8 të Konventës (e drejta e privatësisë), ajo përdori të njëjtat standarde si ato për shqyrtimin e ligjeve të brendshme në lidhje me lirinë e shprehjes.

Një çështje e rëndësishme sipas nenit 10 mbi cilësinë e ligjit është *Gaweda kundër Polonisë*, ku gjykatat refuzuan të lejonin që kërkuesi të regjistronte dy periodikë, duke argumentuar se titujt e tyre ishin “në konflikt me realitetin”. Titujt ishin: “*E përmuajshmjia sociale dhe politike - një tribunë morali europian*” dhe “*Gjermania - armiku njëmijë-vjeçar i Polonisë*”. Në lidhje me publikimin e parë, gjykatat e brendshme refuzuan regjistrimin bazuar në argumentin se titulli i propozuar “do të sugjeronte një institucion europian të themeluar në Kety, që ishte qartësisht jo e vërtetë”. Regjistrimi i publikimit të dytë u refuzua me argumentin që titulli “nuk do të ishte në pajtueshmëri me gjendjen e vërtetë të rrethanave dhe fokusohet në mënyrë të parregullt mbi aspektet negative të marrëdhënieve polake-gjermane dhe në këtë mënyrë jepte një

¹⁰⁹ *The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 26 prill 1979, paragrafi 49.

¹¹⁰ *Rotaru kundër Rumanisë*, 4 maj 2000, paragrafi 55.

¹¹¹ *Petra kundër Rumanisë*, 23 shtator 1998, paragrafët 37-38.

pamje të paekuilibruar të fakteve”. Gjykata vuri re se gjykatat e brendshme:

u bazuan te koncepti “në papajtueshmëri me gjendjen e vërtetë të rrethanave” ... si një legjitimim për të refuzuar regjistrimin nëse do të mendojnë që një titull nuk e kalon testin e së vërtetës, d.m.th., titulli i propozuar i periodikëve tregonte një pamje thelbësisht të gabuar.

Kërkesa që një titull i një reviste të mishërojë informacion të vërtetë:

është, së pari, e papërshtatshme nga këndvështrimi i lirisë së shtypit. Titulli i një periodiku nuk është një deklaratë si e tillë, meqenëse funksioni i saj në thelb është të identifikojë periodikun përkatës në tregun e shtypit për lexuesit faktikë dhe të ardhshëm. Së dyti, një interpretim i tillë do të kërkonte një dispozitë legislative për ta autorizuar këtë qartazi. Me pak fjalë, interpretimi i dhënë nga gjykatat u bë shkak për kritere të reja, që nuk mund të parashikoheshin mbi bazën e tekstit që specifikon situata në të cilat mund të refuzohej regjistrimi i një titulli.

Gjykata, për më tepër, pranoi se karakteri gjyqësor i regjistrimit ishte një garanci e vyer e lirisë së shtypit, por ajo u shpreh se vendimet e gjykatave duhet të respektojnë parimet e nenit 10. Gjykata konstatoi se ligji, i cili u jepte gjykatave kompetencën të refuzonin regjistrimin nëse ai do të ishte “në konflikt me realitetin”, nuk ishte “formular me saktësi të mjaftueshme për të bërë të mundur që kërkuesi të rregullojë sjelljen e tij”¹¹².

Gjykata ka interpretuar gjithashtu bazën ligjore të një regjistrimi ku janë marrë masat e mbikëqyrjes së fshehtë ndaj individëve¹¹³. Kështu, në çështjen *Roman Zakharov kundër Rusisë*, Gjykata u shpreh se fraza:

Parashikueshmëria në kontestin e posaçëm të masave të fshehta të mbikëqyrjes, si përgjimi i komunikimeve, nuk mund të ketë kuptimin që individi duhet të jetë në gjendje të parashikojë kur autoritetet mund të përgjojnë komunikimet e tij, në mënyrë që ai të përshtatë sjelljen e tij. Megjithatë, nëse një kompetencë që i vishet ekzekutivit ushtrohet në mënyrë të fshehtë, rreziqet e arbitraritetit janë të dukshme. Kjo është arsyeja se pse është e rëndësishme pasja e rregullave të qarta dhe të hollësishme për përgjimin e bisedave telefonike, posaçërisht ku teknologjia e disponueshme për përdorim po sofistikohet gjithnjë e më shumë. Ligji i brendshëm duhet të jetë i qartë në masë të mjaftueshme për t’u dhënë qytetarëve një tregues të përshtatshëm në lidhje me rrethanat dhe kushtet në të cilat autoritetet publike autorizohen të zbatojnë masa të tilla¹¹⁴.

¹¹² *Gawęda kundër Polonisë*, vendim i datës 14 mars 2002, paragrafët 43 dhe 48.

¹¹³ *Malone kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2 gusht 1984.

¹¹⁴ *Roman Zakharov kundër Rusisë*, 4 dhjetor 2015 (GC), paragrafi 229.

Në vendimin *Leander kundër Suedisë*, Gjykata u shpreh se edhe në sferat që preknin sigurinë kombëtare ose të luftës kundër krimit të organizuar, ku karakteri i parashikueshëm i ligjit mund të jetë më i dobët (për efektivitetin e hetimeve, për shembull), teksti i ligjit duhet të jetë i qartë aq sa t'u japë individëve një tregues të përshtatshëm për sjelljen e ligjshme dhe pasojat e të vepruarit në mënyrë të ligjshme. Përveç kësaj, në këtë vendim të fundit, Gjykata u shpreh që “në vlerësimin nëse është i përmbushur kriteri i parashikueshmërisë, duhet të merren parasysh edhe udhëzimet edhe praktikatat administrative që nuk kanë statusin e ligjit lëndor, në masën që personat e interesuar të jenë në dijeni në masë të mjaftueshme për përmbajtjen e tyre.” Gjykata po ashtu theksoi:

Nëse zbatimi i ligjit ka të bëjë me masat e fshehta, që nuk janë të hapura për t'u shqyrtuar nga individët e interesuar apo publiku i gjerë, vetë ligji, ndryshe nga praktikatat shoqëruese administrative, duhet të tregojë hapësirën e çdo diskrecioni të dhënë autoriteteve kompetente me qartësi të mjaftueshme, duke pasur parasysh qëllimin legjitim të masave në fjalë, për t'u dhënë individëve mbrojtje të përshtatshme ndaj ndërhyrjeve arbitrare¹¹⁵.

Kështu, gjykatat e brendshme duhet të shqyrtojnë cilësinë e ligjeve, norma të tjera, praktika ose praktikën gjyqësore që ofron shkaqe për një kufizim të ushtrimit të lirisë së shprehjes. Ato duhet të shohin së pari kërkesat e aksesueshmërisë, që normalisht do të përmbusheshin nëse publikohet ligji përkatës. Rregullat e brendshme ose normat e tjera të pabotuara nuk do t'i përmbushnin këto kërkesa nëse individit përkatës nuk është në dijeni të ekzistencës dhe përmbajtjes së tyre. Vlerësimi i arsyeshmërisë dhe karakterit të parashikueshëm të dispozitave ligjore ose praktikës gjyqësore duket se është më i përparuar. Gjykatat duhet të shqyrtojnë nëse dispozita përkatëse është e hartuar qartazi në masë të mjaftueshme dhe me terma të saktë, me koncepte të mirë-përkufizuara, që mundëson ndërlidhjen e veprimeve me kërkesat e ligjit dhe të përkufizojë qartazi sferën e sjelljes së ndaluar dhe pasojat në rast shkeljeje të dispozitës përkatëse. Normat ligjore që autorizojnë autoritetet publike për të urdhëruar dhe zbatuar masa të fshehta ndaj individëve, si: mbikëqyrja e fshehtë, duhet të shqyrtohen me imtësi nga gjykatat, pasi këto masa janë ndërhyrjet më të rrezikshme në të drejtat e njeriut.

Nëse gjykatat e brendshme përballen me legjislacion kontradiktor, siç mund të jetë ndërmjet ligjeve dhe rregulloreve të tjera të miratuara nga autoritetet lokale dhe ligjeve federale dhe/ose kushtetutës, gjyqtarët mund të zbatojnë

¹¹⁵ *Leander kundër Suedisë*, 26 mars 1987, paragrafi 51.

dispozitat ligjore që garantojnë më mirë gëzimin e lirë të lirisë së shprehjes. Për më tepër të gjitha ligjet e brendshme duhet të interpretohen në pajtim me praktikën gjyqësore dhe parimet e Gjykatës së Strasburgut dhe, kur ekzistojnë kontradikta të qarta, duhet të mbizotërojë ligji evropian.

4.5. Qëllimi legjitim

” Ushtrimi i këtyre lirive ... mund t’u nënshtrohet ... kufizimeve që janë të nevojshme ... në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial; sigurisë publike; parandalimit të trazirave ose krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, për mbrojtjen e reputacionit ose të drejtave të tjerëve, për parandalimin e deklarimit të informacionit të marrë në mirëbesim, ose për ruajtjen e autoritetit dhe paanësisë së gjyqësorit

Lista e shkaqeve të mundshme për kufizimin e lirisë së shprehjes është shteruese. Autoritetet e brendshme mund të mos mbështeten në mënyrë legjitime në lidhje me shkaqe të tjera që dalin jashtë listës së parashikuar në paragrafin 2. Kështu, nëse do të kërkohet të zbatohet një dispozitë që do të ndërhynte në një formë të caktuar të liria e shprehjes, gjykatat e brendshme do të duhet të identifikojnë vlerën ose interesin e mbrojtur nga dispozita përkatëse dhe të verifikojnë nëse ai interes ose vlerë është një prej atyre të renditura në paragrafin 2. Vetëm nëse përgjigjja është pohuese atëherë gjykatat mund ta zbatojnë atë dispozitë për individin përkatës. Për shembull, një akuzë penale apo padi civile e paraqitur ndaj një gazetari të akuzuar për dëmtimin e reputacionit ose nderit të dikujt do të ketë një qëllim legjitim të mbrojtjes së “reputacionit ose të të drejtave të të tjerëve”. Ose, sekuestrimi i një libri të pahijshëm mund të ketë qëllimin legjitim të mbrojtjes së “moralit”. Një urdhër ndalimi i përkohshëm ndaj një gazete që publikon informacion të klasifikuar mund të justifikohet se është në interes të “sigurisë kombëtare”. Megjithatë, gjykatat duhet të garantojnë që interesi që mbrohet të jetë i vërtetë, dhe jo thjesht dhe vetëm një mundësi.

Nëse gjykatat e brendshme janë të bindura që një qëllim legjitim përbën shkak për ndërhyrje te liria e shprehjes, ato duhet të shohin kërkesën e tretë të paragrafit 2, siç bën edhe Gjykata, dhe të vendosin nëse një ndërhyrje e tillë është “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, në vijim të parimeve tejet të zhvilluara të Gjykatës.

4.6. I nevojshëm në një shoqëri demokratike

” Ushtrimi i këtyre lirive... mund t’u nënshtrohet ... atyre kufizimeve që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike

Gjykatat e brendshme, me qëllim që të merret një vendim sipas kësaj kërkesë të tretë, duhet të zbatojnë parimin e proporcionalitetit duke iu përgjigjur pyetjes së mëposhtme: “A ishte qëllimi proporcional me mjetet e përdorura për të arritur këtë qëllim?” “Në këtë ekuacion, “qëllimi” është një ose disa prej vlerave dhe interesave të parashikuara nga paragrafi 2 për mbrojtjen e të cilit shtetet mund të ndërhyjnë te liria e shprehjes. “Mjeti” është vetë ndërhyrja. Kështu, “qëllimi” është ai interes specifik që citohet nga shteti, siç është “siguria kombëtare”, “rendi”, “moralin”, “të drejtat e të tjerëve” etj. “Mjeti” është masa e posaçme e miratuar ose zbatuar ndaj një individi që ushtron të drejtën e tij/saj të shprehjes. Për shembull, një “mjet” mund të jetë: një ndëshkim penal për një fyerje ose shpifje; një urdhër për të paguar dëmshpërblim civil; një masë e përkohshme ndaj publikimit; ndalimi i profesionit të gazetarit; kontrolli i mjediseve të një gazete; sekuestrimi i mjeteve nëpërmjet të cilave shprehet një mendim etj.

Vendimi i proporcionalitetit bazohet në parimet e qeverisjes së shoqërisë demokratike. Me qëllim që të provohet që ndërhyrja ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, gjykatat e brendshme, si dhe Gjykata e Strasburgut, duhet të binden që ekziston një “nevojë sociale urgjente”, që kërkon kufizimin e posaçëm të ushtrimit të lirisë së shprehjes. Në çështjen *Observer dhe Guardian kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata u shpreh se “mbiemri ‘i nevojshëm’ brenda kuptimit të nenit 10, paragrafi 2, nënkupton ekzistencën e një ‘nevoje sociale urgjente’”¹¹⁶.

Të parat që duhet të vlerësojnë ekzistencën e një nevoje sociale urgjente janë autoritetet e brendshme, të cilat, kur e bëjnë këtë, duhet të respektojnë praktikën gjyqësore të Gjykatës. Megjithatë, në lidhje me këtë, Gjykata u shpreh se:

Shtetet Kontraktuese kanë një hapësirë të caktuar për të vlerësuar nëse ekzistojnë këto nevoja, por kjo shkon krahas me mbikëqyrjen europiane, që përfshin si ligjin ashtu edhe vendimet zbatuese të tij, madje edhe ato të dhëna nga gjykatat e pavarura¹¹⁷.

¹¹⁶ *Observer dhe Guardian kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 26 nëntor 1991.

¹¹⁷ *Lingens kundër Austrisë*, 8 korrik 1986; *Janowski kundër Polonisë*, 21 janar 1999; *Tammer kundër Estonisë*, 6 shkurt 2001.

Kështu Gjykata ka tagrin të japë një vendim përfundimtar nëse një “kufizim” është i pajtueshëm me lirinë e shprehjes së mbrojtur nga neni 10. Mesazhi për gjykatat e brendshme është që ato duhet të ndjekin praktikën gjyqësore të Gjykatës nga seanca e parë në një çështje në lidhje me lirinë e shprehjes. Meqenëse standardet europiane, si praktika gjyqësore e Gjykatës, i ofrojnë lirisë së shprehjes një nivel më të lartë mbrojtjeje se ligji dhe praktika gjyqësore e brendshme, të gjithë gjyqtarët nuk mund të bëjnë gjë tjetër veçse të zbatojnë standardet më të larta europiane.

Arsyetimi i gjykatës në gjetjen e përgjigjes për pyetjet “nëse kufizimi ka qenë i nevojshëm në një shoqëri demokratike?” ose a “ka qenë qëllimi proporcional me mjetin?” do të shqyrtohet më tej duke marrë parasysh secilën prej “qëllimeve” legjitime të renditura në paragrafin 2. Me sa duket, “mjetet” në të gjitha këto raste do të jenë të njëjtat: ndërhyrja te liria e shprehjes. Në vlerësimin e proporcionalitetit, Gjykata do të marrë posaçërisht parasysh rrethanat e publikimit, ekzistencën e interesit publik dhe ashpërsinë e sanksionit.

Kapitulli 5

Kufizimet për shkaqe “publike”

“Siguria kombëtare”, së bashku me “sigurinë publike” dhe “të drejtat e të tjerëve”, janë konsideruar si mbizotëruese ndaj interesit të mbrojtjes së lirisë së shprehjes në çështjet kur shprehja e sanksionuar nga autoritetet e brendshme synonte asgjësimin e të drejtave të parashikuara në Konventë.

5.1. Liria e shprehjes dhe siguria kombëtare

Një nga çështjet madhore ku shkak i “sigurisë kombëtare” u përdor për të kufizuar lirinë e shprehjes është *Observer dhe Guardian kundër Mbretërisë së Bashkuar*¹¹⁸. Në vitin 1986, të dyja këto gazeta deklaruan synimin e tyre për të publikuar pjesë nga “*Spycatcher*”, një libër nga *Peter Wright*, një agjent në pension i shërbimeve të fshehta. Në momentin e deklarimit, libri nuk ishte botuar ende. Libri i z. *Wright* përfshinte një raport mbi aktivitetet e konsideruara të paligjshme të shërbimit të fshehtë britanik dhe agjentëve të tij. Ai pohoi që MI5 kishte përgjuar të gjitha konferencat ndërkombëtare në Londër përgjatë viteve 1950 dhe 1960, si dhe bisedimet për pavarësinë e Zimbabvesë në vitin 1979; që MI5 kishte përgjuar diplomatë në Francë, Gjermani, Greqi dhe Indonezi, si dhe suitën e hotelit të Hrushovit gjatë vizitës së tij në Britani në vitin 1950; që MI5 kishte hyrë me forcë dhe vendosur përgjues në konsullatat sovjetike jashtë shtetit; që MI5 ishte përpjekur pa sukses të vriste Presidentin *Nasser* të Egjiptit në momentin e krizës së Suezit; që MI5 kishte ngritur kurth ndaj *Harold Wilson-it* gjatë mandatit të tij si kryeministër nga viti 1974 deri 1976; dhe që MI5 i kishte kanalizuar burimet e veta për të hetuar grupimet politike të majta në Britani.

Prokurori i përgjithshëm u kërkoi gjykatave të nxirrnin një urdhër ndalimi të përhershëm ndaj gazetave, duke i penguar ato të publikonin pjesë nga libri. Në korrik të vitit 1986, gjykatat nxorën një urdhër të përkohshëm që i pengonte gazetat të publikonin në lidhje me urdhrin gjyqësor gjatë zhvillimit të procesit.

¹¹⁸ *Observer dhe Guardian kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 26 nëntor 1991.

Në korrik të vitit 1987, libri u botua në Shtetet e Bashkuara dhe kopje të tij qarkullonin edhe në Mbretërinë e Bashkuar. Megjithëkëtë, urdhrat e përkohshëm ndaj gazetave ishin mbajtur në fuqi deri në vitin 1988, kur Dhoma e Lordëve refuzoi të miratonte urdhrin e përhershëm të kërkuar nga prokurori i përgjithshëm.

“The Observer” dhe *“The Guardian”* u ankuan tek organet e Strasburgut ndaj masave të përkohshme. Qeveria britanike argumentoi që në momentin kur u urdhëruan masat e përkohshme, informacioni ku *Peter Wright* kishte akses ishte konfidencial. Nëse do të botohej ky informacion, shërbimi i fshehtë britanik, agjentët e tij dhe palët e treta do të pësonin dëme të konsiderueshme pas identifikimit të agjentëve; marrëdhëniet me vendet aleate, organizatat dhe të tjerë do të dëmtoheshin; dhe këta nuk do të besonin më në shërbimin e fshehtë britanik. Përveç kësaj, Qeveria përparoi me argumentin që ka pasur rrezik që agjentë të tjerë të tanishëm ose të mëparshëm do të pasonin veprimin e z. *Wright*. Për periudhën pas publikimit, qeveria u mbështet në nevojën e garantimit të shteteve aleate për mbrojtjen efektive të informacionit nga shërbimet e fshehta britanike. Sipas mendimit të qeverisë, e vetmja mënyrë për të dhënë një garanci të tillë ishte për ta bërë të qartë që oficerët që kërcënonin të shkelnin detyrimin e tyre të përjetshëm të konfidencialitetit do të pengoheshin në mënyrë të efektshme nga kjo nëpërmjet akuzës gjyqësore, dhe që një masë e tillë do të ndërmerrej.

Në lidhje me kufizimet e mëparshme të publikimit, Gjykata u shpreh se:

Rreziqet që fshihen në kufizimet paraprake janë të tilla që ato kërkojnë një kontroll tepër të kujdesshëm nga ana e Gjykatës. Kjo vlen posaçërisht nëse bëhet fjalë për shtypin, pasi lajmet janë një mall që priset dhe vonesa e publikimit të tij, edhe për një periudhë të shkurtër, mund t’i heqë atij të gjithë vlerën dhe interesin¹¹⁹.

Gjykata më tej konstatoi se masat e përkohshme ishin të justifikuar para publikimit të librit, por jo pas këtij momenti. Pas publikimit të tij në Shtetet e Bashkuara, informacioni e kishte humbur karakterin e tij konfidencial dhe, në këtë mënyrë, interesi për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit të *“Spycatcher”* dhe mbajtjen e tij jashtë vëmendjes së publikut nuk ekzistonte më. Në këto rrethana, nuk kishte nevojë “të mjaftueshme” për të mbajtur në fuqi masat ndaluese.

Në mendimin e pakicës, gjyqtari *Pettiti* deklaroi se masat e përkohshme nuk justifikoheshin as para botimit të librit jashtë Mbretërisë së Bashkuar: “ku

¹¹⁹ Paragrafi 60.

shtypi është i shqetësuar që një vonesë në lidhje me pikat e punëve aktuale i heq artikullit të gazetarit një pjesë të madhe të interesit”. Gjyqtari deklaroi më tej se:

Të krijohet përshtypja sikur ashpërsia ekstreme e masës së përkohshme dhe natyrisht e miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm, nuk ishte aq shumë çështje e detyrimit të konfidencialitetit se sa frika e deklarimit të parregullsive të kryera nga shërbimet e sigurisë që ndiqnin më shumë qëllime politike se qëllime të shërbimeve të fshehta.

Sipas mendimit të gjyqtarit *Pettiti*, kjo përbënte shkelje të lirisë për të marrë informacion, pasi “privimi i publikut nga informacioni për funksionimin e organeve të shtetit është i barabartë me shkeljen e të drejtës demokratike themelore”. Gjyqtari *De Meyer*, gjithashtu pjesërisht mendim pakice, shprehu se ishte në një mendje me gjyqtarin *Pettiti* dhe shtoi:

Shtypi duhet të lihet i lirë të publikojë lajme, cilido qoftë burimi, pa censurë, masa ndaluese ose kufizime paraprake: në një shoqëri të lirë demokratike nuk mund të ketë vend, në kohë dhe hapësirë, për kufizime të këtij lloji dhe veçanërisht aq më pak nëse këto shërbejnë, siç është në çështjen konkrete, për “fshehjen nga qeveria të informacionit ose ideve shqetësuese”.

Në çështjen *Vereniging Weekblad Bluf! kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata shqyrtoi, bazuar në fakte të ndryshme, konfliktin ndërmjet “sigurisë kombëtare” dhe lirisë së shprehjes. Kërkuesi, një shoqatë e vendosur në Amsterdam, publikoi një revistë javore të quajtur “Bluf!”, të destinuar kryesisht për lexuesit e majtë. Në vitin 1987, “Bluf!” mori një raport semestral nga shërbimi holandez i brendshëm i sigurisë (“BVD”). Raporti, i vitit 1981, u shënjua “konfidencial” dhe kishte informacion me interes për shërbimin sekret holandez. Raporti i referohej Partisë Komuniste holandeze dhe lëvizjeve anti-bërthamore; ai përmendte planin e Lidhjes Arabe për të ngritur një zyrë në Hagë; ai jepte informacion mbi aktivitetet e shërbimeve sekrete të Polonisë, Rumanisë dhe Çekosllovakisë në Holandë.

Redaktori i revistës propozoi që raporti, së bashku me komentarin, të publikohej si një shtojcë e numrit të datës 29 prill 1987. Në të njëjtën ditë, shefi i Shërbimit Holandez të Sigurisë së Brendshme dërgoi një letër te zyra e prokurorit, duke u shprehur që shpërndarja e raportit do të shkelte ligjin penal. Në lidhje me karakterin sekret të informacionit të raportit, ai vuri re se:

Megjithëse ... kontributet e ndryshme të marra veçmas nuk përmbajnë (ose nuk vazhdojnë të përmbajnë) sekrete shtetërore, të marra dhe lexuara së bashku ato përbëjnë informacion, konfidencialiteti i të cilit është i nevojshëm në interes

të shtetit ose aleatëve të tij. Kjo vjen për shkak se ballafaqimi i fakteve jep një pamje të përgjithshme, në sektorë të ndryshëm me interes, të informacionit në dispozicion të shërbimeve të sigurisë dhe të aktiviteteve të BVD-së dhe metodat operative¹²⁰.

Si rezultat, para shtypjes dhe shpërndarjes së revistës, mjediset e “Bluff!” u kontrolluan në pajim me një urdhër të gjyqtarit hetimor. U sekuestrua i gjithë tirazhi i “Bluff!” i datës 29 prill, duke përfshirë shtojcën. Gjatë asaj nate, të panjohur për autoritetet, personeli i “Bluff!” rishtypi numrin dhe rreth 2 500 kopje u shitën ditën tjetër në rrugët e Amsterdimit. Autoritetet nuk e ndaluan shpërndarjen.

Në maj të vitit 1987, gjyqtari hetues e mbylli hetimin kundër personelit të “Bluff!” pa ngritur akuza penale. Ndërkohë, shoqata kërkoi kthimin e kopjeve të sekuestruara, por kjo kërkesë u refuzua. Në mars të vitit 1988, me kërkesë të prokurorit publik, gjykatat holandeze vendosën që të gjitha kopjet e atij numri të “Bluff!” të tërhiqeshin nga qarkullimi publik. Gjykatat u mbështetën në nevojën për mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe argumentuan që zotërimi pa mbikëqyrje i artikujve të sekuestruar ishte në kundërshtim me ligjin dhe me interesin publik.

Shoqata u ankua në gjykatë, duke pretenduar se autoritetet holandeze kishin shkelur të drejtën e saj sipas nenit 10. Qeveria ishte e mendimit se ndërhyrja te liria e shprehjes së kërkuesit ishte e arsyetuar në mënyrë legjitime nga nevoja për të mbrojtur “sigurinë kombëtare”, duke e bazuar këtë mbi argumentet e mëposhtme: individët ose grupet që përbëjnë rrezik për sigurinë kombëtare mund të kenë zbuluar duke lexuar raportin, nëse dhe në cilën masë janë në dijeni shërbimet sekrete holandeze për aktivitetet e tyre subversive; mënyra në të cilën informacioni ishte paraqitur mund t’u kishte dhënë atyre tregues mbi metodat dhe aktivitetet e shërbimeve sekrete; këta armiq potencialë kishin mundësinë për ta përdorur këtë informacion në dëm të sigurisë kombëtare.

Duke shqyrtuar nëse ndërhyrja - sekuestrimi dhe tërheqja nga qarkullimi - ishte “i nevojshëm në një shoqëri demokratike” për mbrojtjen e “sigurisë kombëtare”, Gjykata u shpreh:

Është e diskutueshme nëse informacioni në raport ishte sensitiv në masë të mjaftueshme për të justifikuar parandalimin e shpërndarjes. Dokumenti në fjalë datonte që para gjashtë vjetësh. ... vetë shefi i Shërbimit të Sigurisë kishte pranuar që në vitin 1987, të gjithë artikujt e informacionit të marra veçmas, nuk

¹²⁰ *Vereniging Weekblad Bluff! kundër Holandës*, 9 shkurt 1995, paragrafi 9.

përbënin më sekrete shtetërore. Së fundmi, raporti ishte shënuar thjesht “konfidencial”, që përfaqëson një nivel të ulët fshehtësie.

...

Tërheqja nga qarkullimi duhet të konsiderohet nën dritën e ngjarjeve si një e tërë. Pas sekuestrimit të gazetës, botuesit ribotuan një numër të madh kopjesh dhe i shitën ato në rrugën e Amsterdimit, që ishin shumë të mbipopulluara ...

Për pasojë, informacioni në fjalë ishte shpërndarë gjerësisht kur gazeta ishte tërhequr nga qarkullimi. ...

Për sa i takon kësaj të fundit, Gjykata vëren se tashmë është konsideruar e panevojshme të parandalohet deklarimi i informacionit të caktuar duke ditur që ai tashmë është bërë publik ... ose ka pushuar së qeni konfidencial. ...

Informacioni në fjalë është bërë i aksesueshëm për një numër të madh njerëzish, që kanë qenë në gjendje t’ua komunikojnë atë të tjerëve. Për më tepër, ngjarjet janë komentuar nga media. Duke qenë kështu, mbrojtja e informacionit si një sekret shtetëror nuk mbetet e justifikuar dhe tërheqja e numrit të “Bluf!-it” nuk duhet e nevojshme për të arritur qëllimin legjitim të ndjekur....

Me pak fjalë, meqenëse masa nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike, nuk ka pasur shkelje të nenit 10¹²¹.

Vendimet e themelit në çështjet *Observer* dhe *Guardian* dhe *Bluf!* përcaktojnë të paktën dy parime të rëndësishme. Parimi i parë përcakton që nëse tashmë është bërë publik, informacioni mbi sigurinë kombëtare nuk mund të pengohet, tërhiqet dhe autorët e shpërndarjes nuk mund të ndëshkohen. Parimi i dytë vendos një ndalim për shtetet që të përcaktojnë pa kushte si të klasifikuar të gjithë informacionin në sferën e sigurisë kombëtare dhe, për pasojë, të vendosin një kufizim paraprak mbi aksesin te ky informacion. Një pjesë e informacionit mbi sigurinë kombëtare mund të klasifikohet nëse ka shkaqe serioze për të besuar që siguria kombëtare do të kërcënohej duke e lejuar atë të dilte në sferën publike. Për më tepër, statusi i klasifikuar i informacionit duhet të jetë i kufizuar në kohë dhe nevoja për të ruajtur këtë status duhet të verifikohet periodikisht. Interesi i publikut në marrjen dijeni për informacione të caktuara duhet të konsiderohet gjithashtu në procesin e klasifikimit ose deklasifikimit të informacionit në lidhje me sigurinë kombëtare.

Natyra e artikullit duhet të merret parasysh nga gjykatat e brendshme në vlerësimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes në rastin e zbulimit të informacionit të klasifikuar. Në çështjen *Stoll kundër Zvicrës*, kërkuesi, një gazetar, u ndëshkua me gjobë sepse kishte deklaruar në shtyp një raport konfidencial nga

¹²¹ Paragrafët 41-46.

Ambasadori i Zvicrës në Shtetet e Bashkuara, *Carlo Jagmetti*. Raporti kishte të bënte me strategjinë që duhet të miratohej nga qeveria zvicerane në bisedimet, ndërmjet të tjerash midis Kongresit Çifut Botëror dhe bankave zvicerane mbi temën e kompensimit të viktimave të holokaustit për asetet e pa pretenduara të depozituara në llogaritë bankare zvicerane. Për këtë temë u përpilua një dokument strategjik, i klasifikuar “konfidencial” nga ambasadori dhe pastaj iu dërgua personit përgjegjës për çështjen në Departamentin Federal zviceran për Punët e Jashtme në Bernë. Duke mos konstatuar shkelje të nenit 10, gjykata theksoi se përmbajtja e artikujve të kërkuesit ishte shkurtuar dhe reduktuar qartazi dhe fjalori i përdorur synonte të tregonte që komentet e ambasadorit ishin anti-semite, duke shkaktuar kështu një thasethemnajë që kontribuoi në dorëheqje dhe që kishte të bënte me një prej fenomeneve të themelit të çështjeve të aseteve të pa pretenduara, që ishin tmerret kundër komunitetit çifut gjatë Luftës së Dytë Botërore. Duke ditur natyrën e pasaktë dhe sensacionale të artikujve që rridhte nga kontributi i tyre potencial në debatin publik, dhe duke pasur parasysh që një prej tyre ishte vendosur në kopertinën e parë të një gazete javore me një tirazh të madh, Gjykata ishte e mendimit se synimi kryesor i kërkuesit nuk ishte për të informuar publikun për një temë me interes të përgjithshëm, por për ta bërë raportin e ambasadorit temë të një skandali të panevojshëm¹²².

Një legjislacion që ndalon në terma absolutë dhe të pakushtëzuar shpërndarjen e të gjithë informacionit në sferën e sigurisë kombëtare, elimini i kontrollit publik mbi aktivitetet e shërbimeve të fshehta, do të përbënte shkelje të nenit 10, pasi nuk do të ishte “i nevojshëm në një shoqëri demokratike”. Nëse përballet me një legjislacion që parashikon ndalimin e përgjithshëm dhe të pakushtëzuar të shpërndarjes së të gjithë informacionit në sferën e sigurisë kombëtare, gjykatat e brendshme duhet ta rrëzojnë këtë pretendim, qoftë penal apo civil. Gjykatat duhet të lejojnë shtypin, që vepron në interes të publikut, të ushtrojë lirinë e tij për të identifikuar keqfunksionimin, paligjshmëritë ose parregullsitë e tjera brenda sistemit të shërbimit të fshehtë. Rregullat e zhvilluara nga Gjykata e Strasburgut në rastet kur liria e shprehjes bie në kundërshtim me interesin e mbrojtjes së sigurisë kombëtare janë udhëzimet që duhet të ndiqen në nivel kombëtar. Edhe nëse një sistem ligjor i brendshëm nuk parashikon shprehimisht për testin e “domosdoshmërisë”, parimin e proporcionalitetit dhe argumentin e interesit publik, gjykatat e brendshme duhet t’i përfshijnë ato në arsyetimin e tyre ligjor dhe të zhvillojnë testimin e balancuar që do t’i përgjigjej pyetjes së “domosdoshmërisë”.

¹²² *Stoll kundër Zvicrës*, 10 dhjetor 2007 (GC), paragrafi 151.

Një udhëzim tjetër mund të gjendet në Parimin 12 të Parimeve të Johannesburgut¹²³, duke parashikuar që “një shtet nuk mund të mohojë kategorikisht të gjithë informacionin në lidhje me sigurinë kombëtare, por duhet të përcaktojë në ligj vetëm ato kategori specifike dhe të ngushta informacioni që janë të nevojshme për të mos u deklaruar për të mbrojtur interesin legjitim të sigurisë kombëtare”.

Përveç kësaj, Parimi 15 ndalon dënimin e një personi për shkaqe të “sigurisë kombëtare për deklarim informacioni nëse: (1) deklarimi aktualisht nuk dëmton dhe nuk mund të dëmtojë sigurinë legjitime të sigurisë kombëtare; ose (2) interesi publik në marrjen e këtij informacioni mbizotëron dëmtimin nga deklarimi.

Rekomandimi i vitit 1981 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës mbi të drejtën e aksesit në informacionin që mbahet nga autoritetet publike, ia nënshtron aksesin në informacion një testi me tri pjesë: kufizimet duhet të parashikohen në ligj ose në praktikë; të jenë të nevojshme në një shoqëri demokratike dhe të synojnë mbrojtjen e një interesi publik legjitim. Çdo refuzim informacioni duhet të shpjegohet dhe t’i nënshtrohet rishikimit. Informacioni në sferën e sigurisë kombëtare nuk përbën përjashtim nga ky rregull.

“Siguria kombëtare” përkundrejt lirisë së shprehjes u shqyrtua edhe nga Gjykata në lidhje me sekretet ushtarake. Në çështjen *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, një oficer u dënua me burgim me kusht për 5 muaj për shkak të dhënies së informacionit të klasifikuar një shoqërie private përkundrejt pagesës. Informacioni kishte të bënte me një armë të caktuar dhe njohuritë përkatëse teknike dhe, sipas mendimit të qeverisë, deklarimi ishte në gjendje të shkaktonte dëm të konsiderueshëm për sigurinë kombëtare. Pasi u shpreh se informacioni ushtarak nuk është i përjashtuar nga mbrojtja e nenit 10, Gjykata e konstatoi dënimin si “të nevojshëm në një shoqëri demokratike” për mbrojtjen e “sigurisë kombëtare” dhe u shpreh:

Deklarimi i interesit të Shtetit në një armë të caktuar dhe që ai i njohurive përkatëse teknike, që mund të përmbajnë tregues mbi gjendjen e progresit në prodhimin e tij, janë në gjendje të shkaktojnë dëm të konsiderueshëm në sigurinë kombëtare.

(...)

Provat nuk deklarojnë mungesën e një raporti të arsyeshëm të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të zbatuara dhe qëllimit legjitim të ndjekur¹²⁴.

Vendimi në çështjen *Hadjianastassiou* jep dy prirje të rëndësishme për gjykatat e brendshme. Së pari, jo i gjithë informacioni ushtarak përjashtohet nga sfera publike. Së dyti, Gjykata ishte përsëri e mendimit që u takon gjykatave të brendshme të përcaktojnë në çdo çështje konkrete nëse infor-

¹²³ Parimet e Johannesburgut për Sigurinë Kombëtare, Lirinë e Shprehjes dhe Aksesin në Informacion, të miratuar më 1 tetor 1995.

¹²⁴ *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, 16 dhjetor 1992, paragrafët 45 dhe 47.

macioni përkatës përbën një rrezik të rëndë dhe real për sigurinë kombëtare. Një vlerësim i tillë i bazuar në parimin e proporcionalitetit është përgjigja nëse një shprehje që bën publik informacion ushtarak duhet apo nuk duhet të ndalohet apo sanksionohet.

5.2. Liria e shprehjes dhe integriteti territorial

Në çështjen *Sürek dhe Özdemir kundër Turqisë*, kërkuessit u dënuan nga gjykatat e brendshme me gjashtë muaj burg dhe një gjobë secili, me akuzën e shpërndarjes së propagandës separatiste. Përveç kësaj, ekzemplarët e shtypur u sekuestruan. Kërkuessit publikuan dy intervista me një figurë të lartë të PKK-së, i cili dënonte politikën e autoriteteve turke në juglindje, që ai i përshkruante sikur synonin të nxirrnin kurdët nga territori i tyre dhe të shkatërronin rezistencën. Ai pretendoi gjithashtu se lufta në emër të popullit kurd do të vazhdojë “sikur edhe vetëm një individ të mbetet në anën tonë”. Kërkuessit publikuan gjithashtu një deklaratë të përbashkët të publikuar nga katër organizata që, si PKK-ja, ishin të paligjshme sipas së drejtës turke, që kërkonin njohjen e së drejtës së popullit kurd për vetëvendosje dhe tërheqjen e ushtrisë turke nga Kurdistan.

Gjykata fillimisht iu referua kritikës së qeverisë - siç praktikohet nga publikimi dhe u shpreh që “limitet e kritikës së lejueshme janë më të gjera në lidhje me qeverinë se sa në lidhje me një qytetar privat ose edhe politikën”¹²⁵. Për më tepër, Gjykata vuri re se fakti që intervistat ishin dhënë nga një anëtar drejtues i një organizate të ndaluar dhe që ato përmbanin kritikë të fortë të politikës zyrtare të shtetit dhe komunikonin një këndvështrim të njëanshëm të situatës dhe përgjegjshmërisë për trazirat në Turqinë Juglindore nuk mund të justifikojnë në vetvete një ndërhyrje të liria e shprehjes së kërkuessve. Sipas mendimit të Gjykatës:

Intervistat përbënin lajm, që i mundësonte publikut të kishte një vështrim mbi psikologjinë e atyre që janë forca shtytëse pas opozitës së politikës zyrtare në Turqinë Juglindore dhe të vlerësojë interesat e përfshira në konflikt.

Gjykata më tej u shpreh se “autoritetet vendase nuk e morën parasysh si duhet të drejtën e publikut për t’u informuar në lidhje me një perspektivë tjetër mbi situatën në Turqinë Juglindore, pavarësisht nga sa e papranueshme mund të ishte kjo perspektivë për ta”. Në përfundim, Gjykata konstatoi se arsytet e dhëna nga gjykatat vendase për të dënuar kërkuessit “megjithëse relevante, nuk mund të jenë të mjaftueshme për të justifikuar ndërhyrjet në të

¹²⁵ *Sürek dhe Özdemir kundër Turqisë*, 8 korrik 1999 (GC), paragrafi 60.

drejtën e lirisë së shprehjes”¹²⁶.

Po ashtu, në çështjen *Özgür Gündem kundër Turqisë*, Gjykata u shpreh se ndëshkimet për propagandë separatiste, që ishin të justifikuara nga qeveria turke bazuar në mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe parandalimin e krimit dhe trazirave, ishin në kundërshtim me nenin 10:

përdorimi i termit “kurdistan” në një kontekst, i cili nënkupton që ai duhet të jetë, ose është, i ndarë nga territori i Turqisë dhe pretendimet nga personat për të ushtruar autoritet në emër të atij subjekti, mund të jetë tepër provokues për autoritetet.

Pas referimit tek e drejta e publikut për t’u informuar mbi këndvështrime të ndryshme nga ato të shtetit dhe shumicës së popullatës, Gjykata deklaroi se:

megjithëse shumë nga artikujt ishin tepër kritikë për autoritetet dhe forcave të sigurisë u vishnin sjellje të paligjshme, ndonjëherë në terma të gjalla dhe poshtëruese, Gjykata konstaton se ato nuk mund të konsiderohen se propagandonin ose nxitnin përdorimin e dhunës¹²⁷.

Nga ana tjetër, në çështjen *Sürek kundër Turqisë*, Gjykata konstatoi se shkaqet e mbrojtjes së sigurisë kombëtare dhe integritetit territorial ishin proporcionale me kufizimin mbi lirinë e shprehjes, për shkak të aftësisë së artikullit për të nxitur dhunë në Turqinë Juglindore: “Vërtet që mesazhi i komunikuar lexuesit është që përdorimi i dhunës është një masë e nevojshme dhe e justifikuar e vetëmbrojtjes përballë agresorit”¹²⁸. Diferenca ndërmjet kësaj dhe çështjeve të tjera qëndron në aftësinë e artikullit të debatuar për të nxitur dhunë dhe në mundësinë që kjo dhunë do të ndodhë, ku të dyja këto elemente përcaktohen nga Gjykata mbi bazën e rrethanave konkrete të secilës çështje.

Në çështjen *Kühnen kundër Republikës Federale të Gjermanisë*¹²⁹, kërkuesi drejtonte një organizatë, qëllimi i së cilës ishte sjellja e Partisë Nacional-Socialiste (e ndaluar në Gjermani) përsëri në skenën politike. Z. Kühnen kishte shpërndarë publikime që nxisnin luftën për një “Gjermani të Madhe” socialiste dhe të pavarur. Ai shkroi që organizata e tij ishte në favor të “unitetit gjerman, drejtësisë sociale, krenarisë racore, komunitetit të njerëzve (dhe) bashkëjetesës” dhe kundër “kapitalizmit, komunizmit, sionizmit, përçudnimit nga masat e punëtorëve të huaj, shkatërrimit të mjedisit.” Ai shkroi gjithashtu: “kushdo që i shërben këtij qëllimi mund të veprojë, kushdo që e pengon do të luftohet

¹²⁶ Paragrafi 61.

¹²⁷ *Özgür Gündem kundër Turqisë*, 16 mars 2000, paragrafi 70.

¹²⁸ *Sürek kundër Turqisë* (Nr. 3), 8 korrik 1999 (GC), paragrafi 40.

¹²⁹ *Kühnen kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, 12 maj 1989 (vendim).

dhe më në fund eliminohet.” Z. *Kühnen* u dënua me burg nga gjykatat gjermane¹³⁰. Komisioni Europian theksoi se kërkuesi kishte propaganduar nacional-socializmin që synonte të dëmtonte rendin bazë të lirisë dhe demokracisë dhe që fjalimi i tij ishte në kundërshtim me një prej vlerave bazë të shprehura në Preambulën e Konventës: liritë themelore të mishëruara në Konventë “ruhen më mirë nga një demokraci politike efektive”. Përveç kësaj, Komisioni theksoi që fjalimi i kërkuesit përmbante elemente të diskriminimit racial dhe fetar. Për pasojë, Komisioni u shpreh që kërkuesi ishte përpjekur të përdorte lirinë e shprehjes për të nxitur sjellje në kundërshtim me tekstin dhe frymën e Konventës, si dhe në kundërshtim me nenin 17, që ndalon abuzimin me të drejtat. Në përfundim, Komisioni konstatoi që ndërhyrja tek ushtrimi i lirisë së shprehjes së kërkuesit ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

5.3. Liria e shprehjes dhe parandalimi i trazirave ose krimet

Në çështjen *Incal kundër Turqisë*¹³¹ autoritetet e brendshme e kufizuan lirinë e shprehjes mbi bazën e “parandalimit të trazirave”. Z. *Incal*, shtetas turk dhe anëtar i Partisë Popullore të Punës (shpërndarë në vitin 1993 nga Gjykata Kushtetuese), kishte shpërndarë fletëpalosje që përmbanin deklarime agresive në lidhje me politikën e qeverisë turke dhe i bënte thirrje popullatës me origjinë kurde të bashkohej dhe të ngrinte kërkesa të caktuara politike. Fletëpalosjet i bënin thirrje popullit për të luftuar kundër fushatës “Nxjerrja Jashtë e Kurdëve”, e cila ishte filluar nga policia turke e rendit dhe organet e pushtetit lokal, dhe e quajtën këtë fushatë “pjesë të një lufte të posaçme të zhvilluar në vend momentalisht kundër popullit kurd”. Fushata i karakterizonte masat shtetërore si “terror shtetëror kundër proletarëve turq dhe kurdë”. Megjithatë, fletëpalosjet nuk bënin thirrje për dhunë ose urrejtje. Policia turke e rendit ishte e mendimit që fletëpalosjet mund të konsideroheshin si propagandë separatiste. Z. *Incal* u dënua nga gjykatat e brendshme me gjashtë muaj burg nën akuzën e nxitjes për kryerjen e një vepre penale. Atij gjithashtu iu ndalua futja në shërbimin civil dhe pjesëmarrja në një numër aktiviteteesh brenda organizatave dhe shoqatave politike dhe bashkimeve profesionale.

Para gjykatës, qeveria turke argumentoi se dënimi i kërkuesit ishte i nevojshëm për të parandaluar trazirat, meqenëse gjuha e fletëpalosjeve ishte agresive, provokative dhe mund të nxiste popullin me origjinë kurde të besonte që ata ishin viktimat e një “lufte të posaçme” dhe në këtë mënyrë

¹³⁰ Kodi Penal gjerman ndalon zhvillimin e propagandës nga organizatat jokushtetuese nëse kjo propagandë drejtohet kundër rendit bazë të demokracisë, lirisë dhe mirëkuptimit të të gjithë njerëzve.

¹³¹*Incal kundër Turqisë*, 9 qershor 1998 (GC).

justifikonte ngritjen e komiteteve të vetëmbrojtjes. Qeveria gjithashtu argumentoi që “dukej nga teksti i fletëpalosjeve që ato synonin të nxisnin një kryengritje nga një grup etnik kundër autoriteteve shtetërore” dhe që interesi në luftën dhe shtypjen e terrorizmit merr prioritet në një shoqëri demokratike”¹³².

Gjykata nuk ishte e të njëjtit mendim me qeverinë dhe iu referua nevojës që “veprimet ose mosveprimet e qeverisë” t’i “nënshtroheshin një vëzhgimi të imët jo vetëm të autoriteteve legjislative dhe gjyqësore, por edhe të opinionit publik”¹³³. Me qëllim që të vlerësohet nëse fajësimi dhe dënimi i kërkuesit ishin “të nevojshme në një shoqëri demokratike”, Gjykata theksoi që “ndërsa është e shtrenjtë për të gjithë, liria e shprehjes është posaçërisht e rëndësishme për partitë politike dhe për anëtarët e tyre aktivë”¹³⁴. Gjykata u shpreh se ajo nuk mund të identifikonte:

asgjë që do të sillte përfundimin që z. *Incal* ishte në ndonjë mënyrë përgjegjës për problemet e terrorizmit në Turqi...

Si përfundim, dënimi i z. *Incal* ishte në disproporcion me qëllimin e ndjekur dhe në këtë mënyrë i panevojshëm në një shoqëri demokratike¹³⁵.

Përveç shkeljes së nenit 10, Gjykata konstatoi gjithashtu një shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë (neni 6), pasi një nga gjyqtarët e trupit gjykues ishte gjyqtar ushtarak.

Parandalimi i trazirave ose krimit, si dhe interesi i mbrojtjes së sigurisë kombëtare, u argumentua nga qeveria austriake në çështjen *Salzmann kundër Austrisë*. Kërkuesi u dënua me tre muaj burg, u pezullua me kusht për një periudhë prej tre vjetësh, për shkak të nxitjes së anëtarëve të ushtrisë, nëpërmjet shtypit, për mosbindje dhe shkelje të ligjeve ushtarake. Komisioni vendosi që ndëshkimi i kërkuesit ishte i justifikuar për ruajtjen e rendit në ushtrinë federale austriake dhe për mbrojtjen e sigurisë kombëtare: “nxitja e shpërfilljes së ligjeve ushtarake përbën një presion jo kushtetues dhe synon në shmangien e ligjeve që ishin miratuar në një mënyrë kushtetuese. Një presion i tillë jo kushtetues nuk mund të tolerohej në një shoqëri demokratike”¹³⁶.

¹³² Paragrafi 57.

¹³³ Paragrafi 54.

¹³⁴ Paragrafi 46.

¹³⁵ Paragrafët 58 dhe 59.

¹³⁶ *Saszmann kundër Austrisë*, 27 shkurt 1997 (vendim).

Gjykata arriti në një përfundim të ndryshëm në çështjen *Vereinigung demokratischer Soldaten Österreichs dhe Gubi kundër Austrisë*, ku gjykatat austriake ndaluan shpërndarjen e një gazete austriake të ushtarët në kazernat ushtarake; periodiku propozonte reforma dhe inkurajonte ushtarët të ndërmerren veprime gjyqësore kundër autoriteteve. Qeveria austriake argumentoi se organi periodik i kërkuesve kërcënonte sistemin e mbrojtjes së vendit, efektivitetin e ushtrisë, dhe mund të sillte trazira e kriminalitet. Gjykata nuk ra dakord me parashtrirat e qeverisë dhe u shpreh se pjesa më e madhe e artikujve në periodik:

shprehnin ankesa, paraqisnin propozime për reforma ose inkurajonin lexuesit të bënin ankime gjyqësore ose të ankimonin vendimet. Megjithatë, me gjithë pjesën urdhëuese shpesh polemike, nuk duket se ata e kaluan kufirin e asaj që është e lejueshme në një diskutim të thjeshtë të ideve, që duhet të tolerohet në ushtrinë e një shteti demokratik, siç duhet të jetë edhe në shoqërinë që shërben një ushtri e tillë¹³⁷.

Për këtë shkak, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 10.

5.4. Liria e shprehjes dhe morali

Konflikti ndërmjet “moralit” dhe lirisë së shprehjes ka sjellë interpretime të reja të parimit të proporcionalitetit dhe është shqyrtuar kryesisht në kontekstin e lirisë artistike. Si rregull, në të tilla raste Gjykata u ka lënë autoriteteve të brendshme një hapësirë më të gjerë vlerësimi, të justifikuar nga specifika e “moralit” në çdo shtet anëtar ose edhe në rajone të ndryshme brenda të njëjtit vend.

Në çështjen *Müller dhe të Tjerë kundër Zvicrës*¹³⁸, ndërhyrja e autoriteteve të brendshme të liria e shprehjes u konsiderua e arsyeshme nga Gjykata dhe “e nevojshme në një shoqëri demokratike “për mbrojtjen e “moralit”. Në vitin 1981, gjatë një ekspozite të artit bashkëkohor, z. Müller pikturoi dhe ekspozoi tri piktura të mëdha që tregonin sodominë, zoofilinë, masturbimin dhe homoseksualitetin. Ekspozita ishte e hapur për publikun e gjerë, pa kufizim moshe dhe ishte falas. Gjykatat zvicerane e dënuan me gjobë z. Müller dhe organizatorët e ekspozitës dhe sekuestruan pikturat, që iu dorëzuan një muzeu për ruajtje. Megjithatë, ato iu kthyen z. Müller në vitin 1988. Në Strasburg, z. Müller dhe organizatorët e ekspozitës pretenduan që si dënimi dhe sekuestrimi kishin shkelur të drejtën e lirisë së shprehjes.

¹³⁷ *Vereinigung demokratischer Soldaten Österreichs dhe Gubi kundër Austrisë*, 19 dhjetor 1994, paragrafi 38.

¹³⁸ *Müller dhe të Tjerë kundër Zvicrës*, 24 maj 1988.

Gjykata iu referua mungesës së një koncepti uniform të moralit brenda territorit të palëve kontraktuese të Konventës. Gjykata u shpreh që gjykatat e brendshme ishin në një pozitë më të mirë se gjyqtarët ndërkombëtarë për të vendosur mbi çështjet e “moralit”, duke pasur parasysh kontaktin e drejtpërdrejtë të mëparshëm me “forcat vitale” në vendet e tyre. Gjykata u shpreh se:

pikturat në fjalë preknin në mënyrë të drejtpërdrejtë marrëdhëniet seksuale, posaçërisht ato ndërmjet njerëzve dhe kafshëve... publiku i gjerë mund të hynte lirish dhe organizatorët nuk kishin vendosur ndonjë pagesë pranimi apo kufi moshe. Vërtet që pikturat ishin ekspozuar në një ekspozitë të pakufizuar për të tërhequr publikun e gjerë¹³⁹.

Gjykata gjithashtu u shpreh se argumentet e gjyqtarëve të brendshëm, që kishin konstatuar se imazhet ishin të përshtatshme “të ofendonin anën e cilësisë seksuale të personave me ndjeshmëri të zakonshme” nëpërmjet “theksimin të seksualitetit në format e tij më vulgare”, nuk ishin të paarsyeshme¹⁴⁰. Konstatimet e Gjykatës u konfirmuan më vonë në një numër vendimesh në lidhje me lirinë artistike¹⁴¹. Aksesin e pakufizuar tek ekspozita luajti një rol të rëndësishëm në vendimin e çështjes *Müller*, siç ishte edhe te çështja *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*¹⁴², ku kërkuesi kishte publikuar dhe shpërndarë të nxënësit një libër të konsideruar si të pahijshëm nga autoritetet britanike.

Në çështjen *Wingrove kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Bordi Britanik i Klasifikimit të Filmit refuzoi të jepte një certifikatë klasifikimi për një punë në video të titulluar “*Vizione të Ekstazës*”. Filmi tregonte një aktore të re të veshur si një murgeshë - e destinuar të përfaqësonte Shenjtoreshen Tereza të Avilas, një murgeshë e shekullit XVI të Carmelites dhe themeluese e disa konventave - e cila kishte përjetuar disa vizione rinore ekstaze të Jezu Krishtit. Komisioni doli në përfundimin që refuzimi i Bordit Britanik të Klasifikimit të Filmit për një certifikatë klasifikimi ishte e panevojshme në një shoqëri demokratike të mbrojtur ndaj ofendimeve të ndjenjave fetare. Sipas mendimit të Komisionit, konteksti i kufizimit paraprak nënkuptonte që duhej të ekzistonin shkaqe tepër detyruese për të justifikuar kufizimin “e bazuar në spekulimin nga autoritetet kompetente që një pjesë e popullatës mund të pezmatohet”¹⁴³. Ishte e rëndësishme që nuk ishte film artistik dhe nuk do të shfaqej për publikun e gjerë; dhe bordi mund të kishte kufizuar qarkullimin tek

¹³⁹ Paragrafi 36.

¹⁴⁰ Po aty.

¹⁴¹ *Vereinigung Bildender Künstler kundër Austrisë*, 25 janar 2007.

¹⁴² *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 7 dhjetor 1976.

¹⁴³ *Wingrove kundër Mbretërisë së Bashkuar*, raporti i Komisionit i miratuar më 10 janar 1995.

ata që ishin mbi 18 vjeç.

Gjykata e rrëzoi vendimin e Komisionit në këtë çështje. Nuk e konsideroi veten në gjendje të vendoste se vepra e blasfemisë e shkelte nenin 10. Ajo vendosi që:

megjithëse ka pak hapësirë sipas nenit 10, parag. 2.... për kufizimet e deklaramëve politike ose të debatit mbi çështjet e interesit publik, ... ofrohet një hapësirë më e gjerë vlerësimi për shtetet kontraktuese, kur rregullohet liria e shprehjes në lidhje me çështjet që mund të prekin bindje intime personale brenda sferës së moralit, ose veçanërisht fesë¹⁴⁴.

Gjyqtari *Löhmus* në një mendim pakice vuri re se:

Gjykata bën dallime brenda nenit 10 ... kur ajo zbaton doktrinën e saj për marzhin e vlerësimit të shteteve. Ndërsa në disa raste marzhi i vlerësimit të zbatuar është i gjerë, në çështje të tjera është më i kufizuar. Megjithatë, është e vështirë të vihet në dukje cilat parime përcaktojnë objektin e këtij marzhi vlerësimi¹⁴⁵.

Ka pasur shenja të ndryshimit të qëndrimit të Gjykatës në lidhje me lirinë artistike dhe marzhin e gjerë të vlerësimit lënë shteteve. Në çështjen *I.A kundër Turqisë*, kërkuesi publikoi një roman në të cilin autori trajtonte çështje filozofike dhe teologjike, ku u shtypën dy mijë kopje të këtij libri. Kërkuesi u ndoq penalisht për blasfemi ndaj “Zotit, Fesë, Profetit dhe Librit të Shenjtë”, dhe u dënua për blasfemi. Në vendimin e Gjykatës, shumica ndoqi arsyetimin e çështjes *Wingrove*. Ai i linte Turqisë një marzh të gjerë vlerësimi sepse “besimtarët mund të ndihen në mënyrë të ligjshme objekt i sulmeve të padrejta dhe ofensive” dhe ka pasur një nevojë urgjente sociale të ofrohej “ndihmë ndaj sulmeve ofensive për çështjet e konsideruara si të shenjta nga myslimanët”¹⁴⁶. Por, mendimi i fuqishëm, i përbashkët i pakicës së gjyqtarëve *Costa, Cabral Barreto* dhe *Jungwiert* iu referuan pasazhit të *Handyside* që pranonte se neni 10 mbron informacionin dhe idetë që “tronditin, fyejnë ose shqetësojnë shtetin ose çdo sektor të popullatës”. Ata deklaruan që “këto fjalë nuk duhet të bëhen një frazë magjike ose rituale, por duhet të merren seriozisht dhe të frymëzojnë zgjidhjet e arritura nga Gjykata jonë”¹⁴⁷. Ai pranonte se romani përmbante deklarime fyese dhe të papranueshme, por konsideroi që këto deklarime nuk duhet të merren të izoluara si bazë për dënimin e një libri të tërë dhe vendosjen e sanksioneve penale për botuesin

¹⁴⁴ *Wingrove kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i datës 25 nëntor 1996, paragrafi 58.

¹⁴⁵ Mendimi i pakicës i gjyqtarit *Löhmus*, paragrafi 1.

¹⁴⁶ *I.A kundër Turqisë*, 13 shtator 2005, paragrafi 30.

¹⁴⁷ Opinion i përbashkët pakice i gjyqtarëve *Costa, Cabral Barreto* dhe *Jungwiert*, paragrafi 1.

dhe që “një shoqëri demokratike nuk është një shoqëri teokratike”. Gjyqtarët e pakicës nuk ishin shtyrë nga precedenti i çështjes *Wingrove*, duke nxjerrë përfundimin që “ka ardhur koha për t’iu rikthyer kësaj praktike gjyqësore, që sipas mendimit tonë duket sikur e vendos shumë theksin mbi konformizmin ose uniformitetin e mendimit dhe reflekton një konceptim të tej-kujdesshëm dhe të ndrojtur të lirisë së shtypit”¹⁴⁸.

Një tjetër lloj konflikti ndërmjet “moralit” dhe lirisë së shprehjes u shqyrtua nga Gjykata në çështjen *Open Door and Dublin Well Woman kundër Irlandës*¹⁴⁹. *Open Door Counseling Ltd and Dublin Well Woman Centre Ltd* (“*Open Door*” dhe “*Dublin Well Woman*”) ishin organizata jofitimprurëse në Irlandë, ku ndalohej aborti. Të dyja këto organizata ofronin këshillim për gratë shtatzëna dhe *Dublin Well Woman* mbulonte një gamë të gjerë shërbimesh në sferën e planifikimit familjar, shtatzënisë, shëndetit, sterilitetit etj. Ajo gjithashtu u servite grave shtatzëna informacion mbi mundësinë e një aborti jashtë Irlandës, siç janë adresat e disa klinikave në Mbretërinë e Bashkuar. Të dyja organizatat kufizoheshin tek ofrimi i këshillimit, ndërsa vendimi nëse do të bëhej aborti apo jo u lihej grave. Në vitin 1983, *Dublin Well* publikon një broshurë, ku kritikonte dy ndryshimet e fundit kushtetuese. Ndryshimi i parë i jepte kujtudo të drejtën të bënte një kërkesë në gjykatë për të ndaluar dhënien e informacionit mbi abortet jashtë Irlandës. Amendamenti i dytë kushtetues i jepte kujtudo të drejtën të kërkonte në gjykatë një masë të përkohshme për të penguar një grua nga udhëtimi jashtë shtetit nëse ai besonte se ajo synonte të bënte abort.

Në vitin 1986, pas një kërkesë të bërë nga Shoqëria për Mbrojtjen e Fëmijëve të Palindur (Irlandë) sh.p.k, gjykatat irlandeze vendosën që dhënia e informacionit në lidhje me abortin shkelte kushtetutën dhe dispozitat e tjera ligjore. Gjykatat nxorën një urdhër të përhershëm kundër *Dublin Well Woman* dhe *Open Door* për t’i parandaluar ato në dhënien e këshillave për të ndihmuar gratë shtatzëna për të bërë abort jashtë Irlandës. Të dyja organizatat u ankuan në Gjykatën e Strasburgut, duke pretenduar që e drejta e tyre për të dhënë dhe marrë informacion ishte shkelur. Atyre iu bashkuan edhe katër gra si individë: dy si viktima të drejtpërdrejta të ndalimit dhe dy si viktima të mundshme.

Gjykata, duke diskutuar mbrojtjen e “moralit” si një qëllim legjitim, argumentoi se mbrojtja e fëmijëve të palindur mbështetet në vlerat morale të shëndosha të popullit irlandez dhe shprehu mendimin se megjithëse marzhi i

¹⁴⁸ Paragrafi 8.

¹⁴⁹ *Open Door dhe Dublin Well Woman kundër Irlandës*, 29 tetor 1992.

vlerësimit të autoriteteve është më i gjerë në lidhje me “moralin”, ai nuk është i pakufizuar: autoritetet e brendshme nuk kanë një diskrecion “të pakufishëm dhe të parashikueshëm”¹⁵⁰. Për më tepër, Gjykata shqyrtoi nëse ndërhyrja ishte në proporcion me “nevojën e ngutshme sociale” dhe nëse ishte proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur. Gjykata mbeti e tronditur nga natyra absolute e urdhrave të nxjerrë nga gjykatat irlandeze, që vendosnin një ndalim të përhershëm dhe të përgjithshëm “pavarësisht moshës ose gjendjes shëndetësore ose arsyeve të kërkimit të këshillimit të ndërprerjes së shtatzënisë” (paragrafi 73). Gjykata theksoi se: një kufizim i tillë ishte tepër i gjerë dhe joproporcional. Duke argumentuar natyrën joproporcionale të natyrës së ndërhyrjes, Gjykata theksoi ekzistencën e burimeve të tjera të disponueshme të informacionit (revistat, numërorët telefonikë, njerëzit që banojnë jashtë shtetit), ku të gjitha këto provojnë që nevoja për kufizim e vendosur për kërkuesit nuk ishte e ngutshme.

Po ashtu, gjykatave të brendshme u bëhet e ditur që ndalimet e përgjithshme dhe/ose të përhershme për lirinë e shprehjes janë të papranueshme, edhe në një sferë kaq delikate sa edhe morali. Gjykatave të brendshme në këtë mënyrë u janë dhënë udhëzime për zbatimin e parimit të proporcionalitetit: grupi i synuar i shprehjes është i rëndësishëm dhe veçanërisht me vend nëse adresohen fëmijët dhe të rinjtë; masat që kufizojnë aksesin të forma përkatëse e shprehjes janë të rëndësishme, pasi provojnë kujdesin e treguar për të ulur ndikimin “imoral”; dhe dëmi i vërtetë i moralit duhet të identifikohet, për të shmangur arbitraritetin.

¹⁵⁰ Paragrafi 68.

Kapitulli 6

Liria e shprehjes dhe reputacioni

“Qëllimi i ligjshëm” i mbrojtjes së “reputacionit dhe të drejtave të të tjerëve” është “qëllimi i ligjshëm” i përdorur më shpesh deri tani nga autoritetet kombëtare për kufizimin e lirisë së shprehjes. Ai është cituar shpesh për mbrojtjen e politikanëve dhe nëpunësve civilë nga kritikët. Gjykata ka zhvilluar për rrjedhojë një praktikë gjyqësore të gjerë në këtë fushë, duke dëshmuar nivelin më të lartë të mbrojtjes së ofruar për lirinë e shprehjes dhe në veçanti për shtypin. Pozicioni i privilegjuar i medias rrjedh nga pikëpamja e gjykatës për rolin qendror që luan debati politik në një shoqëri demokratike, si në lidhje me procesin zgjedhor ashtu edhe me çështjet e përditshme me interes publik. Përsa i takon gjuhës, gjykata ka pranuar kritika të ashpra, si dhe shprehje shumëngjyrëshe, sepse këto të fundit kanë avantazhin e tërheqjes së vëmendjes të çështjet në debat.

Për balancimin e të drejtës së lirisë së shprehjes kundrejt të drejtës së jetës private, gjykata përdor gjashtë kritere të vendosura në çështjen *Axel Springer AG kundër Gjermanisë*.¹⁵¹ si kontribut në një debat me interes të përgjithshëm; sa i mirënjohur është personi për të cilin po raportohet dhe subjekti i raportit; sjellja e mëparshme e personit; metoda e përdorur për marrjen e informacionit; vërtetësia, përmbajtja, forma dhe jehona e raportit; si dhe ndëshkimi i dhënë. Nacionet e mësipërme analizohen më poshtë me më shumë hollësi.

6.1. Reputacioni i figurave publike

Klasifikimi i mbrojtjes së grupeve të ndryshme mund të shihet nga praktika gjyqësore e gjykatës. Për shprehje të drejtuara kundër gjyqtarëve, gjykata ka favorizuar më pak mbrojtje dhe lë një hapësirë vlerësimi për shtetin. Shprehjet e drejtuara të njerëzve të zakonshëm dhe figurat publike (përveç politikanëve) gjithashtu përfitojnë mbrojtje më të pakët. Niveli më i lartë i mbrojtjes i jepet gjuhës së përdorur në lidhje me politikanët dhe zyrtarët e lartë, ndërsa kritikët

¹⁵¹ *Axel Springer AG kundër Gjermanisë*, 7 shkurt 2012.

mund të drejtohen kundër shtetit, qeverisë dhe institucioneve shtetërore të tjera¹⁵².

Megjithatë, liria e ndërhyrjes së shtypit në jetën private të figurave publike nuk është absolute. Në çështjen *Von Hannover kundër Gjermanisë*, gjykata vendosi në favor të së drejtës për respektimin e jetës private. Gjykata ritheksoi se koncepti i jetës private përfshin aspekte që lidhen me identitetin personal, si: emri ose fotoja e personit. Krahas kësaj, në këndvështrimin e gjykatës, jeta private përfshin integritetin fizik dhe psikologjik të personit; garancia e ofruar nga neni 8 i Konventës synon kryesisht të garantojë, pa ndërhyrje të jashtme, zhvillimin e personalitetit të secilit individ në marrëdhëniet e tij/saj me qeniet e tjera njerëzore. Aplikantit iu akordua mbrojtja kundër botimit të fotove dhe artikujve për sferën e jetës private dhe familjare¹⁵³.

6.2. Kritikkat ndaj politikanëve

Shumë më pak mbrojtje do të ofrohej për jetën private dhe reputacionin e politikanëve, veçanërisht nëse informacioni për jetën private të një personi ka ndikim mbi detyrimet dhe funksionet publike të tij/saj. Gjykata konstatoi se duke qenë të gatshëm të punojnë në sferën publike, politikanët e vendosin vullnetarisht veten në qendër të vëmendjes dhe kështu duhet të tolerojnë më shumë kritika, të jenë “më pak të ndjeshëm”.

Në çështjen *Lingens kundër Austrisë*¹⁵⁴, gjykata balancoi lirinë e shtypit kundrejt të drejtës për reputacion të një zyrtari publik të nivelit të lartë. Në tetor të vitit 1975, pas zgjedhjeve të përgjithshme në Austri, z. *Lingens* botoi dy artikuj ku kritikonte Kancelarin Federal austriak, z. *Bruno Kreisky*, i cili kishte dalë fitues në zgjedhje. Kritikkat përqendroheshin në lëvizjen politike të kancelarit, që kishte shpallur koalicion me një parti të drejtuar nga një person me të kaluar naziste dhe në përpjekjet sistematike të kancelarit për mbështetjen politike të ish-nazistëve. Sjellja e kancelarit karakterizohej si “imorale”, “e padenjë”, duke demonstruar “oportunizmin më të ulët”. Pas procedimit ligjor privat të filluar nga kancelari, gjykatat austriake vendosën se thëniet ishin fyese dhe e dënuan gazetarin me gjobë. Gjykatat kombëtare vendosën gjithashtu se gazetari nuk mund ta provonte vërtetësinë e pretendimeve të tij për “oportunizmin më të ulët”. Përpara gjykatës së Strasburgut, qeveria austriake pretendoi se dënimi i kërkuesit synonte mbrojtjen e reputacionit të kancelarit.

Nga shqyrtimi i kriterëve për domosdoshmërinë e ndërhyrjes “në një shoqëri

¹⁵² *Human rights files* Nr. 18, *Liria e shprehjes në Europë, Jurisprudenca për nenin 10 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut*, Këshilli i Europës, mars 2007.

¹⁵³ *Von Hannover kundër Gjermanisë*, 24 qershor 2004.

¹⁵⁴ *Lingens kundër Austrisë*, 8 korrik 1986.

demokratike”, gjykata zhvilloi disa parime shumë të rëndësishme. Politikanët duhet të tregojnë tolerancë më të madhe ndaj kritikave nga media:

liria e shtypit për më tepër i jep publikut një nga mjetet më të mira të zbulimit dhe krijimit të një mendimi për idetë dhe qëndrimet e udhëheqësve politikë. Në *vija më të përgjithshme*, liria e debatit politik është në thelb të konceptit të një shoqërie demokratike që mbizotëron në të gjithë Konventën.

Kufijtë e kritikave të pranueshme janë rrjedhimisht më të gjera për një politikan sesa për një person privat. Ndryshe nga ky i fundit, politikani pashmangshmërisht dhe me vetëdije e ekspozon veten ndaj një shqyrtimi të kujdesshëm të çdo fjale dhe veprimi të tij edhe nga gazetarët edhe nga publiku i gjerë, dhe rrjedhimisht duhet të tregojë një shkallë më të madhe tolerance¹⁵⁵.

Gjykata nuk e përjashtoi mbrojtjen e reputacionit të politikanëve, por theksoi se “në raste të tilla kriteret e një mbrojtjeje të tillë duhet të peshohen në lidhje me interesat e diskutimit të hapur të çështjeve politike”¹⁵⁶.

Konteksti politik i artikujve të kundërshtuar ishte gjithashtu me rëndësi: “për rrjedhojë thëniet e kundërshtuara duhet të shihen kundrejt sfondit të një debati politik pas-zgjedhor; ...në këtë luftë secili përdor armët që ka në dispozicion; dhe këto nuk ishin aspak të pazakonta në luftimet e ashpra të politikës”¹⁵⁷.

Ndikimi i dënimit të kërkuesit mbi lirinë e shtypit në përgjithësi ishte një element tjetër që u konsiderua i rëndësishëm nga gjykata:

siç e theksoi dhe qeveria, artikujt e kundërshtuar ishin shpërndarë në atë kohë, kështu që megjithëse dënimi i dhënë për autorin nuk e pengoi atë të shprehej, ai gjithsesi përbënte një lloj censure, që me gjasa do ta dekurajonte të bënte përsëri kritika të tilla në të ardhmen ...Në kontekstin e debatit politik, një dënim i tillë do t'i frenonte me gjasa gazetarët nga kontributi në diskutimin publik të çështjeve që preknin jetën e komunitetit. Në të njëjtën mënyrë, një sanksion si ky është përgjegjës për pengimin e shtypit në kryerjen e detyrës së tij si furnizues i informacionit dhe rojtar publik¹⁵⁸.

Sipas parimeve të gjykatës, çdo ligj i brendshëm që mbron me dënime të rënda ose të posaçme politikanët dhe të gjithë zyrtarët e nivelit të lartë në përgjithësi (si presidentin, kryeministrin, ministrat, anëtarët e parlamentit etj.) kundër fyerjeve ose shpifjeve, në veçanti nga shtypi, do të ishte i papajtueshëm me nenin 10¹⁵⁹. Aty ku ekzistojnë dispozita të tilla dhe përdoren nga politikanët, gjykatat kombëtare duhet të mos i zbatojnë ato. Në vend të tyre mund të

¹⁵⁵ Paragrafi 42.

¹⁵⁶ Paragrafi 42.

¹⁵⁷ Paragrafi 43.

¹⁵⁸ Paragrafi 44.

¹⁵⁹ *Otegi Mondragon kundër Spanjës*, 15 mars 2011.

shërbejnë dispozitat ligjore të përgjithshme për fyerjet dhe shpifjet. Krahas kësaj, aty ku nderi dhe reputacioni i politikanëve është në konflikt me lirinë e shtypit, gjykatat kombëtare duhet të zbatojnë me kujdes parimin e proporcionalitetit dhe të vendosin nëse dënimi i një gazetari është një masë e nevojshme në një shoqëri demokratike, duke parë udhëzimet e dhëna nga gjykata në çështje të tilla si *Lingens*.

Në çështjen *Sanocki kundër Polonisë* Gjykata theksoi se megjithëse politikanët duhet të pranojnë kritika më të gjera, ata duhet të jenë në gjendje të mbrohen kur çmojnë se një botim që hedh dyshime mbi personin e tyre është i pavërtetë dhe mund të çorientojë publikun përsa i takon mënyrës së tyre të ushtrimit të pushtetit¹⁶⁰.

6.3. Zyrtarët dhe drejtuesit e lartë të Shërbimit Civil

Përsa i takon fyerjeve ose shpifjeve të zyrtarëve të nivelit të lartë (duke përfshirë presidentin e një vendi¹⁶¹, ministrat¹⁶², anëtarët e parlamentit etj.) ose nëpunësit civilë¹⁶³ (duke përfshirë oficerët e policisë, prokurorët dhe punonjësit e rendit, dhe të gjithë punonjësit publikë) ofrohet një nivel më i ulët mbrojtjeje (në krahasim me kritikën e drejtuar politikanëve). Duket se gjykata po e zgjeron “hapësirën e lejuar” për shprehjet fyese/kritike drejtuar zyrtarëve publikë ose enteve publike, që diskutojnë ose komentojnë për çështje me interes publik ose janë pjesë e debatit politik¹⁶⁴.

Në çështjen *Colombani dhe të Tjerë kundër Francës*, gjykata shqyrtoi ligjin francez për mbrojtjen e krerëve të shteteve në kontekstin e shpifjes për Mbretin e Marokut. Gjykata vërejtë se ligji priret t’i japë krerëve të shteteve një privilegj të jashtëzakonshëm:

Mbrojtja e tyre nga kritikën vetëm për shkak të funksionit ose të statusit, pavarësisht nëse kritikën janë të justifikuar...përbën dhënien e një privilegji të posaçëm krerëve të shtetit, gjë e cila nuk mund të pajtohet me praktikën moderne dhe konceptet politike. Cilido të jetë interesi i dukshëm që çdo shtet ka në ruajtjen e marrëdhënieve miqësore bazuar te besimi me udhëheqësit e shteteve të tjera, një privilegj i tillë e tejkalon atë që është e nevojshme për arritjen e atij objektivit¹⁶⁵.

¹⁶⁰ *Sanocki kundër Polonisë*, 17 korrik 2007, paragrafi 61.

¹⁶¹ Mbrojtja e një kryetari shteti të huaj u shqyrtua në çështjen *Eon kundër Francës*, 14 mars 2013. Gjykata vendosi se nuk kishte ndonjë shkak për të ofruar mbrojtje të posaçme për kryetarin e një shteti me anë të ligjeve kundër shpifjes ose fyerjes.

¹⁶² *Tuşalp kundër Turqisë*, 21 shkurt 2012.

¹⁶³ *Sokolowski kundër Polonisë*, 29 mars 2005.

¹⁶⁴ *Uj kundër Hungarisë*, 19 korrik 2011.

¹⁶⁵ *Colombani dhe të Tjerë kundër Francës*, 25 qershor 2002, paragrafi 68.

Në çështjen *Thorgeir Thorgeirson kundër Islandës*¹⁶⁶, gjykata konfirmoi lirinë e shtypit në kontekstin e kritikave për nëpunësit civilë. Kërkuesi (një shkrimtar) kishte botuar në një gazetë të përditshme dy artikuj në lidhje me brutalitetin e policisë.

Artikulli i parë kishte formën e një letre drejtuar ministrit të Drejtësisë, të cilit i kërkohej të ngrinte një komision “për hetimin e fjalëve, të cilat gradualisht po bëheshin opinion publik, se kishte gjithnjë e më tepër brutalitet në radhët e forcave të policisë së Reikjavikut dhe që zyrat për këtë brutalitet po mbyteshin në një mënyrë jo të natyrshme”. Përveç një gazetari që kishte qenë viktimë e brutalitetit policor, kërkuesi nuk i tregoi emrat e viktimave të tjera. Në përshkrimin e oficerëve të policisë dhe sjelljes së tyre, z. *Thorgeirson*, ndër të tjera, përdori shprehjet e mëposhtme: “kafshë të egra me uniformë që zvarriteshin, heshtazi ose jo, në xhunglën e jetës së natës të qytetit tonë”; “individë të kthyer në fëmijë të sapolindur si rezultat i kapjeve mbytëse që policët dhe rojet mësojnë dhe përdorin me spontanitet brutal në vend që të trajtojnë njerëzit me kujdes dhe maturi”, ose “duke lejuar shtazët dhe sadistët të realizonin perversionet e tyre”. Pas një programi televiziv ku policia i mohoi pretendimet për brutalitet, kërkuesi botoi një artikull të dytë, ku thoshte se: “sjellja [e policisë] ishte shumë tipike e asaj që po bëhej imazhi publik i policisë sonë në mbrojtje të vetvetes: bullizëm, falsifikim, veprime të paligjshme, supersticione, shkujdesje dhe marrëzi”. Kërkuesi u dënua me gjobë për shpifje për pjesëtarë të ndryshëm të forcave të policisë.

Përpara gjykatës, qeveria argumentoi se dënimi synonte të mbronte “reputacionin ...e të tjerëve”, pikërisht atë të oficerëve të policisë dhe krahas asaj, se kufijtë e kritikave të pranueshme ishin më të gjera vetëm përsa u takon fjalimeve politike. Megjithatë, gjykata vërejti “se nuk kishte tagër që në praktikën e saj gjyqësore të bënte dallimin, në mënyrën e sugjeruar nga qeveria, ndërmjet diskutimit politik dhe çështjeve të tjera të interesit publik”. Përsa i takon gjuhës, gjykata deklaroi se “të dy artikujt ishin realizuar me terma të fortë. Megjithatë, duke pasur parasysh qëllimin e tyre dhe ndikimin që kishin si destinacion, gjykata ishte e mendimit se gjuha e përdorur nuk mund të konsiderohej e tepërt.” Gjykata arriti në konkluzionin se “dënimi dhe vendimi i shpallur mund të dekurajonin diskutimin e hapur të çështjeve me interes publik” dhe se arsyet e parashtruara nga qeveria nuk provonin proporcionalitetin e ndërhyrjes së ndjekur në synimin e ligjshëm. Për rrjedhojë, dënimi i kërkuesit nuk ishte “i nevojshëm në një shoqëri demokratike”¹⁶⁷.

Në çështjen *Thoma kundër Luksemburgut*, një gazetar u urdhërua të paguante

¹⁶⁶ *Thorgeir Thorgeirson kundër Islandës*, 25 qershor 1992.

¹⁶⁷Paragrafët 64-69.

dëmspërblim për shkak të thënieve të tij, se të gjithë zyrtarët e Komisionit për Ujin dhe Pyjet ishin të korruptuar, përveç njërit. Duke marrë parasysh debatin e gjerë për këtë temë dhe interesin e përgjithshëm të krijuar nga ajo, gjykata konstatoi shkelje të nenit 10. Duke iu referuar kritikave të nëpunësve civilë, Gjykata u shpreh:

Nëpunësit civilë që veprojnë në cilësinë e zyrtarit, siç janë politikanët, i nënshtrohen kufijve më të gjerë të kritikave të pranueshme sesa personat privatë. Megjithatë, nuk mund të thuhet se nëpunësit civilë me vetëdije janë të hapur ndaj kontrolleve strikte të fjalëve dhe veprave të tyre në masën që janë politikanët dhe për rrjedhojë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë me këta të fundit kur është fjala për kritikën ndaj sjelljes së tyre¹⁶⁸.

Kritikave ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve individualë nuk iu ofrohet e njëjta mbrojtje – anëtarëve të gjyqësorit iu ofrohet mbrojtje e posaçme nga gjykata¹⁶⁹.

Në çështjen *Castells kundër Spanjës*¹⁷⁰, gjykata argumentoi në favor të një mbrojtjeje më të mirë të lirisë së shprehjes në emër të opozitës politike. Z. *Castells* ishte senator në parlamentin spanjoll dhe përfaqësonte një organizatë politike që përkrahte pavarësinë e rajonit bask. Në vitin 1979, ai shkroi një artikull të quajtur “*Pandëshkueshmëri mizore*”, i cili u botua në një gazetë të përditshme kombëtare. Z. *Castells* akuzoi qeverinë për mos hetimin e vrasjeve dhe sulmeve në rajonin bask dhe deklaroi: “Autorët e këtyre akteve kriminale vazhdojnë të punojnë dhe mbeten në poste me përgjegjësi, pa asnjë lloj ndëshkimi. Asnjë urdhër nuk është lëshuar për arrestimin e tyre”. Ai gjithashtu akuzoi qeverinë për bashkëfajësi në këto krime:

e djathta, që është në pushtet, i ka të gjitha mjetet në dispozicion (policinë, gjykatat dhe burgjet) për t’i gjetur dhe ndëshkuar autorët e kaq shumë krimeve. Por, mos u shqetësoni, e djathta nuk mund të ndëshkojë veten e saj.

...

Përgjegjësit për rendin publik dhe ndjekjen penale janë sot po ata që ishin dhe më parë.

Duke iu referuar grupeve ekstreme për këto krime, ai shkroi:

ata kanë dosje të konsiderueshme që mbahen të përditësuara. Kanë sasi të mëdha armësh dhe parash. Kanë burime dhe materiale të pakufizuara dhe veprojnë me pandëshkueshmëri të plotë...mund të thuhet se iu garantohet paraprakisht imuniteti nga ligji.

¹⁶⁸ *Thoma kundër Luksemburgut*, 29 mars 2001.

¹⁶⁹ *Błaja News Sp. z o.o. kundër Polonisë*, 26 nëntor 2013; *Łozowska kundër Polonisë*, 13 janar 2015.

¹⁷⁰ *Castells kundër Spanjës*, 23 prill 1992.

Z. Castells më tej thotë:

pas këtyre akteve mund të jetë vetëm qeveria, partia në pushtet dhe njerëzit e saj. E dimë se gjithnjë e më tepër ata po përdorin si instrument politik gjuetinë e pamëshirshme të disidentëve bask dhe eliminimin e tyre fizik...Por, për hir të viktimitës së radhës nga njerëzit tanë, ata që janë përgjegjës duhet të identifikohen menjëherë me publicitetin maksimal.

Z.Castells u akuzua për fyerje të qeverisë dhe u dënua me një vit burg, të cilin nuk e kreu asnjëherë.

Përpara gjykatës, autoritetet spanjolle argumentuan se dënimi i z. *Castells* shërbente për parandalimin e “prishjes së rendit dhe krimit”. Pas shqyrtimit nëse ndërhyrja ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, gjykata vendosi:

megjithëse liria e shprehjes është e rëndësishme për të gjithë, ajo është veçanërisht e tillë për përfaqësuesit e zgjedhur të popullit. Ata përfaqësojnë elektoratin e tyre, tërheqin vëmendjen për shqetësimet e tyre dhe mbrojnë interesat e tyre. Për rrjedhim, ndërhyrja në lirinë e shprehjes së një anëtari të opozitës në parlament, si kërkuesi, kërkon shqyrtim më të kujdesshëm nga ana e gjykatës¹⁷¹.

Më pas gjykata vuri në dukje se: “Z. *Castells* nuk e shprehu mendimin e tij nga dhoma e senatit, siç mund të kishte vepruar pa pasur frikën e ndëshkimit, por zgjodhi të vepronte me anë të një gazete. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ai e humbi të drejtën për të kritikuar qeverinë”.

Më tej, gjykata iu referua kritikave mbi qeverinë:

kufijtë e kritikave të lejueshme janë më të gjera për qeverinë sesa për një shtetas privat, ose madje edhe një politikan. Në një sistem demokratik, veprimet ose mosveprimet e qeverisë duhet t’i nënshtrohen shqyrtimit të kujdesshëm jo vetëm të autoriteteve legislative dhe gjyqësore, por edhe të shtypit dhe opinionit publik. Krahas kësaj, pozita dominuese e qeverisë e bën të nevojshme që ajo të tregojë përmbajtje në përdorimin e procedimeve penale, veçanërisht kur ka në dispozicion mjete të tjera për t’iu përgjigjur sulmeve dhe kritikave të pajustificuara të kundërshtarëve të saj ose medias¹⁷².

Gjykata konstatoi shkelje të nenit 10. Krahas kësaj, mendimi me të cilin pajtohej gjykatësi *De Meyer* thoshte se: “Nuk ka asnjë arsye për t’i dhënë mbrojtje më të mirë institucioneve sesa personave, ose qeverisë sesa opozitës”.

Në mënyrë të ngjashme me mësimet e nxjerra nga vendimet e mëparshme gjyqësore, gjykatat kombëtare duhet të kuptojnë se edhe sikur në parim nxitja e mosbindjes ligjore të jetë e dënueshme, gjyqtarët nuk duhet të japin auto-

¹⁷¹ Paragrafi 42.

¹⁷² Paragrafi 46.

matikisht ndëshkimin e parashikuar me ligj, por duhet të peshojnë interesat në konflikt dhe të zbatojnë parimin e proporcionalitetit kur marrin vendim nëse “në një shoqëri demokratike është i nevojshëm” dënimi i një ushtrimi të caktuar të lirisë së shprehjes.

Krahas kësaj, siç provohet nga vendimi gjyqësor në çështjen *Castells*, gjykatat kombëtare duhet të mos i ndëshkojnë kritikën për autoritetet shtetërore. Kritika të tilla, edhe kur janë të ashpra, janë pjesë e pluralizmit politik dhe pluralizmit të opinioneve.

Qëllimi për dënimin e një personi që ka fyer ose shpifur kundër një personi që i përket secilës prej dy kategorive të mësipërme megjithëse mund të justifikohet me nevojën për mbrojtjen e “reputacionit ose të drejtave të të tjerëve”, një dënim më i rëndë – parashikuar me ligj – sesa ai i dhënë për fyerje ose shpifje kundër një personi të thjeshtë, nuk do të ishte i justifikuar. Dënimet më të rënda për shpifje kundër nëpunësve civilë dhe zyrtarëve të lartë janë kundër parimit të barazisë përpara ligjit. Krahas kësaj, këto dënime më të rënda do të mbronin në mënyrë të nënkuptueshme më shumë të drejtat e personave që i kryejnë këto funksione. Ato do të mbronin nocionet abstrakte, si p.sh.: “autoritetin shtetëror” ose “prestigjin shtetëror”, të cilat nuk shfaqen në listën e nenit 10, paragrafi 2.

Krahas kësaj, vlera të tilla, si: “imazhi/nderi i vendit ose qeverisë”, “imazhi/nderi i kombit”, “simbole shtetërore ose simbole të tjera”, “imazhi/autoriteti i autoriteteve publike” (përveç gjykatave) nuk parashikohen në paragrafin 2, dhe për rrjedhojë nuk janë qëllime të ligjshme për kufizimin e lirisë së shprehjes. Kjo është arsyeja pse gjykatat kombëtare nuk duhet të dënojnë kritikën – e shprehura me anë të fjalëve, gjesteve, imazheve ose në ndonjë mënyrë tjetër – kundër nocioneve abstrakte, sepse dalin jashtë fushës së zbatimit të mbrojtur nga paragrafi 2. Shpjegimi i kësaj mund të gjendet në rregullat funksionale të një shoqërie demokratike, ku kritikën ndaj atyre (individëve dhe institucioneve) që ushtrojnë pushtetin janë një e drejtë themelore dhe detyrim për median, njerëzit e zakonshëm dhe shoqërinë. Për shembull, shkatërrimi ose një akt “fyerjeje” kundër një simboli shtetëror do të shprehte kundërshtimin dhe kritikën e dikujt ndaj vendimeve politike, aktivitetit të autoriteteve publike, politikave publike në fusha të caktuara, ose gjërave të tjera të lidhura me ushtrimin e pushtetit. Kundërshtime dhe kritika të tilla duhet të jenë të lira sepse është mënyra e vetme për të debatuar në publik padrejtësitë e mundshme dhe për të bërë korrigjimet e mundshme. Krahas kësaj, nocione të tilla të përgjithshme dhe abstrakte si “autoriteti shtetëror” zakonisht mbulojnë dhe fshehin interesa private dhe ndoshta të paligjshme të atyre në pushtet, ose të paktën interesin e tyre për të qëndruar në pushtet me çdo kusht.

Disa juridiksione europiane kanë eliminuar nga sistemet juridike të tyre mundësinë e mbrojtjes së reputacionit të institucioneve shtetërore. Gjykata pranoi “se mund të ketë arsye të shëndosha politike për të vendosur që organet publike [si p.sh. departamenti i menaxhimit të gjykatës], nuk duhet të ketë pozitën për të paditur në vetë cilësinë e tij”¹⁷³. Megjithatë, gjykata vendosi se nuk ishte “detyra e saj të shqyrtonte legjislacionin vendas në anën abstrakte, por të kishte parasysh mënyrën në të cilën zbatohet legjislacioni, ose prekte kërkuesin në një rast të caktuar”¹⁷⁴.

6.4. Kritikat ndaj subjekteve tregtare

Kritikat ndaj subjekteve tregtare u shqyrtuan nga gjykata në çështjen *Kuliś dhe Różycki kundër Polonisë*. Pronari dhe kryeredaktori i revistës polake me titull “Angora” dhe suplementit të saj për fëmijë, “Angorka”, botoi një artikull në revistën “Angorka” që i referohej një fushate reklamimi për patatinat e prodhuara nga shoqëria “Star Foods”. Faqja e parë e revistës shfaqte imazhin vizatimor të një djaloshi që mbante një pako patatina të shoqërisë “Star Foods” dhe që i thoshte qenit Reksio, një personazhi filmash vizatimor të famshëm për fëmijë, “Mos u mërzit! Edhe unë do të isha vrasës po ta haja këtë pisllek!”. Vizatimi në fjalë mbante titullin: “Fëmijët polakë të tronditur nga reklamimet e patatinave, Reksio është vrasës”. Në faqen pasuese kishte një artikull që raportonte se prindërit dhe fëmijët ishin të neveritur dhe madje të tmerruar për shkak të copave të vogla të letrës që tregonin se qeni Reksio ishte vrasës, që në atë kohë mund të gjendej në pakot e patatinave të sipërpërmendura. Më pas, shoqëria “Star Foods” ngriti padi për mbrojtjen e të drejtave personale kundër të dy kërkuesve, ku u kërkonte atyre të kërkonin ndjesë publike për diskreditimin e produkteve të saj pa asnjë justifikim dhe të bënin një pagesë prej PLN10000 për një bamirësi. Gjykata polake vendosi në favor të paditësit. Gjykata e Strasburgut vendosi se imazhi vizatimor në fjalë nuk përmbante një deklaratë shpifëse për faktet, por një gjykim vlerash të paraqitura në mënyrë satirike. Krahas kësaj, titulli i madh që i referohej një “fushate reklamimi tronditëse”, përdorimi i një slogani të diskutueshëm që gjendej në pakot e patatinave, si dhe artikulli në faqen e dytë qartësisht tregonin se imazhi vizatimor në fakt ishte frymëzuar nga fushata reklamuese e shoqërisë. Duke pasur të gjithë këtë në vëmendje, gjykata vendosi se qëllimi i kërkuesit nuk ishte diskreditimi i produktit në sytë e lexuesve, por rritja e ndërgjegjësimit për llojin e reklamimit që bënte paditësi me qëllim rritjen e çmimit, dhe për papranueshmërinë e tij kur vjen fjala për reklama të drejtuara të fëmijët¹⁷⁵.

¹⁷³ Romanenko dhe të Tjerë kundër Ruisë, 8 tetor 2009, paragrafi 39.

¹⁷⁴ Po aty.

¹⁷⁵ *Kuliś dhe Różycki kundër Polonisë*, 6 tetor 2009.

6.5. Mbrojtja e të miturve

Mbrojtje e veçantë i ofrohet edhe informacionit që ka të bëjë me të miturit. Në një rast që ka të bëjë me një artikull shtypi që trajtonte një konflikt kujdestarie ndërmjet prindërve, gjykata konstatoi se një fëmijë, që kishte qenë subjekt i artikujve në fjalë nuk ishte figurë publike, e as nuk kishte hyrë në sferën publike duke u bërë viktimë e konfliktit të kujdestarisë ndërmjet prindërve, që kishte tërhequr shumë vëmendjen e publikut. Artikujt trajtonin një çështje me interes publik duke krijuar një debat të gjerë, konkretisht zbatimin e duhur të vendimeve të kujdestarisë dhe nëse duhej ose mund të përdorej forca në këtë kontekst dhe deri në çfarë shkalle. Megjithatë, meqenëse as fëmija e as prindërit nuk ishin figura publike ose nuk kishin hyrë më parë në sferën publike, gjykata vendosi se nuk kishte qenë e nevojshme, për të kuptuar çështjen, që të zbulohesh identiteti i tij, detajet më intime të jetës së tij, ose të botohej një foto nga e cila mund të njihesh ai¹⁷⁶.

6.6. Autoriteti dhe paanësia e gjyqësorit

Jurisprudenca e gjykatës përsa i takon autoritetit dhe paanësisë së gjyqësorit provon se megjithëse gjyqësori gëzon mbrojtje të posaçme, ai nuk funksionon në vakuum dhe çështjet për administrimin e drejtësisë mund të jenë pjesë e debatit publik.

Në çështjen *The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar*¹⁷⁷, qeveria i justifikoi urdhrat ndalues kundër botimit të një artikulli gazete me citimin e interesit të mbrojtjes së paanësisë së gjyqësorit dhe ruajtjes së besimit të publikut tek autoritetet gjyqësore. Pas përdorimit të sedativit të quajtur “talidomid”, ndërmjet viteve 1959 dhe 1962, shumë fëmijë lindën me deformime të rënda. Ilaçi u prodhua dhe u shit nga shoqëria “*Distillers Company Ltd*”, e cila e hoqi nga tregu në vitin 1961. Prindërit e paditën shoqërinë, duke kërkuar dëmshpërblim dhe negociatat ndërmjet palëve vazhduan për shumë vite. Transaksionet e palëve duhet të miratoheshin nga gjykatat. Të gjitha gazetat, duke përfshirë edhe “*The Sunday Times*”, e trajtuan çështjen gjerësisht. Në vitin 1971, palët filluan negociatat për krijimin e një fondi bamirësie për fëmijët me deformime. Në shtator të vitit 1972, “*The Sunday Times*” botoi një artikull me titull “*Fëmijët tanë talidomid: shkak për turpin kombëtar*”, duke kritikuar shoqërinë për shumën e reduktuar të parave të paguara për viktimat dhe për shumën të vogël, të cilat shoqëria synonte t’i vendoste në fondin e bamirësisë. “*The Sunday Times*”

¹⁷⁶ *Kurier Zeitungsverlag und Druckerei GmbH kundër Austrisë (Nr. 2)*, 19 qershor 2012 dhe *Krone Verlag GmbH kundër Austrisë*, vendim i 19 qershorit 2012.

¹⁷⁷ *The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 26 prill 1979.

njoftoi se do të përshkruante në një artikull të ardhshëm rrethanat e tragjedisë. Me kërkesë të shoqërisë, prokurori i përgjithshëm i kërkoi gjykatës të lëshonte një urdhër ndalimi kundër gazetës, duke argumentuar se botimi i artikullit të njoftuar do të përbënte një pengesë për drejtësinë. Urdhri i ndalimit u lëshua dhe “*The Sunday Times*” nuk u lejua ta botonte artikullin.

Përpara Gjykatës së Strasburgut, “*The Sunday Times*” pretendoi për shkelje të nenit 10. Qeveria e justifikoi urdhrin e ndalimit me nevojën e ruajtjes së “autoritetit dhe paanësisë së gjyqësorit”, meqenëse çështjet për talidomidin ishin ende pezull përpara gjykatave. Gjykata deklaroi se:

ka një njohje të përgjithshme të faktit se gjykatat nuk mund të funksionojnë në vakuum. Megjithëse ato janë forumi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, kjo nuk do të thotë se nuk mund të ketë diskutim të mosmarrëveshjeve diku tjetër, qoftë në revista të specializuara, në shtypin e përgjithshëm ose në publikun e gjerë. Krahas kësaj, megjithëse masmedia nuk duhet të tejkalojë kufijtë e interesave të administrimit të duhur të drejtësisë, është detyrë e saj të japë informacion dhe ide për çështje që dalin përpara gjykatave si në fushat e tjera me interes publik. Jo vetëm media e ka detyrën e dhënies së informacionit dhe ideve: por edhe publiku ka gjithashtu të drejtën ta marrë¹⁷⁸.

Në rrethanat e veçanta të çështjes, gjykata vërejti se “fatkeqësia e talidomidit” ishte një çështje që shqetësonte padiskutim publikun. Krahas kësaj, familjet e përfshira në tragjedi, si dhe publiku i gjerë kishin të drejtën për t’u informuar për të gjitha faktet lidhur me këtë çështje. Gjykata arriti në konkluzionin se urdhri i ndalimit i nxjerrë kundër gazetës “nuk i korrespondonte një nevoje sociale me tryzni të mjaftueshme për të peshuar më shumë se interesi publik në lirinë e shprehjes brenda kuptimit të Konventës”¹⁷⁹.

Rregullat ekzistuese për kufizimin e fjalimeve shpifëse për shkak të mbajtjes së autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit rrjedhin nga dy çështje: *Nikula kundër Finlandës*¹⁸⁰ dhe *Morice kundër Francës*¹⁸¹. Në një memo të lexuar nga znj. *Nikula* përpara gjykatës së nivelit të parë, prokurori, z.T, u kritikua për “manipulimin e rolit dhe paraqitjen e paligjshme të provave”. Pas një procedimi privat të filluar nga z. T, znj. *Nikula* u dënua në vitin 1994 për shpifje publike të kryer pa informacion të saktë. Gjykata e Lartë la në fuqi dënimin penal në vitin 1996, por e kufizoi dënimin vetëm me pagimin e dëmshpërblimit dhe shpenzimeve gjyqësore. Precedenti në çështjen *Nikula* përcakton lirinë e avokatit të kritikojë sjelljen e një prokurori në gjykatë, gjatë mbrojtjes së klientit të tij/saj. Statusi i posaçëm i avokatëve iu jep atyre një pozitë qendrore në admi-

¹⁷⁸ Paragrafi 65.

¹⁷⁹ Paragrafi 67.

¹⁸⁰ *Nikula kundër Finlandës*, 21 mars 2002.

¹⁸¹ *Morice kundër Francës*, 23 prill 2015.

nistrimin e drejtësisë si ndërmjetës midis publikut dhe gjykatave. Pretendimet e kërkuetit u kufizuan vetëm në sallën e gjyqit, ndërsa kritikata për gjyqtarin dhe prokurorin dolën në media. Kërcënimi i rishikimit *ex post facto* të kritikave të avokatit për prokurorin është i vështirë të pajtohet me detyrimin e avokatit mbrojtës për mbrojtjen e zellshme të interesave të klientëve të tij/saj. Vlerësimi i argumenteve të mbrojtjes nuk duhet të ndikohet nga “efekti zbutës” i mundshëm i dënimit penal ose një detyrimi për pagimin e dëmshpërblimit për dëmin e pësuar ose kostot e realizuara.

Çështja *Morice* kishte të bënte me thëniet e bëra nga një avokat në të përditshmen franceze “*Le Monde*”; thëniet e përmbajtura në tekstin e një letre iu dërguan nga kërkueti ministrit të Drejtësisë ku kërkohet një hetim administrativ për të dy gjyqtarët. Dënimi penal – një gjobë prej 4000 Eurosh – u çmua të ishte një kufizim i justifikuar nga një dhomë e gjykatës, por kjo më pas u rrëzua si jo proporcionale nga Dhoma e Madhe e gjykatës. Siç u konstatua në një çështje tjetër, avokatëve nuk do t’iu jepet mbrojtje nga kritikata e drejtuara kundër gjyqtarëve specifikë. Shkrimet në letra qarkulluese për disa gjyqtarë, se njëri prej tyre është i “anshëm” dhe kishte kryer gabime“me dashje... me keqdashësi ose në pakujdesi të rëndë ose për shkak të mungesës së angazhimit”, pa dhënë prova të mjaftueshme për të provuar një keqdashësi të tillë, nuk mbrohen nga neni 10¹⁸².

Në çështjen *De Haes dhe Gijssels kundër Belgjikës*¹⁸³, kërkuetit, të dy gazetarë, trajtuan në gazetë një çështje të mbetur pezull përpara gjykatave. Në pesë artikuj, ata kritikuan me terma të fortë gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të cilët në një çështje divorci kishin dhënë vendimin që dy fëmijë në një familje të divorcuar të jetonin me babain e tyre. Babai, një noter i mirënjohur, ishte akuzuar më parë nga ish-bashkëshortja e tij dhe prindërit e saj për abuzim seksual të të dy fëmijëve. Në kohën e divorcit, hetimi kundër noterit ishte mbyllur pa akuzë.

Tre gjyqtarët dhe një prokuror i paditën dy gazetarët dhe gazetën, duke kërkuar dëmshpërblim për thëniet shpifëse. Gjykatat civile konstatuan se dy gazetarët kishin dyshime të forta për paanshmërinë e gjyqtarëve duke shkruar se ata qëllimisht kishin vendosur në mënyrë të padrejtë për shkak të marrëdhënies politike të ngushtë me noterin. Gazetarët u detyruan të paguanin dëmshpërblimin (një shumë simbolike) dhe të botonin vendimin gjyqësor në gjashtë gazeta me shpenzimet e tyre.

Gjykata pranoi se anëtarët e gjyqësorit duhet të gëzojnë besimin e publikut dhe

¹⁸² *Peruzzi kundër Italisë*, 30 qershor 2015, paragrafi 59.

¹⁸³ *De Haes dhe Gijssels kundër Belgjikës*, 24 shkurt 1997.

për rrjedhjë duhet të mbroheshin kundër sulmeve destruktive të pabazuara në fakte. Krahas kësaj, meqenëse ato kanë detyrimin e diskrecionit, gjyqtarët nuk mund t'i përgjigjen publikisht sulmeve të ndryshme, si për shembull, politikanët.

Duke parë artikujt në fjalë, gjykata vuri në dukje se ato përmbanin një informacion të detajuar, duke përfshirë mendimin e ekspertëve, duke provuar se gazetarët kishin bërë kërkime serioze përpara se të informonin publikun për çështjen. Artikujt ishin pjesë e një debati të madh publik mbi incestin dhe mënyrën sesi e kishte trajtuar gjyqësori çështjen. Duke i dhënë rëndësinë e duhur të drejtës së publikut për t'u informuar për një çështje me interes publik, gjykata vendosi se vendimi i gjykatave kombëtare nuk ishte "i nevojshëm në një shoqëri demokratike" dhe për rrjedhjë kishte shkëlqe të nenit 10.

Në parim, shpifja për një gjyqtar nga shtypi ndodh si pjesë e një debati për keqfunksionimin e sistemit gjyqësor ose në kontekstin e dyshimeve për pavarësinë ose paanshmërinë e gjyqtarëve. Çështje të tilla janë gjithnjë të rëndësishme për publikun dhe nuk duhen mbajtur jashtë debatit publik, në veçanti në një vend që kalon tranzicion drejt një gjyqësori të pavarur dhe efektiv¹⁸⁴. Kjo është arsyeja pse gjykatat kombëtare duhet të vlerësojnë vlerat dhe interesat e përfshira në çështjet ku kritikohen gjyqtarët dhe aktorë të tjerë të gjyqësorit. Gjykatat duhet të balancojnë nderin e gjyqtarit respektiv kundrejt lirisë së shtypit për të raportuar për çështjet me interes publik, dhe të vendosin për prioritetin në një shoqëri demokratike. Sigurisht, aty ku kritikata drejtohen kryesisht për të fyer ose shpifur kundër anëtarëve të gjyqësorit, pa kontribuar në debatin publik për administrimin e drejtësisë, atëherë mbrojtja e ofruar për lirinë e shprehjes mund të jetë më e vogël. Një çështje tjetër e rëndësishme në këtë titull është mundësia e kundërshtimit publik të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

6.7. Natyra e të shprehurit

Është karakteristike për nenin 10 të mbrojtë shprehjen që përmban një risk për dëmtimin ose faktikisht dëmtton interesat e të tjerëve. Zakonisht, mendimet e shumicës ose grupeve të mëdha të individëve nuk e kanë rrezikun e ndërhyrjes nga shtetet. Pra, mbrojtja e ofruar nga neni 10 përfshin gjithashtu informacionin dhe mendimet e shprehura nga grupe të vogla ose një person, edhe kur shprehje të tilla e tronditin shumicën. Toleranca ndaj pikëpamjeve individuale është një komponent i rëndësishëm i sistemit politik demokratik. Duke denoncuar tiraninë e shumicës, *John Stuart Mill* ka thënë: "Sikur i gjithë njerëzimi të ishte në një

¹⁸⁴ *Maciejewski kundër Polonisë*, 13 janar 2015.

mendje, e sikur vetëm njëri të ishte kundër, njerëzimi nuk do të ishte më i justifikuar për t'i mbyllur gojën atij personi sesa do të ishte i justifikuar ai person, sikur të kishte pushtetin, t'i mbyllte gojën njerëzimit"¹⁸⁵.

Në këtë drejtim, gjykata ka thënë se neni 10 nuk mbron vetëm:

“informacionin” ose “idetë që merren në mënyrë të favorshme ose konsiderohen jo fyese ose si çështje indiference, por gjithashtu edhe ato që fyejnë, tronditin ose shqetësojnë [...] të tilla janë kërkesat e atij pluralizmi, tolerance ose mendjegjerësie, pa të cilat nuk ka shoqëri demokratike”¹⁸⁶.

Përdorimi i shprehjeve vulgare në vetvete nuk është vendimtar në vlerësimin e një shprehjeje fyese sepse fare mirë mund t'i shërbejë qëllimeve thjesht stilistike. Për gjykatën, stili përbën pjesë të komunikimit si formë e shprehjes dhe si i tillë mbrohet bashkë me përmbajtjen e shprehjes¹⁸⁷.

Opinionet e shprehura me gjuhë të fortë ose të ekzagjeruar gjithashtu janë të mbrojtura; niveli i mbrojtjes varet nga konteksti dhe synimi i kritikës. Në çështjet e debateve publike ose me interes publik, gjatë një debati politik, në fushatat elektorale ose kur kritikata janë në nivelin e qeverisë, politikanëve ose autoriteteve publike, mund të priten fjalë të forta dhe kritika të ashpra dhe do të ketë një tolerancë më të madhe nga gjykata¹⁸⁸. Për shembull, në çështjen *Thorgeirson kundër Islandës*¹⁸⁹, gjykata konstatoi se megjithëse artikujt përmbanin fjalë shumë të forta – oficerët e policisë karakterizoheshin si “kafshë me uniformë”, “individë me mendjen e një fëmije të sapolindur si rezultat i kapjeve që policët dhe rojet mësojnë dhe përdorin me spontanitet brutal” dhe referenca te forcat e policisë ishin “bullizëm, falsifikim, akte të paligjshme, supersticione, shkuajdesje dhe marrëzi”- gjuha nuk mund të shihej si e tepërt duke pasur parasysht synimin e tyre për nxitjen e reformimit të policisë. Po kështu, në çështjen *Jersild kundër Danimarkës*¹⁹⁰, fakti se një intervistë me thënie raciste u transmetua në një program serioz lajmesh ishte i rëndësishëm sepse programi u konceptua për të informuar një auditor serioz për ngjarje në komunitet ose nga jashtë shtetit. Në çështjen *Dalban kundër Rumanisë*, ku një gazetar akuzoi një politikan për korrupsion dhe keqadministrim të pronës shtetërore, gjykata çmoi se “liria gazetareske përfshin gjithashtu përdorimin e mundshëm të një shkalle ekzagjerimi

¹⁸⁵ “*On Liberty*” (1859), Penguin Classics, 1985, f. 76.

¹⁸⁶ *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 7 dhjetor 1976, paragrafi 49; *Thorgeir Thorgeirson kundër Islandës*, 25 qershor 1992; *Jersild kundër Danimarkës*, 23 shtator 1994 (GC); *Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 27 mars 1996; *De Haes dhe Gijels kundër Belgjikës*, 24 shkurt 1997.

¹⁸⁷ *Uj kundër Hungarisë*, 19 korrik 2011, paragrafi 20.

¹⁸⁸ Liria e shprehjes duhet të jepet veçanërisht gjatë periudhës parazgjedhore kur votuesit duhet të informohen për kandidatët. *Kwiecien kundër Polonisë*, 9 janar 2007.

¹⁸⁹ *Thorgeir Thorgeirson kundër Islandës*, 25 qershor 1992.

¹⁹⁰ *Jersild kundër Danimarkës*, 23 shtator 1994.

apo madje edhe provokimi”¹⁹¹. Në çështjen *Arslan kundër Turqisë*, kërkuesi kritikonte veprimet e autoriteteve turke në juglindje të vendit duke përdorur fjalë të përshkruara nga gjykata, si “egërsi e pamohueshme”, e cila “i jep një shkallë vrelli kritikës”. Megjithatë, gjykata vendosi se dënimi i kërkuesit për kritikën ndaj qeverisë nuk ishte proporcional dhe jo i nevojshëm në një shoqëri demokratike¹⁹².

Përdorimit të termave shumë të fortë i ofrohet më shumë mbrojtje kur ato janë në përgjigje të një provokimi. Në çështjen *Lopes Gomes da Silva kundër Portugalisë*, gazetari kritikoi besimet politike të z. *Resende*, një kandidat për në bashki, dhe i quajti “groteske”, “qesharake”, “të rëndomta”. Kritikën erdhën pas deklaratave të z. *Resende*, ku ai i referohej një numri figurash publike në mënyrë therëse, duke përfshirë sulmet ndaj tipareve fizike (për shembull, një ish-kryeministër të Francës e quajti “çifut tullac”). Gjykata vuri në dukje se dënimi i gazetarit cenonte nenin 10 dhe vendosi se:

mendimet e shprehura nga z. *Resende* dhe të riprodhuara së bashku me editorialin e kundërshtuar janë të formuluar në mënyrë therëse, provokative dhe më së paku në mënyrë polemike. Nuk është e paarsyeshme të arrihet në përfundimin se stili i artikullit të kërkuesit ndikohej nga ai i z.*Resende*¹⁹³.

Ose, në çështjen *Oberschlick (2)*, gazetari e quajti z.*Haider* (udhëheqës i Partisë Austriake të Lirisë dhe Guvernator) “idiot” (“...ai nuk është nazist...megjithatë është idiot”) pas deklaratave të *Haiderit* se në Luftën e Dytë Botërore ushtarët gjermanë luftuan për paqe dhe liri. Gjykata konstatoi se vetë fjalimi i z.*Haider* ishte provokues dhe për rrjedhojë termi “idiot” nuk dukej disproporcional me indinjatën me vetëdije të nxitur nga z. *Haider*¹⁹⁴.

Megjithatë, gjykata i vendos kufijtë e ekzagjerimit në çështjet që lidhen me tabloidët. Artikujt e shkruar në mënyrë sensacionale, nuk do të mbroheshin nga gjykata¹⁹⁵. Në çështjen *Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés kundër Francës*¹⁹⁶, gjykata konstatoi se artikujt që përshkruanin një fëmijë jashtë martesë të Princit *Albert Grimaldi*, për shkak të tonit të tyre dukeshin si të matur dhe jo-sensacionale dhe për rrjedhojë iu dha mbrojtje sipas nenit 10.

6.8. Dallimi ndërmjet fakteve dhe opinioneve

Një nga dallimet më të rëndësishme që duhet bërë nga gjykatat kombëtare

¹⁹¹ *Dalban kundër Rumanisë*, 28 shtator 1999 (GC), paragrafi 49. Njësoj si *Prager dhe Oberschlick kundër Austrisë*, 26 prill 1995 dhe *Dichand dhe të Tjerë kundër Austrisë*, 26 shkurt 2002.

¹⁹² *Arslan kundër Turqisë*, 8 korrik 1999.

¹⁹³ *Lopes Gomes da Silva kundër Portugalisë*, 28 shtator 2000, paragrafi 35.

¹⁹⁴ *Oberschlick kundër Austrisë (Nr. 2)*, 1 korrik 1997.

¹⁹⁵ *Société Prisma Press kundër Francës*, 1 korrik 2003 (vendim).

¹⁹⁶ *Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés kundër Francës*, 10 nëntor 2015.

gjatë gjykimeve të çështjeve të shpifjeve është ai ndërmjet informacionit (fakteve) dhe mendimeve (grykimet e vlerave). Gjykata deklaroi se:

ekzistenca e fakteve mund të demonstrohet, ndërsa vërtetësia e gjykimeve të vlerave nuk është e provueshme....[Përsa i takon gjykimeve të vlerave ky] kriter për të provuarin e vërtetësisë së një grykimi të vlerave është i pamundur të përmbushet dhe cenon lirinë e vetë mendimit, që është pjesë themelore e të drejtës së garantuar nga neni 10¹⁹⁷.

Megjithëse mendimet janë këndvështrime ose vlerësime personale të ngjarjeve ose situatave dhe jo të provueshme si të vërteta ose të rreme, faktet mbi të cilat bazohet mendimi mund të jenë në gjendje të provohen si të vërteta ose të rreme. Po kështu, në çështjen *Dalban*, gjykata çmoi se: “do të ishte e papranueshme që një gazetari t’i ndalohej shprehja e gjykimeve kritike ndaj vlerave nëse nuk do të provonte vërtetësinë e tyre”¹⁹⁸.

Rrjedhimisht, së bashku me informacionin ose të dhënat që mund të vërtetohen, mendimet, kritikën ose spekulimet, që nuk mund t’i nënshtrohen “provës së vërtetësisë” mbrohen gjithashtu nga neni 10. Krahas kësaj, grykimet e vlerave, në veçanti ato të shprehura në fushën politike, gëzojnë mbrojtje të posaçme si kriter i pluralizmit të mendimit, i rëndësishëm për një shoqëri demokratike.

Dallimi ndërmjet fakteve dhe opinionëve, si dhe ndalimi i të provuarit të vërtetësisë së tyre, është bërë shumë i rëndësishëm në sistemet ligjore të brendshme që ende kërkojnë provën e vërtetësisë për krimin e “fyerjes”, që ka të bëjë me shprehjen e ideve dhe mendimeve. Krahas kësaj, edhe përsa i takon fakteve, gjykata ka pranuar mbrojtjen në mirëbesim për t’i lënë medias “një hapësirë për gabim”. Për shembull, në çështjen *Dalban*¹⁹⁹, gjykata vërejti “se nuk ka prova se përshkrimi i ngjarjeve të dhëna në artikuj ishte tërësisht i pavërtetë dhe ishte bërë për nxitjen e një fushate shpifjesh kundër G.S”. Në parim, mbrojtja në mirëbesim bëhet në kurriz të provës së vërtetësisë. Kur një gazetar ose një botim ka një qëllim të ligjshëm, çështja kthehet në interes publik, dhe bëhen përpjekje të arsyeshme për verifikimin e fakteve, por shtypi nuk do të jetë përgjegjës edhe sikur faktet respektive të mos provohen si të vërteta.

Megjithatë, një bazë e mjaftueshme faktesh duhet të mbështetë grykimet për vlerat. Gjykata madje vuri në dukje se:

kur një deklaratë përbën grykim vlerash, proporcionaliteti i ndërhyrjes mund të

¹⁹⁷ *Jerusalemi kundër Austrisë*, 27 shkurt 2001; *Dichand dhe të Tjerë kundër Austrisë*, 26 shkurt 2002.

¹⁹⁸ *Dalban kundër Rumanisë*, 28 shtator 1999 (GC).

¹⁹⁹ Po aty.

varet nga fakti nëse ekziston një bazë e mjaftueshme faktesh për deklaratën e kundërshtuar, sepse edhe një gjykim vlerash pa mbështetjen e ndonjë baze faktesh mund të jetë i tepërt²⁰⁰.

Në çështjen *Lingens*, të cituar më lart, qasja e gjykatave austriake përsa i takon mbrojtjes së të provuarit të vërtetësisë u çmua nga gjykata të ishte e gabuar. Gjykata theksoi dallimin ndërmjet “fakteve” dhe “gjykimeve të vlerave”, duke vënë në dukje se të provuarit e vërtetësisë së “gjykimeve të vlerave” është një detyrë e pamundur. Mendimet e kërkuarit për sjelljen politike të kancelarit ishin thjesht shprehje e të drejtës për mbajtjen dhe dhënien e mendimeve dhe jo të drejtës për dhënien e informacionit. Kriteri i të provuarit të vërtetësisë së gjykimeve të vlerave bie në kundërshtim me frymën e lirisë së mendimit. Gjykata vërejti gjithashtu se faktet mbi të cilat z. *Lingens* kishte bazuar gjykimet e tij të vlerave ishin të pakundërshtueshme dhe ai ishte në mirëbesim.

Parimet e zhvilluara nga gjykata në fushën e kritikave ndaj politikës dhe dallimit ndërmjet fakteve dhe mendimeve janë riafirmuar nga shumë vendime gjyqësore të tjera. Kështu në çështjen *Dalban kundër Rumanisë*, gjykata theksoi se “do të ishte e papranueshme që një gazetari t’i ndalohej shprehja e gjykimeve kritike ndaj vlerave nëse nuk do të provonte vërtetësinë e tyre”²⁰¹. Në çështjen *Oberschlick kundër Austrisë (Nr.2)*, përdorimi i termit “idiot” për të karakterizuar sjelljen e një politikani u çmua si i pranueshëm²⁰². Përsëri, në çështjen *Lopes Gomes da Silva kundër Portugalisë*, ku një kandidat në zgjedhjet lokale u quajt “grotesk”, “qesharak” dhe “i rëndomtë”, gjykata vendosi se megjithëse therëse, formulimet nuk ishin të ekzagjeruara dhe vinin në përgjigje të fjalimeve provokative të kandidatit. Gjykata vuri në dukje gjithashtu se “sharjet politike shpesh kalojnë në sferën personale; të tilla janë rreziqet e politikës dhe debatit të lirë të ideve, të cilat janë garanci për një shoqëri demokratike”²⁰³.

Po kështu, kur legjislacioni kombëtar parashikon mbrojtjen e të provuarit të vërtetësisë së shprehjeve fyese, gjykatat vendase nuk duhet të kërkojnë prova të tilla, duke ndjekur dallimin që bën gjykata ndërmjet fakteve dhe mendimeve.

6.9. Mirëbesimi dhe kujdesi i duhur

Mbrojtja e mirëbesimit duhet të pranohet nga gjykata në rastet e shpifjeve, të cilat në thelb kanë të bëjnë me fakte. Nëse, në kohën e botimit, një gazetar ka pasur arsye të mjaftueshme për të besuar se një informacion i caktuar ishte i

²⁰⁰ *Feldek kundër Sllovakisë*, 12 korrik 2001, paragrafi 76; *Kuliš dhe Rózycki kundër Polonisë*, 6 tetor 2009.

²⁰¹ *Dalban kundër Rumanisë*, 28 shtator 1999 (GC), paragrafi 49.

²⁰² *Oberschlick kundër Austrisë (Nr. 2)*, 1 korrik 1997.

²⁰³ *Lopes Gomes da Silva kundër Portugalisë*, 28 shtator 2000, paragrafi 34.

vërtetë, ai/ajo nuk duhet të dënohet. Lajmi është “produkt që skadon dhe të vonosh publikimin e tij, qoftë dhe për një kohë të shkurtër, mund t’ia heqë atij të gjithë vlerën dhe interesin”²⁰⁴. Për rrjedhojë, një gazetari duhet t’i kërkohe vetëm të bëjë një kontroll të arsyeshëm dhe të presupozojë në mirëbesim saktësinë e lajmit. Një argument tjetër në këtë drejtim ka të bëjë me mungesën e qëllimit, nga ana e gazetarit, për të shpifur për viktimën e pretenduar. Përsa kohë që gazetari ka besuar se informacioni është i vërtetë, një qëllim i tillë nuk ekziston dhe rrjedhimisht sjellja e gazetarit nuk mund të dënohet sipas dispozitave që ndalojnë shpifjet e qëllimshme; janë shpifjet e qëllimshme ato që parashikohen në legjislacionin penal.

Krahas kësaj, gazetarët nuk duhet të veprojnë vetëm në mirëbesim, por duhet të demonstrojnë zell dhe profesionalizëm në mbledhjen e informacionit dhe faktet, në veçanti, duhet të verifikohen me burime të besueshme. Kur “rrethanat kanë treguar një probabilitet të lartë saktësie nga personat që ishin burimi i informacionit për gazetarin, një verifikim veçanërisht i përpiktë i vërtetësisë së pretendimeve është i nevojshëm”²⁰⁵. Gjykatat kombëtare duhet të verifikojnë gjithmonë zellin me të cilin është mbledhur materiali gazetaresk. I njëjti standard duhet të zbatohet edhe ndaj grupeve të tjera profesioniste që gëzojnë lirinë e shprehjes, për shembull prodhuesit e filmave²⁰⁶.

6.10. Sanksionet

Gjykatat kombëtare nuk duhet të zbatojnë dënime penale dhe dënimet me burg në veçanti. Dënime të tilla rrezikojnë vetë thelbin e lirisë së shprehjes dhe veprojnë si censurë për të gjithë median, duke penguar shtypin në rolin e tij si rojtari publik.

Gjykata ritheksoi se natyra dhe ashpërsia e dënimeve të vendosura janë faktorë, të cilët duhet të merren në konsideratë kur vlerësohet proporcionaliteti i një ndërhyrjeje në lirinë e shprehjes së garantuar nga neni 10²⁰⁷. Në çështjen *Mahmudov dhe Agazade kundër Azerbajxhanit*, ku kërkuesit u dënuan me pesë vjet burgim, gjykata theksoi se:

Megjithëse dënimi është në parim çështje e gjykatave vendase, dhënia e një dënimi me burgim për një vepër kundër shtypit do të jetë i pajtueshëm me lirinë e shprehjes së gazetarëve të garantuar nga neni 10 i Konventës vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, pikërisht kur të drejtat e tjera themelore janë cenuar

²⁰⁴ *The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar (Nr. 2)*, 26 nëntor 1991, paragrafi 51.

²⁰⁵ *Stankiewicz dhe të Tjerë kundër Polonisë*, 14 tetor 2014, paragrafi 58.

²⁰⁶ *Braun kundër Polonisë*, 4 nëntor 2014.

²⁰⁷ *Ceylan kundër Turqisë*, 8 korrik 1999 (GC), paragrafi 37 dhe *Skalka kundër Polonisë*, 27 maj 2003, paragrafët 41-42.

rëndë, si për shembull, në rastet e fjalimeve që shprehin urrejtje dhe nxisin dhunën²⁰⁸.

Ndërprerja me kusht e procedimeve për një periudhë prove u konsiderua gjithashtu një ndërhyrje jo proporcionale në lirinë e shprehjes²⁰⁹.

Edhe kur dënimet penale përbëhen nga gjoba relativisht të vogla, gjykata argumentoi kundër këtyre dënimeve, sepse ato mund të luajnë rolin e një censure të nënkuptuar. Në çështjet e tjera ku gazetarët u gjobitën, gjykata vendosi se:

Megjithëse dënimi i dhënë për autorin nuk e pengonte atë në mënyrë strikte të shprehte mendimet e tij, ai përbënte një lloj censure, që me shumë gjasa do ta dekurajonte atë nga bërja e kritikave të atij lloji në të ardhmen...Në kontekstin e debatit politik, një dënim i tillë me gjasa do të frenonte gazetarët nga kontributi në diskutimet publike për çështje që prekin jetën e komunitetit. Në të njëjtën mënyrë, një dënim si ky ka të ngjarë të pengojë shtypin të kryejë detyrën e tij si furnizues i informacionit dhe rojtar publik²¹⁰.

Efekti zbutës i dënimeve penale është veçanërisht i rrezikshëm në rastet e fjalimeve politike dhe debatit me interes publik²¹¹.

Krahas kësaj, gjobat dhe shpenzimet gjyqësore mund të përbëjnë ndërhyrje në të drejtën e lirisë së shprehjes ku shumica e tyre ngre dyshime në lidhje me mbijetesën financiare të personit që urdhërohet t'i paguajë ato²¹².

Ka një konsensus të përgjithshëm ndër organet e specializuara ndërkombëtare dhe organizatat rajonale se jo vetëm zbatimi i dënimeve penale, por gjithashtu edhe fakti i thjeshtë që këto dënime mund të zbatohen, ka efekte të mëdha të padëshirueshme mbi lirinë e shprehjes dhe informacionin. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës ka bërë thirrje për dekriminalizimin e shpifjes.²¹³ Një përmirësim i tillë është trajtuar nga Komiteti i Ministrave²¹⁴.

Kompensimet e rëndësishme civile mund të përbëjnë një ndërhyrje dispropor-

²⁰⁸ *Mahmudov dhe Agazade kundër Azerbajxhanit*, 18 dhjetor 2008, paragrafi 50.

²⁰⁹ *Długolecki kundër Polonisë*, 24 shkurt 2009.

²¹⁰ *Lingens kundër Austrisë*, 8 korrik 1986, paragrafi 44; *Barthold kundër Gjermanisë*, 25 mars 1985.

²¹¹ *Lewandowska-Malec kundër Polonisë*, 18 shtator 2012, paragrafi 70.

²¹² *Open Door dhe Dublin Well Woman kundër Irlandës*, 29 tetor 1992.

²¹³ Rezoluta 1577 (2007) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, Drejt dekriminalizimit të shpifjes, miratuar më 4 tetor 2007, e disponueshme në adresën: <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML.en.asp?fileid=17588&lang=en>.

²¹⁴ Deklaratë e Komitetit të Ministrave për Dëshirueshmërinë e Standardeve Ndërkombëtare që trajtojnë Gjetjen e Gjykatës së Favorshme për gjykimin e Shpifjes, "Turizmin për Shpifje", për garantimin e Lirisë së Shprehjes, miratuar më 4 korrik 2012 në takimin e 1147-të të zëvendësministrave.

cionale në lirinë e shprehjes. Në çështjen *Tolstoy Miloslav kundër Mbretërisë së Bashkuar*, gjykatat kombëtare konstatuan se kërkuesi (bazuar në sistemin me juri) kishte shkruar një artikull shpifës dhe iu kërkua (së bashku me shpërndarësin e artikullit) t'i paguante viktimës dëmshpërblimin që shkonte në shumën prej GBP1500000²¹⁵. Duke çmuar se shumica e dëmshpërblimit ishte në vetvete shkelje e nenit 10, Gjykata Europiane theksoi:

...kjo nuk do të thotë se juria ishte e lirë të jepte çdo vendim që e shihte të përshtatshëm sepse, sipas Konventës, dhënia e dëmshpërblimit për shpifje duhet të ketë lidhje të arsyeshme me proporcionalitetin e dëmtimit të reputacionit.

Juria ishte udhëzuar të mos e dënonte kërkuesin, por vetëm ta bënte të jepte një dëmshpërblim që do të kompensonte dëmin jo financiar ndaj Lordit *Aldington* [viktima].

Krahas kësaj, gjykata theksoi se “fushëveprimi i kontrollit gjyqësor ... në kohën e çështjes së kërkuesit nuk ofronte mbrojtje efektive dhe të përshtatshme kundër dëmshpërblimit disproporcionalisht të madh.”Për rrjedhojë,

duke pasur parasysh madhësinë e dëmshpërblimit në rastin e kërkuesit në lidhje me mungesën e mbrojtjes efektive dhe të përshtatshme në kohën e duhur kundër një dëmshpërblimi disproporcionalisht të madh, Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të të drejtave të kërkuesit sipas nenit 10 të Konventës.

Në një vendim të kohëve të fundit, *Kurski kundër Polonisë*²¹⁶, Gjykata konstatoi se detyrimi për mbulimin e kostove të shtypjes ose transmetimit të ndjesave publike mund të jetë i tepërt dhe jo proporcional. Në këtë rast, kostoja e publikimit të ndjesave përbënte ekuivalentin e një page 18-mujore për kërkuesin. Gjykata gjeti shkelje të nenit 10.

Të gjitha udhëzimet e mësipërme në lidhje me dallimin ndërmjet gjykimeve të vlerave dhe fakteve dhe dënimit e dhëna nga Gjykata për gjykatat kombëtare zbatohen njësoj për kritikën ndaj nëpunësve civilë dhe çdo kritike tjetër që ka si synim të sjellë në debatin publik çështje me interes për komunitetet dhe publikun e gjerë.

²¹⁵ *Tolstoy Miloslavsky kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 13 korrik 1995.

²¹⁶ *Kurski kundër Polonisë*, 5 korrik 2016.

Kapitulli 7

Të drejtat e të tjerëve

Liria e shprehjes mund të përplasët me të drejta të tjera të mishëruara në Konventë, veçanërisht me lirinë e besimit fetar. “Të drejtat e të tjerëve”, pikërisht liria e besimit fetar kundrejt lirisë së shprehjes, u shqyrtuan nga gjykata në çështjen *Otto-Preminger-Institut kundër Austrisë*²¹⁷. Në këtë çështje, kërkuesi, një shoqatë (“OPI”) me seli në Innsbruck, njoftoi një seri prej gjashtë shfaqjesh, të aksesueshme për publikun e gjerë, të filmit “*Këshill në Parajsë*” nga *Werner Schroeter*. Njoftimi mbante edhe një deklaratë, ku thuhej se në përputhje me ligjin, filmi ndalohej të shihej nga personat nën moshën 17 vjeç. Filmi portretizonte Zotin e besimeve çifute, të krishtere dhe myslimane si një plak të vjetër të gjunjëzuar përpara Djallit, me të cilin shkëmbente një puthje të thellë, duke e quajtur Djallin mikun e tij. Skena të tjera tregonin virgjëreshën Marie duke dëgjuar një histori të turpshme dhe një shkallë tensioni erotik përshkruhej ndërmjet virgjëreshës Marie dhe Djallit. Jezu Krishti i rritur portretizohej si një i mangët mendërisht i gradës së ulët, dhe në një skenë ai tregohet në përpjekje për të përkëdhelur dhe puthur gjinjtë e nënës së tij, e cila shfaqej sikur e lejonte këtë. Zoti, virgjëresha Marie dhe Jezu Krishti tregoheshin duke duartrokitur Djallin.

Përpara shfaqjes së parë, me kërkesë të dioqezës në Innsbruck të Kishës Katolike Romane, prokurori filloi procedimin penal kundër drejtorit të “OPI” me akuzën e “denigrimit të doktrinave fetare”. Pas shikimit të filmit, një gjykatë vendase urdhëroi sekuestrimin e tij. Për rrjedhojë, shfaqjet publike nuk u zhvilluan. Procedimi penal u ndërpre dhe çështja vazhdoi vetëm me qëllimin e sekuestrimit. “OPI” bëri ankim në Komisionin Europian, duke argumentuar se e drejta e saj sipas nenit 10 ishte shkelur me sekuestrimin e filmit. Komisioni u pajtua me këtë këndvështrim.

²¹⁷ *Otto-Preminger-Institut kundër Austrisë*, 20 shtator 1994.

Përpara Gjykatës, qeveria argumentoi se sekuestrimi i filmit synonte të “mbronte të drejtat e të tjerëve”, në veçanti të drejtën e respektimit të ndjenjave fetare dhe të “parandalonte prishjen e rendit”. E drejta e respektimit të ndjenjave fetare është pjesë e të drejtës së lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar, e parashikuar nga neni 9 i Konventës. Duke parë ligjshmërinë e këtij synimi, gjykata theksoi:

ata që zgjedhin të ushtrojnë lirinë e manifestimit të besimit të tyre fetar, pavarësisht nëse veprojnë kështu si anëtarë të shumicës ose pakicës fetare, nuk mund të presin në mënyrë të arsyeshme të përjashtohen nga të gjitha kritikrat. Ata duhet të tolerojnë dhe pranojnë mohimin nga të tjerët të besimeve fetare të tyre dhe madje dhe përhapjen nga të tjerët të doktrinave të kundërta me besimin e tyre. Megjithatë, mënyra në të cilën kundërshtohen ose mohohen doktrinat dhe besimet fetare është një çështje që mund të angazhojë përgjegjësinë e shtetit, pikërisht përgjegjësinë e tij për të garantuar gëzimin paqësor të së drejtës së garantuar sipas nenit 9...për mbajtësit e këtyre besimeve dhe doktrinave. Në fakt, në raste ekstreme, efekti i metodave të caktuara të kundërshtimit ose mohimit të besimeve fetare mund të jetë i tillë që t'i pengojë ata që i kanë këto besime nga ushtrimi i lirisë së tyre për t'i mbajtur dhe ushtruar ato.

Respektimi i ndjenjave fetare të besimtarëve i garantuar nga neni 9...mund të mendohet në mënyrë legjitime të jetë shkelur nga portretizimet provokative të objekteve të adhurimit fetar; dhe këto portretizime mund të konsiderohen si shkelje keqdashëse të frymës së tolerancës, e cila duhet të jetë gjithashtu tipar i një shoqërie demokratike. Konventa duhet të lexohet si një e tërë dhe për rrjedhojë interpretimi dhe zbatimi i nenit 10...në rastin aktual duhet të jetë në harmoni me logjikën e Konventës²¹⁸.

Më tej, gjykata iu referua detyrimit për shmangien e “shprehjeve që janë fyese në mënyrë të paarsyeshme ndaj të tjerëve...të cilat...nuk kontribuojnë për asnjë formë të debatit publik në progresin e çështjeve njerëzore”²¹⁹.

Në mbrojtje të pozitës së saj, qeveria theksoi rolin e besimit fetar në jetën e përditshme të njerëzve në *Tyrol*, ku pjesa e besimtarëve katolikë ishte 87%.Duke balancuar dy vlerat konfliktuale, gjykata vendosi:

Gjykata nuk mund të mos përfillë faktin se besimi katolik është besimi i shumicës mbizotëruese në *Tyrol*. Në sekuestrimin e filmit, autoritetet austriake vepruan për garantimin e paqes fetare në atë rajon dhe për parandalimin e bërjes objekt të disa

²¹⁸ Paragrafi 47.

²¹⁹ Paragrafi 49.

njerëzve të sulmeve mbi besimet fetare të tyre në mënyrë fyese dhe të pajustificuar. I takon në radhë të parë autoriteteve kombëtare, që janë në pozitë më të mirë sesa gjykatësit ndërkombëtarë, të vlerësojnë nevojën për një masë të tillë duke pasur parasysh situatën lokale në një kohë të caktuar. Bazuar në të gjitha rrethanat e çështjes në fjalë, gjykata nuk është e mendimit se autoritetet austriake kanë shkelur hapësirën e tyre të vlerësimit në këtë drejtim²²⁰.

Rrjedhimisht, sekuestrimi i filmit nuk e shkel nenin 10.

Është interesante të vihet re se tre gjyqtarë në pakicë argumentuan në favor të shkeljes së nenit 10:

nuk duhet që autoritetet shtetërore të vendosin nëse një thënie e caktuar është në gjendje të “kontribuojë në ndonjë formë të debatit publik duke sjellë progres në çështjet njerëzore”; një vendim i tillë nuk mund të priset nga ideja për “progres” e autoriteteve.

...

Nevoja për veprime represive që shkojnë në ndalimin e plotë të ushtrimit të lirisë së shprehjes mund të pranohet vetëm nëse sjellja në fjalë arrin në një nivel kaq të lartë abuzimi, dhe vjen kaq afër me mohimin e lirisë së besimit fetar të të tjerëve, saqë e humbet vetë të drejtën për t’u toleruar nga shoqëria.

...

...filmi duhet t’i shfaqej një audience me pagesë në një “kinema arti” që mbante një publik relativisht të vogël me shije për filma eksperimentalë. Për rrjedhojë nuk kishte të ngjarë që audience të përfshinte persona të pa interesuar për filmin.

Për më tepër, kjo audience kishte mundësi të lajmërohej përpara për natyrën e filmit.

...

Pra, në rastin konkret, duket se kishte pak gjasa që njerëzit të përballeshin me materiale të kundërshtueshme pa dijeni.

Rrjedhimisht, arrijmë në përfundimin se shoqata e kërkuesit veptoi në mënyrë të përgjegjshme e të arsyeshme duke arritur të kufizonte efektet e dëmshme të shfaqjes së filmit.

²²⁰ Paragrafi 56.

Kapitulli 8

Liria e shprehjes dhe media

8.1. Liria e shtypit

Gjykata, megjithëse neni 10 nuk e përmend shprehimisht lirinë e shtypit, ka përpunuar një grup parimesh dhe rregullash në jurisprudencën e saj që i japin shtypit status të veçantë në gëzimin e lirive që përmban ky nen. Rrjedhimisht, liria e shtypit meriton vlerësim të mëtejshëm në zbatim të nenit 10. Një tjetër argument në favor të vlerësimit të lirisë së shtypit tregohet në praktikat kombëtare: në një shkallë të madhe, viktimat e shkeljes së të drejtës për lirinë e shprehjes nga autoritetet publike janë gazetarët dhe jo personat e tjerë.

Roli i shtypit si “rojtar publik” u theksua për herë të parë nga gjykata në çështjen *Lingens kundër Austrisë*²²¹. Në disa artikuj, gazetari kishte kritikuar Kancelarin e atëhershëm Federal të Austrisë për një lëvizje të caktuar politike që konsistonte në shpalljen e koalicionit me një parti të udhëhequr nga një njeri me një të kaluar naziste. Gazetari (z.*Lingens*) e kishte cilësuar sjelljen e kancelarit “imorale”, “jo dinjitoze” dhe provë të “oportunitizmit më të ulët”. Pas një procedimi ligjor privat të filluar nga kancelari, gjykatat austriake i çmuan këto thënie si shpifje dhe e dënuan gazetarin me gjobë. Duke argumentuar fajësinë, gjykatat konstatuan gjithashtu se gazetari nuk mund të provonte vërtetësinë e pretendimeve të tij. Përsa i takon kësaj çështjeje, gjykata vendosi se qasja e gjykatave kombëtare ishte e gabuar, sepse mendimet (gjykimet e vlerave) nuk mund të demonstrohen dhe nuk janë të provueshme²²². Duke parë shkaqet për dënimin e gazetarit, gjykata nënvizoi rëndësinë e lirisë së debatit politik:

Këto parime janë me rëndësi të veçantë përse i takon shtypit. Megjithëse, ndër të tjera shtypi nuk duhet të tejkalojë kufijtë e vendosur për “mbrojtjen e reputacionit të të tjerëve”, gjithsesi i takon atij të japë informacion për çështje politike njësoj si

²²¹ *Lingens kundër Austrisë*, 8 korrik 1986.

²²² Paragrafi 12.

në rastin e fushave të tjera me interes publik. Jo vetëm që shtypi ka detyrën e dhënies së informacionit dhe mendimeve të tilla: edhe publiku ka të drejtën t'i marrë ato...Në këtë lidhje, gjykata nuk mund të pranojë mendimin e shprehur në vendimin gjyqësor të Gjykatës së Apelit të Vjenës me efektin se detyra e shtypit ishte dhënia e informacionit, interpretimi i të cilit duhej t'i lihej kryesisht lexuesit²²³.

Në të njëjtin vendim gjyqësor, gjykata argumentoi se liria e shtypit i jep publikut një nga mjetet më të mira të zbulimit dhe formimit të mendimeve dhe qëndrimeve të udhëheqësve politikë dhe për pasojë liria e debatit politik është në thelb të konceptit të një shoqërie demokratike. Si rezultat, gjykata i jep debatit politik të zhvilluar nga shtypi një mbrojtje të fortë në zbatim të nenit 10.

Gjykata përsëriti me terma të fortë se një organizatë joqeveritare mund të luajë një rol po aq të rëndësishëm sa shtypi në një shoqëri demokratike: “kur një OJQ tërheq vëmendjen drejt çështjeve me interes publik, ajo po kryen rolin e rojtarit publik me të njëjtën rëndësi si ai i shtypit”²²⁴.

Gjykata ka nënvizuar rolin e posaçëm të shtypit në një debat politik. Në çështjen *Castells kundër Spanjës*, të diskutuar gjerësisht në kapitullin VI, kërkuesi, një militant bask dhe anëtar i parlamentit spanjoll, ishte dënua për fyerje ndaj qeverisë për botimin e një artikulli, ku akuzonte qeverinë për mbështetjen ose tolerimin e sulmeve ndaj baskëve nga grupe të armatosura. Në këtë drejtim, gjykata bëri vërejtjen e mëposhtme:

Roli i rëndësishëm që ka shtypi në një shtet të së drejtës nuk duhet të harrohet... Liria e shtypit i jep publikut një nga mjetet për zbulimin dhe krijimin e mendimeve dhe qëndrimeve të udhëheqësve të tij politikë. Në veçanti, i jep politikanëve mundësinë e reflektimit dhe komentimit për shqetësimet e opinio-nit publik; pra i mundëson të gjithëve të marrin pjesë në debatin e lirë politik, që është në thelb të konceptit të një shoqërie demokratike²²⁵.

Liria e shtypit gëzon gjithashtu një status të posaçëm kur çështjet me interes publik janë në rrezik. Në çështjen *Thorgeir Thorgeirson kundër Islandës*, kërkuesi (z. *Thorgeirson*) ishte shprehur në shtyp për brutalitetin e policisë në Islandë, dhe i kishte quajtur policët “kafshë me uniformë”, “individë me mendjen e një foshnje për shkak të kapjeve që mësojnë dhe përdorin policët dhe rojet me spontanitet”, dhe i akuzoi forcat e policisë për përdorim të “bullizmit, falsifikimit, akteve të paligjshme, supersticioneve, shkujdesjes dhe marrëzisë” kur mbrojnë veten. Në nivelin kombëtar, z. *Thorgeirson* u ndoq ligjërisht dhe u gjobit për shpifje kundër anëtarëve të pidentifikuar të forcave të policisë. Gjykata theksoi se kërkuesi e kishte ngritur çështjen e brutalitetit të policisë në vendin e tij

²²³ Paragrafi 41.

²²⁴ *Animal Defenders International kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 22 prill 2013 (G C), paragrafi 103.

²²⁵ *Castells kundër Spanjës*, 23 prill 1992, paragrafi 43.

dhe se “i takonte [shtypit] të jepte informacion dhe mendime për çështje me interes publik”. Gjykata më tej deklaroi se “nuk ka tagër në praktikën e saj për dallimin ...ndërmjet diskutimit politik dhe diskutimit të çështjeve të tjera me preokupim publik”. Së fundi, gjykata e përshkroi dënimin “në gjendje të dekurojojë diskutimin e hapur të çështjeve që shqetësojnë publikun”²²⁶. Ose, në çështjen *Marônek kundër Sllovakisë*, gjykata e çmoi politikën e strehimit në Sllovaki në një periudhë kur apartamentet shtetërore po privatizoheshin si çështje me interes publik, dhe i ofroi një mbrojtje më të fortë²²⁷ lirisë së shprehjes së kërkuesit. Shembuj të tjerë mund të gjenden në shumë raste kundër Turqisë, ku konflikti në juglindje të vendit dhe çështje të lidhura me të, duke përfshirë “agjendën separatiste” ose çështjen e federalizimit, të ngritur me gojë ose me shkrim, kanë qenë çështje me interes publik²²⁸.

Pa dyshim, gjykata i jep mbrojtje të fortë lirisë së shtypit kur debatohen publikisht çështje me interes publik dhe jo çështje të tjera. Çështjet me interes publik mund të kenë të bëjnë me shqetësime të ndryshme, si për shembull, problemet në komunitetet lokale²²⁹, funksionimin e një shkolle filllore²³⁰ ose ndotjen e mjedisit²³¹.

Një çështje tjetër e rëndësishme në kontekstin e lirisë së shtypit është botimi i thashethemeve dhe pretendimeve, të cilat gazetarët nuk mund t’i provojnë dot. Gjykata, siç u përmend më lart²³², ka theksuar se gjykimet e vlerave nuk duhet t’i nënshtrohen kriterit të vërtetësisë. Në çështjen *Thorgeir Thorgeirson kundër Islandës*²³³, pretendimet kundër policisë u mblodhën nga burime të ndryshme, por artikulli kishte përmendur fjalë që dilnin nga publiku në përgjithësi. Megjithatë shteti i paditur argumentoi se artikujve të kërkuesit i mungonte baza faktike dhe objektive, sepse ai nuk mund të provonte vërtetësinë e pretendimeve të tij, gjykata çmoi se kriteri i vërtetësisë ishte i paarsyeshëm, në mos i pamundur dhe theksoi se shtypi zor se do të ishte në gjendje të botonte ndonjë artikull po t’i kërkohet të shfaqte vetëm faktet e provuara plotësisht. Sigurisht, mendimet e gjykatës duhet të zëvendësohen në kontekstin e debateve publike për çështje me interes të përgjithshëm.

Përhapja në media e thënieve të bëra nga persona të tjerë u mor në shqyrtim nga gjykata në çështjet *Jersild kundër Danimarkës*²³⁴ dhe *Thoma kundër Luksemburgut*²³⁵, ku ajo theksoi se:

²²⁶ *Thorgeir Thorgeirson kundër Islandës*, 25 qershor 1992, paragrafët 64-6.

²²⁷ *Marônek kundër Sllovakisë*, 19 prill 2001.

²²⁸ *Süreke dhe Özdemir kundër Turqisë*, 8 korrik 1999; *Şener kundër Turqisë*, 18 korrik 2000; *Özgür Gündem kundër Turqisë*, 16 mars 2000.

²²⁹ *Kurlowicz kundër Polonisë*, 22 qershor 2010.

²³⁰ *Gatus kundër Polonisë*, 15 nëntor 2011 (vendim).

²³¹ *Dubowska dhe Skup kundër Polonisë*, 18 prill 1997 (vendim).

²³² Kapitulli 6.8.

²³³ *Thorgeirson kundër Islandës*, 25 qershor 1992, paragrafi 65.

²³⁴ Paragrafi 35.

²³⁵ Paragrafi 62.

Ndëshkimi i një gazetari për ndihmën e dhënë në përhapjen e thënieve të bëra nga një person tjetër... do të dëmtonte rëndë kontributin e shtypit në diskutimet e çështjeve me interes publik dhe nuk duhet të parashikohet po të mos ketë arsye veçanërisht të forta për të vepruar ashtu²³⁶.

Më tej, në çështjen *Thoma*, ku qeveria kishte kritikuar gazetarin kërkues për mosdistançimin e tij nga thëniet e cituara, Gjykata theksoi:

kriteri i përgjithshëm që gazetaret të distancohen sistematikisht dhe zyrtarisht nga përmbajtja e citimeve që mund të fyejnë ose provokojnë të tjerë ose dëmtojnë reputacionin e tyre nuk ishte në pajtim me rolin e shtypit për dhënien e informacionit për ngjarjet aktuale, mendimet dhe idetë²³⁷.

8.2. Detyrimet pozitive të shtetit dhe mbrojtja e gazetarëve

Shteteve iu kërkohet të mos ndërhyjnë në ushtrimin e të drejtave. Megjithatë, atyre iu kërkohet edhe të veprojnë pozitivisht në ndërmarrjen e hapave të nevojshëm për garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut për individët, duke për-fshirë pengimin e ndërhyrjes në të drejtat e personave nga aktorë privatë ose jo-shtetërorë²³⁸. Shtetet mund të bëhen “përgjegjëse për aktet e personave pri-vatë” në përmbushjen e detyrimeve të tyre ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Në kontekstin e aktivitetit të medias, gjykata ka konstatuar se këto detyrime mund të lindin sipas nenit 2²³⁹ dhe nenit 3²⁴⁰. Një detyrim pozitiv mund edhe të lindë në zbatim të nenit 10. Kjo ndodh sepse gjykata risjell në vëmendje rëndësinë kyçe të lirisë së shprehjes si një prej parakushteve për një demokraci funksionale dhe se shtetet duhet të garantojnë ushtrimin efektiv nga individët privatë të të drejtës së komunikimit ndërmjet tyre²⁴¹.

Në çështjen *Özgür Gündem kundër Turqisë*, një çështje që kishte të bënte me gazetarë të gazetës pro-PKK dhe punonjës të medieve që i ishin nënshtruar një fushate dhune dhe frikësimi, gjykata theksoi rëndësinë e marrjes së hapave pozitive për ushtrimin e lirisë së shprehjes si dhe konsideratave që japin informacion për fushëveprimin e këtyre detyrimeve pozitive mbi shtetin. Gjykata deklaroi:

²³⁶ *Jersild kundër Danimarkës*, 23 shtator 1994; *Thoma kundër Luksemburgut*, 29 mars 2001.

²³⁷ Paragrafi 64.

²³⁸ Komiteti i të Drejtave të Njeriut, Komenti i Përgjithshëm Nr.34 për nenin 19: Liritë e mendimit dhe të shprehjes, CCPR/C/GC/34, 12 shtator 011, paragrafi 7; Organizata e Shteteve Amerikane, Komisioni Ndër-Amerikan për të Drejtat e Njeriut, Dhunën kundër Gazetarëve dhe Punonjësve të Medias: Standardet dhe Praktikët Kombëtare Ndër-Amerikane për Parandalimin, Mbrojtjen dhe Ndjekjen ligjore të autorëve të krimeve, OEA/Ser.L/V/II, CIDH/RELE/INF.12/13, 31 dhjetor 2013, p. 22.

²³⁹ *Huseynov kundër Azerbajxhanit*, 7 maj 2015.

²⁴⁰ *Najafli kundër Azerbajxhanit*, 2 tetor 2012.

²⁴¹ *Özgür Gündem kundër Turqisë*, 16 mars 2000.

ushtrimi efektiv dhe i mirëfilltë i kësaj lirie nuk varet thjesht nga detyrimi i shtetit për mosndërhyrje, por mund të kërkojë masa pozitive mbrojtjeje, edhe në sferën e marrëdhënieve ndërmjet personave ...Në përcaktimin nëse ekziston një detyrim pozitiv ose jo, vëmendje duhet t'i kushtohet balancës së drejtë që duhet vendosur ndërmjet interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe interesave të individit, kërkimi i të cilës mishërohet në të gjithë konventën. Fushëzbatimi i këtij detyrimi do të ndryshojë pashmangshmërisht, duke pasur parasysh diversitetin e situatave në shtetet kontraktore, vështirësitë e policimit të shoqërive moderne dhe zgjedhjeve që duhen bërë për sa i takon prioritetet dhe burimeve. Një detyrim i tillë nuk duhet të interpretohet në një mënyrë të tillë që të vendosë një barrë të pamundur ose disproporcionale mbi autoritetet²⁴².

Një shkelje e nenit 2 u konstatua në çështjen *Dink kundër Turqisë*, që kishte të bënte me vrasjen e gazetarit *Hrant Dink*, i cili kishte qenë objekt i armiqësive me nacionalistët ekstremë si rezultat i artikujve të shkruar prej tij për marrëdhëniet turko-armene. Gjykata konstatoi se forcat e sigurisë në mënyrë të arsyeshme mund të konsideroheshin se ishin informuar për armiqësinë kundër z. *Dink*, duke qenë se organet ligjzbatuese kishin qenë të informuara për një kërcënim real dhe të menjëhershëm për vrasje, dhe prapëseprapë ato kishin dështuar në marrjen e masave për mbrojtjen e jetës së tij. Neni 10 i Konventës u çmua të ishte shkelur, jo vetëm për shkak të mosmbrojtjes së *Hrant Dinkut* kundër sulmit, por edhe sepse, si rezultat i artikujve të tij në gazetë, ai ishte shpallur fajtor për krimin e denigrimit të "Turqisë", gjë e cila konsiderohej nga gjykata si një nevojë sociale jo e ngutshme²⁴³.

Neni 2 kërkon gjithashtu kryerjen e një hetimi efektiv për vrasjen e paligjshme të pretenduar. Nëse shteti është në dijeni të kërcënimeve ose frikësimeve kundër gazetarëve ose organizatave të medieeve, është i detyruar të marrë masa mbrojtëse dhe të kryejë një hetim efektiv për këto detyrime²⁴⁴. Nëse ka një dyshim të bazuar se një vrasje lidhet me aktivitetin e gazetarit, neni 2 mund t'iu kërkojë autoritetet të ndërmarrin hapat e duhur për hetimin e një mundësie të tillë²⁴⁵. Neni 2 mund të shkelet kur hetuesit nuk marrin parasysh mundësinë që zyrtarët e shtetit (si pjesëtarë të forcave të sigurisë) mund të kenë qenë të përfshirë në sulme²⁴⁶.

Krahas kësaj, neni 2 i kombinuar me nenin 13 të Konventës kërkon gjithashtu parashikimin e një mjeti juridik të brendshëm për trajtimin e thelbit të një ankimi në kuadër të Konventës dhe të japë kompensim efektiv për fëmijët e një gazetari. Për

²⁴² Po aty, paragrafi 43.

²⁴³ *Dink kundër Turqisë*, 14 shtator 2010.

²⁴⁴ *Özgür Gündem kundër Turqisë*, 16 mars 2000, paragrafi 41.

²⁴⁵ *Adali kundër Turqisë*, 31 mars 2005, paragrafi 232.

²⁴⁶ *D.D kundër Turqisë*, 2 shtator 1998, paragrafi 100.

rrjedhje, neni 13 kërkon një hetim efektiv dhe tërësor, i cili do të çojë në identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës për privimin e lirisë, duke përfshirë aksesin e ankimesit në procedurën e hetimit²⁴⁷.

Përdorimi i forcës mbi gazetarët nga agjentët shtetërorë mund të shkelë nenin 3 të Konventës, i cili e ndalon ndëshkimin ose trajtimin çnjerëzor dhe degradues. Neni 3 u çmua të ishte shkelur në çështjen *Tekin kundër Turqisë* sepse një gazetar ishte mbajtur me sy të lidhur në një qeli të ftohtë dhe të errët dhe ishte marrë në pyetje forcërisht, gjë e cila i kishte shkaktuar plagë dhe lëndime në trup²⁴⁸. Ka pasur edhe një shkelje të nenit 3 në çështjen *Najafli kundër Azerbajxhanit*, ku një gazetar u konstatua të ishte rrahur nga policia gjatë shpërndarjes së një demonstrate politike, ku ai kishte vajtur për të bërë raportimin e saj: në atë rast përdorimi i forcës u çmua i panevojshëm, “i tepërt dhe i papranueshëm”²⁴⁹. Krahas kësaj, gjykata theksoi se masat që pengojnë gazetarët të bëjnë punën e tyre mund të ngrenë çështje të lidhura me nenin 10 të Konventës. Gazetari kërkues kishte pasur shenjën e gazetarit në kraharor dhe i kishte thënë oficerëve të policisë se ishte gazetar. Përdorimi i forcës ndërsa ai kryente detyrën e tij profesionale rrjedhimisht u konsiderua shkelje e nenit 10 (pavarësisht nëse policia kishte pasur ndonjë qëllim për të ndërhyrë në aktivitetin e gazetarit).

Në çështjen *Fuentes Bobo kundër Spanjës*, kërkuesi u pushua nga puna nga shoqëria e televizionit kombëtar spanjoll (“TVE”) për shkak të kritikave të tij ndaj drejtuesve, të bëra gjatë një programi radiofonik. Në përgjigje të argumenteve të qeverisë se TVE-ja ishte person juridik, gjykata konstatoi se në bazë të detyrimit pozitiv të saj, i takonte qeverisë spanjolle të mbronte lirinë e shprehjes nga kërcënimet që rridhnin nga personat privatë, kështu që pushimi i ligjshëm nga puna i kërkuesit përbënte ndërhyrje në lirinë e tij të shprehjes²⁵⁰.

Në një çështje tjetër në lidhje me pushimin nga puna për shpërndarjen e një buletini informativ për aktivitetet e sindikatës, kërkuesit u ankuan për shkelje të nenit 10, dhe se arsyeja e vërtetë e pushimit të tyre nga puna kishin qenë aktivitetet sindikaliste të tyre, në shkelje të të drejtës së tyre për lirinë e grumbullimit dhe organizimit në shoqata sipas nenit 11²⁵¹. Çështja kryesore ishte nëse Spanjës i kërkohet të garantonte respektimin e lirisë së shprehjes së kërkuesve duke anuluar pushimin e tyre nga puna. Masa e ankimit nga kërkuesit, më konkretisht pushimi i tyre nga puna, nuk u ndërmor nga një autoritet shtetëror por nga

²⁴⁷ Për shembull, *Tepe kundër Turqisë*, 9 qershor 2003.

²⁴⁸ *Tekin kundër Turqisë*, 9 qershor 1998, paragrafët 48-54.

²⁴⁹ *Najafli kundër Azerbajxhanit*, 2 tetor 2012, paragrafi 39.

²⁵⁰ *Fuentes Bobo kundër Spanjës*, 29 shkurt 2000, paragrafi 38.

²⁵¹ *Palomo Sánchez dhe të Tjerë kundër Spanjës*, 12 shtator 2011 (GC), paragrafi 60.

një shoqëri private. Pas publikimit të buletinit informativ të sindikatës në mars të vitit 2002 dhe shprehjeve të përmbajtura aty, punëdhënësi i kërkuesve filloi procedimin disiplinor kundër tyre për sjellje jo profesionale dhe kjo u pasua nga pushimi i tyre nga puna. Masat u lanë në fuqi nga gjykatat vendase. Kështu, pushimi nga puna i kërkuesve nuk ishte rezultat i ndërhyrjes direkte nga autoritetet kombëtare. Përgjegjësia e autoriteteve do të ishte angazhuar gjithsesi sikur faktet e ankimuara të rridhnin nga mosgarantimi nga ana e tyre i gëzimit nga kërkuesit e së drejtës së mishëruar në nenin 10 të Konventës. Dhoma e Madhe nuk gjeti shkelje të nenit 10, sepse sipas rrethanave të veçanta të çështjes, masa e pushimit nga puna e marrë kundër kërkuesve nuk ishte haptazi në disproporcion ose një sanksion i tepërt që mund t'i kërkonte shtetit të jepte kompensim duke e anuluar atë ose duke e zëvendësuar me një masë më të zbutur.

Deklarata e Komitetit të Ministrave për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias, vendos mbi shtetet detyrimin pozitiv të mbrojtjes së gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias nga çdo formë sulmi (gjithashtu edhe personat privatë) dhe i jep fund pandëshkueshmërisë²⁵².

8.3. Liria e transmetimit radioteleviziv

Në përputhje me fjalinë e fundit të paragrafit 1, e drejta për marrjen dhe dhënien e informacionit dhe mendimeve “nuk i ndalon shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të transmetimeve kinematografike ose televizive.” Kjo dispozitë u përfshi për arsye teknike në një fazë të përparuar të punës përgatitore për Konventën: numri i kufizuar i frekuencave të disponueshme dhe fakti që, në atë kohë, shumica e shteteve europiane kishin monopolin mbi transmetimet dhe televizionin. Megjithatë, progresi në fushën e teknikave të transmetimit i ka bërë të parëndësishme këto arsye. Në çështjen *Informationverein Lentia dhe të Tjerë kundër Austrisë*²⁵³, gjykata theksoi se pas “progresit teknik të bërë gjatë dekadave, justifikimi i këtyre kufizimeve nuk mund të gjendet më sot në konsideratat që lidhen me numrin e frekuencave dhe kanaleve të disponueshme.” Transmetimet satelitore dhe me televizion kabllor kanë sjellë si rezultat një numër të pakufizuar të frekuencave të disponueshme. Në këtë kontekst, e drejta e shtetit për licencimin e shoqërive mediatike mori një kuptim dhe qëllim të ri, dhe konkretisht garancinë e lirisë dhe pluralizmit të informacionit me qëllim përmbushjen e nevojave të publikut²⁵⁴.

²⁵² Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 30 prill 2014 në takimin e 1198-të të zëvendësministrave.

²⁵³ *Informationverein Lentia dhe të Tjerë kundër Austrisë*, 24 nëntor 1993, paragrafi 39.

²⁵⁴ *Observer dhe Guardian kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 26 nëntor 1991.

Gjykata theksoi se kompetencat e autoriteteve vendase për rregullimin e sistemit të licencimit nuk mund të ushtrohen përveçse për qëllime teknike dhe në mënyrë të tillë që të mos përbëjnë ndërhyrje në lirinë e shprehjes në kundërshtim me kriteret e paragrafit të dytë të nenit 10. Në çështjen *Groppera Radio AG dhe të tjerë kundër Zvicrës*²⁵⁵, gjykata theksoi se:

qëllimi i fjalisë së tretë të nenit 10§1...të Konventës është ta bëjë të qartë që shteteve iu lejohet të kontrollojnë me anë të sistemit të licencimit mënyrën sesi janë organizuar transmetimet në territorin e tyre, në mënyrë të veçantë në drejtim të aspekteve teknike të tyre. Megjithatë, ajo nuk përcakton që masat e licencimit nuk i nënshtrohen kriterëve të paragrafit 2 ...sepse kjo do të çonte në një rezultat të kundërt me objektin dhe qëllimin e nenit 10 ...të marrë në tërësi.

Në çështjen *Autronic AG kundër Zvicrës*²⁵⁶, gjykata theksoi se pajiset për marrjen e informacionit të transmetuar, si antenat satelitore, nuk përfshihen në kufizimin e parashikuar në fjalinë e fundit të paragrafit të parë. Në çështjen *Tele 1 Privatfernsehgesellschaft mbH kundër Austrisë*, gjykata vendosi se Austria kishte shkelur nenin 10 pas mungesës së bazës ligjore për dhënien e licencave për ngritjen dhe funksionimin e një transmetitori televiziv në çdo stacion përveç Korporatës Austriake të Transmetimeve²⁵⁷.

Refuzimi i dhënies së licencave të transmetimit një shoqërie televizive nga autoritetet mund të përbëjë shkelje të nenit 10. Gjykata arriti në këtë konkluzion në çështjen e një shoqërie televizive armene, “*Meltex*”, e cila kishte aplikuar disa herë për një licencë transmetimi²⁵⁸. Së pari gjykata konfirmoi se, kërkuesi, shoqëria e transmetimeve të pavarura, “*Meltex*” duhet të konsiderohej “viktimë” e ndërhyrjes në lirinë e saj të shprehjes nga autoritetet publike armene, për shkak se nuk ishte njohur si fituese në thirrjen për tender ku kishte konkuruar. Komisioni Kombëtar për Radion dhe Televizionin (KKRT) kishte refuzuar efektivisht ofertat e shoqërisë kërkuese për një licencë transmetimi dhe refuzime të tilla përbënin ndërhyrje në lirinë e shoqërisë kërkuese të dhënies së informacionit dhe ideve. Gjykata nënvizoi gjithashtu se shteteve iu lejohet të rregullojnë me anë të sistemit të licencimit mënyrën sesi janë organizuar transmetimet në territoret e tyre, veçanërisht në lidhje me aspektet teknike, dhe se dhënia e një licence mund edhe të kushtëzohej për çështje të tilla, si: natyra dhe objektivat e një stacioni të propozuar, audienca e mundshme e tij në nivel kombëtar, rajonal ose lokal, të drejtat dhe nevojat e një audience specifike dhe detyrimet e rrjedhura nga dokumentet ligjore ndërkombëtare. Mënyra e zbatimit të kriterëve të licencimit duhet të japë garanci të mjaftueshme kundër arbitraritetit, duke

²⁵⁵ *Groppera Radio AG dhe të tjerë kundër Zvicrës*, 28 mars 1990, paragrafi 61.

²⁵⁶ *Autronic AG kundër Zvicrës*, 22 maj 1990.

²⁵⁷ *Tele 1 Privatfernsehgesellschaft mbH kundër Austrisë*, 21 shtator 2000.

²⁵⁸ *Meltex Ltd. dhe Mesrop Movsesyan kundër Armenisë*, 17 qershor 2008.

përfshirë arsyetimin nga autoriteti licencues të vendimeve të tij në rastet e mohimit të dhënies së licencës së transmetimit²⁵⁹. Vendimet e KKRT-së ishin bazuar në ligjin për transmetimet (2000) dhe rregullore të tjera përcaktuese të kriterëve mbi të cilat duhet të bënte zgjedhjen KKRT-ja, si burimet financiare dhe teknike të shoqërisë kërkuese, përvoja e stafit të saj dhe nëse prodhonte kryesisht programe brenda Armenisë. Megjithatë, ligji për transmetimet nuk e kishte të parashikuar shprehimisht në atë kohë se organi licencues jepte arsyet e zbatimit të atyre kriterëve. Për rrjedhojë, KKRT-ja thjesht kishte shpallur shoqërinë fituese pa dhënë ndonjë shpjegim se pse kriteret e kërkuara i kishte përmbushur ajo shoqëri dhe jo shoqëria “Meltex”. Pra, nuk kishte asnjë mënyrë të dihej se në ç’bazë e kishte ushtruar diskrecionin e saj KKRT-ja në refuzimin e licencës²⁶⁰. Gjykata më tej vërejti se “paqartësia e ligjit në fuqi kishte sjellë si rezultat një [KKRT] me kompetenca diskrecionare të prera”²⁶¹. Gjykata çmoi se një procedurë licencimi ku autoriteti licencues nuk jep asnjë arsye për vendimet e tij nuk ofron mbrojtjen e duhur kundër ndërhyrjeve arbitrare nga një autoritet publik me të drejtën themelore të lirisë së shprehjes. Për rrjedhojë, gjykata arriti në konkluzionin se ndërhyrja në lirinë e shoqërisë “Meltex” për dhënien e informacionit dhe ideve, më konkretisht shtatë refuzimet e licencës së transmetimit, nuk e kishte përmbushur kriterin e ligjshmërisë.

Monopolet publike brenda medieve audiovizive u konsideruan nga gjykata në kundërshtim me nenin 10, kryesisht sepse nuk mund të ofronin pluralitetin e burimeve të informacionit. Një monopol i tillë nuk është i nevojshëm në një shoqëri demokratike dhe mund të justifikohet vetëm nga një nevojë sociale e ngutshme. Megjithatë, në shoqëritë moderne, shumëfishimi i metodave të transmetimit të komunikimeve dhe rritja e televizioneve ndërkufitare e bënin të pamundur justifikimin e ekzistencës së monopoleve. Përkundrazi, diversiteti i kriterëve të publikut nuk mund të mbulohet vetëm nga një shoqëri transmetimesh²⁶².

Reklamat e dhëna nga mediet audiovizive mbrohen gjithashtu nga neni 10, edhe pse autoritetet vendase gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi përsa i takon nevojës për kufizimin e tyre²⁶³. Në parim, reklamat duhet të përgatiten me një ndjenjë përgjegjësie kundrejt shoqërisë dhe duhet t’i kushtohet vëmendje e

²⁵⁹ Shihni *Glas Nadezhda EOOD dhe Elenkov kundër Bullgarisë*, 11 tetor 2007.

²⁶⁰ Shihni gjithashtu Deklaratën e Komitetit të Ministrave të 26 marsit 2008 për pavarësinë dhe funksionet e autoriteteve rregullatore për sektorin e transmetimeve.

²⁶¹ *Meltex Ltd. dhe Mesrop Movsesyan kundër Armenisë*, 17 qershor 2008, paragrafi 65 (Rezoluta 1361 (2004) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës (PACE): Përmbushja e detyrimeve dhe angazhimeve nga Armenia, 27 shkurt 2004).

²⁶² *Informationverein Lentia kundër Austrisë*, 24 nëntor 1993.

²⁶³ *Markt intern Verlag GmbH dhe Klaus Beermann kundër Gjermanisë*, 20 nëntor 1989.

posaçme vlerave morale që krijojnë bazën e çdo demokracie. Çdo reklamë me objekt fëmijët duhet të shmangë informacionin që mund të dëmtojë interesat e tyre dhe të respektojë zhvillimin e tyre fizik, mendor e moral. Gjykata ka zhvilluar gjithashtu një qasje të rëndësishme në drejtim të së drejtës së aksesit të transmetimi të reklamave televizive “jo-komerciale” me natyrë politike, që kanë krijuar shqetësim publik²⁶⁴. Në vitin 1994, Shoqëria e Televizionit Komercial në Zvicër (*AG fürdas Zerbefernsehen*), kishte refuzuar të transmetonte një reklamë për mirëqenien e kafshëve me kërkesë të një shoqate kundër prodhimit industrial të produkteve shtazore (*Verein gegen Tierfabriken, “VGT”*). Reklama duhet të konsiderohej si përgjigje ndaj reklamave të industrisë së mishit dhe përfundonte me fjalët: “Konsumoni më pak mish, për hir të shëndetit tuaj, të kafshëve dhe mjedisit”. Megjithatë, shoqëria e televizionit komercial refuzoi ta transmetonte reklamën, sepse e konsideronte një mesazh me karakter të qartë politik dhe ligji zviceran i ndalon transmetimet e reklamave politike në radiotelevizion. Ankimi i kërkuar në apelin administrativ nuk u pranua nga gjykata federale (Bundesgericht) më 20 gusht 1997, duke u mbështetur, *ndër të tjera*, në synimin e ligjshëm të ndalimit të reklamave politike të parashikuara në seksionin 18, paragrafi 5 të ligjit federal për radiotelevizionet. Gjykata, duke konstatuar shkelje të nenit 10, mori në konsideratë se shoqëria e televizionit komercial ishte enti i vetëm përgjegjës për transmetimin e reklamave gjatë programeve në shkallë vendi, që do të thoshte se kishte pak mundësi të tjera për informimin e publikut zviceran me reklamën e propozuar. Krahas kësaj, gjykata vërejtë se grupe të fuqishme financiare kanë avantazhe konkurruese nëpërmjet reklamave tregtare dhe për rrjedhojë mund të ushtrojnë presion dhe përfundimisht të kufizojnë lirinë e stacioneve radiotevizive për transmetimin e reklamave. Situata të tilla minojnë rolin themelor të lirisë së shprehjes në një shoqëri demokratike. Si rezultat i mungesës së zbatimit të gjykimit në nivel kombëtar, çështja solli një ankim të dytë²⁶⁵.

Në praktikën gjyqësore të saj, gjykata ka zhvilluar rregulla të posaçme përsa i takon transmetuesve publikë, veçanërisht për pavarësinë e tyre nga ndikimi politik. Në çështjen *Manole dhe të Tjerë kundër Moldovës*, shoqëria e transmetimeve publike, *Teleradio-Moldova (TRM)*, iu nënshtrua kontrollit politik nga qeveria dhe partia politike në pushtet. Asnjë garanci pluralizmi nuk ishte e pranishme në politikën e saj redaksionale dhe në programet e informacionit dhe të lajmeve²⁶⁶. Gazetarët në TRM ankoheshin se i ishin nënshtruar një regjimi censure dhe se pushimi i tyre nga puna ishte bazuar në motive politike. Gjykata konfirmoi se shteti ishte garantuesi final i pluralizmit dhe se kjo i vendos një

²⁶⁴ *Verein gegen Tierfabriken kundër Zvicrës, 28 qershor 2001.*

²⁶⁵ *Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) kundër Zvicrës (Nr. 2), 30 qershor 2009.*

²⁶⁶ *Manole dhe të Tjerë kundër Moldovës, 17 shtator 2009.*

detyrim shtetit të garantojë që publiku të ketë akses me anë të televizionit dhe radios në marrjen e informacionit të saktë, të paanshëm, opinioneve dhe komenteve, që reflektojnë diversitetin e këndvështrimit politik brenda vendit. Gazetarët dhe profesionistët e tjerë që punojnë në mediet audiovizive nuk duhet të pengohen nga dhënia e këtij informacioni dhe komenteve. Krahas kësaj, për funksionimin e duhur të demokracisë është e domosdoshme që shoqëria transmetuese publike të transmetojë informacion, lajme dhe komente të paanshme, të pavarura dhe të balancuara dhe, krahas kësaj, të ofrojë një forum për diskutim publik, ku mund të shprehet një spektër i gjerë pikëpamjesh dhe mendimesh.

3. Komiteti i Ministrave ka nxjerrë një numër rekomandimesh për pavarësinë dhe pluralizmin e medieve publike, në mënyrë të veçantë përsa i takon mënyrës sesi zgjidhen anëtarët e bordeve të këtyre medieve²⁶⁷.

8.4. Detyrimet dhe përgjegjësitë e gazetarëve

Gjykata, në kuadër të qasjes së “detyrimeve dhe përgjegjësiave”, ka argumentuar gjithashtu se fakti që një person i përket një kategorie të caktuar ofron shkaqe për kufizimin, kundrejt rritjes, së kompetencave të autoriteteve publike për kufizimin e ushtrimit të të drejtave të tij. Redaktorët dhe gazetarët përfshihen në këtë kategori. Në çështjen *Observer dhe Guardian kundër Mbretërisë së Bashkuar*²⁶⁸ të diskutuar tashmë më lart, gjykatat kombëtare lëshuan një urdhër që ndalonte botimin e artikujve specifikë për shkak se ata do të rrezikonin sigurinë kombëtare. Gjykata iu referua detyrimit të shtypit për “dhënien e informacionit dhe mendimeve për çështje me interes publik”, duke shtuar se e drejta e publikut për marrjen e informacionit korrespondon me detyrimin e shtypit për dhënien e tij. Për pasojë, duke pasur të drejtën dhe detyrimin e dhënies së informacionit dhe mendimeve, shtypi fitoi një liri më të madhe, duke reduktuar kështu mundësitë që shteti të kufizojë ndërhyrjet e tij. Megjithatë, gjykata theksoi se për shkak të “detyrimeve dhe përgjegjësiave” të mishëruara në ushtrimin e lirisë së shprehjes, mbrojtja e gazetarëve sipas nenit 10 i nënshtrohet kushtit që ata “po veprojnë në mirëbesim me qëllim dhënien e informacionit të saktë dhe të besueshëm në përputhje me etikën e gazetarisë”²⁶⁹.

²⁶⁷ Për shembull, Rekomandimi Nr.R (1996)10 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për garantimin e pavarësisë të transmetimit të shërbimit publik, 11 shtator 1996 dhe Rekomandimi (2007)2 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për pluralizmin e medias dhe diversitetin e përmbajtjes së medias, 31 janar 2007.

²⁶⁸ *Observer dhe Guardian kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 26 nëntor 1991.

²⁶⁹ *Fressoz dhe Roire kundër Francës*, 21 janar 1999; *Bergens Tidende dhe të Tjerë kundër Norvegjisë*, 2 maj 2000.

Krahas kësaj, gjykata ka theksuar gjithashtu se “detyrimet dhe përgjegjësitë” e profesionistëve të medias” marrin rëndësi të veçantë në situatat e konfliktit dhe tensionit”²⁷⁰. Në çështjen *Şener kundër Turqisë*, gjykata theksoi:

Duhet treguar kujdes i veçantë kur merret në konsideratë publikimi i pikë-pamjeve që përmbajnë nxitje të dhunës ndaj shtetit me qëllim që media të mos bëhet mjet për përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe nxitjes së dhunës.

Megjithatë, gjykata theksoi gjithashtu se:

në të njëjtën kohë, kur pikëpamje të tilla nuk mund të kategorizohen, shtetet kontraktore, pa i referuar mbrojtjes së integritetit territorial ose sigurisë kombëtare ose parandalimit të krimit ose prishjes së rendit, nuk mund të kufizojnë të drejtën e publikut për informim duke sjellë peshën e ligjit penal mbi medien²⁷¹.

Në këtë çështje, gjykata vërejti se buletini i botuar nga kërkuesi – pronar dhe redaktor i një publikimi të përjavshëm – përmbante kritika ndaj politikës qeveritare dhe veprimeve të forcave të sigurisë në lidhje me kurdët në juglindje të Turqisë dhe disa shprehje dukeshin me ton agresiv. Megjithatë, gjykata konstatoi se artikulli nuk lartësonte dhunën dhe nuk nxiste hakmarrjen dhe rezistencën me armë, për rrjedhojë dënimi penal i kërkuesit cenonte nenin 10. Kërkuesi nuk i tejkaloi kufijtë e detyrimeve dhe përgjegjësi të tij në konflikt dhe tensionet, por ai i ofroi një perspektivë të ndryshme publikut në lidhje me situatën në juglindje të Turqisë, pavarësisht sesa e pakëndshme mund të ketë qenë ajo perspektivë për publikun.

Dhoma e Madhe, në shqyrtimin nëse një gazetar duhet të ishte ndaluar gjatë raportimit të demonstratave, theksoi se gazetarët “*nuk mund të pretendojnë imunitet ekskluziv nga përgjegjësia penale për të vetmen arsye se, ndryshe nga individët e tjerë që ushtrojnë të drejtën e lirisë së shprehjes, vepra e paligjshme në fjalë u krye gjatë kryerjes së funksionit të gazetarisë*”²⁷². Gjkata vërejti se çështja nuk kishte të bënte me ndalimin e një publikimi ose ndonjë sanksioni të vënë në lidhje me një publikim. Ndërhyrja në lirinë e shprehjes së gazetarit ishte pasojë e mosrespektimit të urdhrave të policisë nga gazetari ndërsa ai bënte foto për të raportuar për një demonstratë që ishte kthyer në dhunë²⁷³. Fakti që kërkuesi ishte gazetar nuk i jepte të drejtë atij për trajtim preferencial ose të ndryshëm në krahasim me njerëzit e tjerë që merrnin pjesë në demonstratën e raportuar.

²⁷⁰ *Şener kundër Turqisë*, 18 korrik 2000.

²⁷¹ Po aty, paragrafi 42.

²⁷² *Pentikäinen kundër Finlandës*, 20 tetor 2015 (GC), paragrafi 91.

²⁷³ Po aty, paragrafi 93.

Gazetarët kanë për detyrë të mbledhin materiale në përputhje me standardet profesionale. Metoda e mbledhjes së informacionit duhet të jetë e duhura për thelbin e materialit të prodhuar. Në çështjen *Haldimann kundër Zvicrës*²⁷⁴, e cila kishte të bënte me dënimin e katër gazetarëve për regjistrimin dhe transmetimin e një interviste duke përdorur kamera të fshehta, gjykata e çmoi këtë metodë të papranueshme. Ajo vendosi se neni 10 i mbron gazetarët në lidhje me raportime të tilla me kushtin që të veprojnë në mirëbesim dhe me një bazë faktike të saktë, ndërkohë që japin informacion “të besueshëm dhe të saktë” në përputhje me etikën e gazetarisë. Nga ana tjetër, regjistrimi ishte transmetuar në formën e një raporti duke përdorur media audiovizive, gjë e cila ishte veçanërisht negative përse i takon personit të regjistruar (agjent sigurimesh), sepse mediet audiovizive shpesh konsiderohen të kenë një efekt më të fuqishëm dhe më të menjëhershëm sesa shtypi i shkruar. Megjithatë, një faktor vendimtar ishte se gazetarët e kishin tjetërsuar fytirën dhe zërin e agjentit të sigurimeve dhe se intervista nuk ishte zhvilluar në vendin e tij të zakonshëm të punës.

Në një çështje më të fundit, *Brambilla dhe të Tjerë kundër Italisë*, në lidhje me mbikëqyrjen e paligjshme të diskutimeve të policisë nga gazetarët, gjykata ritheksoi se nocioni i gazetarisë së përgjegjshme kërkonte që kur gazetarët vepromin në dëm të detyrimin për respektimin e ligjit penal, ata duhet të ishin të ndërgjegjshëm se rrezikonin t’i nënshtroheshin sanksioneve ligjore, duke përfshirë edhe ato me karakter penal²⁷⁵.

8.5. Mbrojtja e burimeve të gazetarëve

Burimet e gazetarëve mbrohen posaçërisht nga neni 10. Gjykata shpjegoi se mbrojtja e burimeve të gazetarëve është një prej kushteve bazë të lirisë së shtypit. Vendimi *Goodwin*²⁷⁶ është i rëndësishëm për balancën ndërmjet interesave të drejtësisë dhe të drejtave të të tjerëve nga njëra anë dhe interesit për mbrojtjen e burimeve nga ana tjetër. Gjykata argumentoi se:

pa një mbrojtje të tillë, burimet mund të frenohen nga ndihma që i japin shtypit në informimin e publikut për çështjet me interes publik. Si rezultat mund të minohet roli i rëndësishëm i rojtarit publik dhe mund të ndikohet negativisht aftësia e shtypit për dhënie të informacionit të saktë dhe të besueshëm²⁷⁷.

Z. *Goodwin*, një gazetar në revistën e përmuajshme “*The Engineer*”, kishte marrë nga një “burim”, me telefon, një informacion për shoqërinë “*Tetra Ltd*”. Burimi kishte deklaruar se shoqëria ishte në procesin e marrjes së një huaje të

²⁷⁴ *Haldimann dhe të Tjerë kundër Zvicrës*, 24 shkurt 2015.

²⁷⁵ *Brambilla dhe të Tjerë kundër Italisë*, 23 qershor 2016.

²⁷⁶ *Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 27 mars 1996 (GC).

²⁷⁷ Paragrafi 39.

madhe ndërkohë që kishte probleme financiare serioze. Gazetari nuk e kishte kërkuar informacionin dhe për të nuk u krye asnjë pagesë. Gjatë përgatitjes së artikullit për këtë temë, gazetari i kishte telefonuar shoqërisë “Tetra Ltd” dhe i kishte kërkuar komente për këtë informacion. Pas telefonatës, shoqëria i kërkoi gjykatës një urdhër ndalimi kundër publikimit të artikullit të z. *Goodwin*, me argumentin se do të dëmtoheshin rëndë interesat ekonomike dhe financiare të saj nëse informacioni bëhej publik. Urdhri i ndalimit u lëshua dhe shoqëria i dërgoi një kopje të gjitha gazetave të mëdha.

Krahas kësaj, shoqëria i kërkoi gjykatës t’i kërkonte gazetarit të zbulonte emrin e burimit të tij. U argumentua se kjo do ta ndihmonte shoqërinë të identifikonte punonjësien e pandershëm dhe të fillonte procedimin kundër tij/saj. Gazetari e refuzoi kërkesën e gjykatës në mënyrë të përsëritur dhe nuk e zbuloi burimin e tij. Më pas ai u gjobit me akuzën e “pengimit të drejtësisë”.

Përpara gjykatës, kërkuesi pretendoi se urdhri i gjykatës që i kërkonte zbulimin e burimit, si dhe gjoba për moszbulimin e burimit, të dyja kishin cenuar të drejtën e tij të lirisë së shprehjes. Duke sjellë në vëmendje se: “liria e shprehjes përbënte një nga themelet kryesore të një shoqërie demokratike dhe se masat mbrojtëse që i ofrohen shtypit janë me rëndësi të veçantë”, gjykata më tej theksoi se:

mbrojtja e burimeve të gazetarëve është një prej kushteve bazë të lirisë së shtypit, siç është e reflektuar në legjislacionin dhe kodet profesionale të një numri shtetesh kontraktore dhe është e afirmuar në disa dokumente ndërkombëtare për liritë e gazetarëve... Pa një mbrojtje të tillë, burimet do të frenohen nga të ndihmuarit e shtypit në informimin e publikut për çështje me interes publik. Si rezultat mund të minohet roli i rëndësishëm i rojtarit publik dhe mund të ndikohet negativisht dhënia e informacionit të saktë dhe të besueshëm²⁷⁸.

Duke pasur parasysh rëndësinë e burimeve të gazetarëve për lirinë e shtypit në një shoqëri demokratike dhe efektin frenues të një urdhri për zbulimin e informacionit, gjykata konstatoi, se: “edhe urdhri që i kërkon kërkuesit të zbulojë burimin e tij edhe gjoba e vendosur mbi të për refuzimin shkaktoi shkeljen e të drejtës së tij për lirinë e shprehjes”.

Standardi *Goodwin* u konfirmua në çështjen *Nagla kundër Letonisë*²⁷⁹. Kjo çështje kishte të bënte me kontrollin e shtëpisë së gazetares së mirënjohur nga policia dhe sekuestrimin e pajisjeve të ruajtjes së të dhënave. Shtëpia e kërkueses u kontrollua pas transmetimit të saj në shkurt të vitit 2010 ku ajo kishte informuar publikun për një informacion nga baza e të dhënave të Shërbimit Shtetëror për të Ardhurat. Kërkuesja u ankua se kontrolli i shtëpisë së saj nën-

²⁷⁸ Paragrafi 39.

²⁷⁹ *Nagla kundër Letonisë*, 16 korrik 2013.

kuptonte se ajo kishte qenë e detyruar të zbulonte informacionin që mundësonte identifikimin e burimit gazetaresk, duke shkelur kështu të drejtën e saj për marrjen dhe dhënien e informacionit.

Pas vendimit *Goodwin*, më 8 mars 2000, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës miratoi Rekomandimin Nr. R(2000)7 për të drejtën e gazetarëve që të mos zbulojnë burimet e tyre të informacionit.

Në çështjen *Sanoma Uitgevers B.V kundër Holandës*, Dhoma e Madhe theksoi se urdhrat që i kërkojnë gazetarëve të zbulojnë burimet e tyre duhet t'i nënshtrohen garancisë së kontrollit gjyqësor ose kontrollit nga një organ tjetër kontrolli i paanshëm dhe i pavarur²⁸⁰. Kriteret për një kontroll të tillë janë:

- duhet të kryhet nga një organ i veçantë nga ekzekutivi dhe palët e tjera të interesuara, me kompetencat për të vendosur nëse ekziston një kriter në interes të publikut, më i rëndësishëm se parimi i mbrojtjes së burimeve të gazetarisë përpara dorëzimit të një materiali të tillë dhe për parandalimin e aksesit të panevojshëm tek informacioni që mund të zbulojë identitetin e burimeve nëse nuk ekziston një kriter i tillë;
- ushtrimi i kontrollit që ndodh vetëm pas dorëzimit të materialit në gjendje të zbulojë burime të tilla do të minonte vetë thelbin e të drejtës së konfidencialitetit;
- duhet të ketë një peshim të risqeve potenciale dhe interesave respektive përpara ndonjë zbulimi dhe në lidhje me materialin që kërkohet të zbulohet në mënyrë që argumentet e autoriteteve që kërkojnë zbulimin të mund të vlerësohen si duhet;
- kontrolli duhet të rregullohet me kritere të qarta, duke përfshirë faktin nëse mund të ishte e mjaftueshme një masë më pak ndërhyrëse;
- duhet të jetë e mundur për gjyqtarin apo ndonjë autoritet tjetër të refuzojë nxjerrjen e një urdhri zbulimi ose nxjerrjen e një urdhri kualifikimi ose kufizimi në mënyrë që të mbrohen burimet nga zbulimi, pavarësisht nëse emërtohen specifikisht ose jo në materialin e mbajtur, me shkakun se komunikimi i një materiali të tillë krijon një rrezik serioz të komprometimit të burimeve të gazetarëve; dhe
- në situata urgjente, duhet të ketë një procedurë për identifikimin dhe izolimin, përpara shfrytëzimit të materialit nga autoritetet, informacion që mund të çojë në identifikimin e burimeve nga informacioni që nuk e përmban këtë rrezik²⁸¹.

²⁸⁰ *Sanoma Uitgevers B.V kundër Holandës*, 14 shtator 2010 (GC), paragrafët 90-92.

²⁸¹ Philip Leach, "Parimet e nxjerra nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

Gjykata ka pranuar gjithashtu se mbikëqyrja sekrete nga shteti mund të ndërhyjë në lirinë e shprehjes së individit nëse ka rrezik për monitorimin e komunikimeve gazetareske – sepse kjo mund të nënkuptojë se burimet ose mund të zbulohen ose mund të pengohen nga dhënia e informacionit me telefon. Transmetimi i të dhënave tek autoritetet e tjera, asgjësimi i tyre ose mos njoftimi i gazetarit për masat e mbikëqyrjes mund të minojnë gjithashtu konfidencialitetin e burimeve²⁸².

8.6. Mbrojtja e sinjalizuesve

Gjykata i ofron mbrojtje të posaçme sinjalizuesve për shkak të rolit të rëndësishëm të tyre në shoqëritë demokratike. Individët që raportojnë ose zbulojnë informacion ose kërcënime ose dëmtojnë interesin publik mund të kontribuojnë në forcimin e transparencës dhe llogaridhënies në demokraci.

Në çështjen *Guja kundër Moldovës*, Gjykata njohu nevojën e mbrojtjes së sinjalizuesve nga neni 10 i Konventës. Gjykata theksoi:

se gjatë punës së tij, një nëpunës civil mund të marrë dijëni për një informacion të brendshëm, duke përfshirë edhe informacionin sekret, zbulimi ose publikimi i të cilit korrespondon me një interes publik të fortë. Kështu, gjykata çmon se sinjalizimi nga një nëpunës civil ose punonjësi i sektorit publik i një sjelljeje abuzive ose keqbërëse në punë duhet të gëzojë mbrojtje në disa rrethana. Kjo mund të duhet kur punonjësi ose nëpunësi civil në fjalë është person i vetëm, ose pjesë e një kategorie të vogël personash, në dijeni të asaj çka ndodh në punë dhe për rrjedhojë në pozitën më të mirë për vepruar në interes të publikut duke lajmëruar punëdhënësin ose publikun e gjerë²⁸³.

Megjithëse zbulimi i informacionit së pari duhet të bëhet tek eprrori i personit ose një organ ose autoritet kompetent tjetër, gjykata pranoi se kur një praktikë e tillë është qartësisht jo praktike, si mjet i fundit, informacioni mund t'i zbulohet publikut. Gjykata vendosi se pushimi nga puna i një nëpunësi civil për zbulimin e dy letrave konfidenciale nga zyra e prokurorit të përgjithshëm në shtyp ishte në shkelje të nenit 10, duke sjellë në vëmendje gjithashtu efektin zbutës të pushimit nga puna të kërkuesit për nëpunësit civilë ose punëmarrësit e tjerë, në dekurajimin e tyre nga sinjalizimet e sjelljeve abuzive²⁸⁴.

Kriteret për përcaktimin e së drejtës së lirisë së shprehjes në lidhje me sinjalizimin

për mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve dhe gazetarisë”, Raport i përgatitur nga Konferenca e Këshillit të Europës për ministrat përgjegjës për Medien dhe Shoqërinë e Informacionit, Lirinë e Shprehjes dhe Demokracinë në Epokën Digjitale: mundësitë, të drejtat, përgjegjësitë, Beograd, 7-8 nëntor 2013, paragrafi 54.

²⁸² *Weber dhe Saravia kundër Gjermanisë*, 29 qershor 2006 (vendim), paragrafi 145 dhe *Bucur dhe Toma kundër Rumanisë*, 8 janar 2013.

²⁸³ *Guja kundër Moldovës*, 12 shkurt 2008 (GC), paragrafi 72.

²⁸⁴ Po aty.

u zbatuan nga gjykata në çështjen *Heinisch kundër Gjermanisë*²⁸⁵. Në këtë çështje, një infermiere geriatrike në një shtëpi të moshuarish, së bashku me koleget e saj, i kishte sinjalizuar në mënyrë të përsëritur drejtuesit se mungesat e stafit po ndikonin në aftësinë e kryerjes së detyrave dhe po shkaktonin të meta serioze në kujdesin e përditshëm të pacientëve. Kërkuesja u ankua se ishte pushuar nga puna pa njoftim me shkakun se kishte bërë ankesë kundër punëdhënësit të saj në lidhje me këto shqetësime dhe se kjo gjë kishte shkelur të drejtën e saj të lirisë së shprehjes. Gjykata theksoi se palët bien dakord se bërja e ankimit penal ishte sinjalizim për sjelljen e paligjshme të pretenduar të punëdhënësit në drejtimin e shtëpisë së të moshuarve, dhe se largimi nga puna ishte ndërhyrje në të drejtën e kërkueses për lirinë e shprehjes. Gjykata konfirmoi standardin se punonjësit, në disa rrethana, duhet të gëzojnë mbrojtje në lidhje me zbulimin e paligjshmërisë ose keqbërjes në vendin e punës, veçanërisht nëse punonjësi është një person, ose pjesë e një grupi të vogël, me dijeni për ndodhinë dhe “në pozitën më të mirë për të vepruar në interes të publikut”, duke sinjalizuar punëdhënësin ose publikun. Në marrjen e këtij vendimi, gjykata theksoi se informacioni i zbuluar nga kërkuesja ishte në interesin publik dhe me “rëndësi jetike” për parandalimin e abuzimit, duke pasur parasysh dobësinë e veçantë të pacientëve në shtëpinë e të moshuarve, që shpesh nuk janë në gjendje të tërheqin vëmendjen për të metat në ofrimin e kujdesit ndaj tyre. Krahas kësaj, kërkuesja i ngriti shqetësimet e saj në shumë raste me punëdhënësin, por pa dobi. Gjykata ritheksoi se personi që zgjedh të zbulojë informacionin duhet të verifikojë me kujdes, për aq sa e lejojnë rrethanat, saktësinë dhe besueshmërinë e tij. Gjykata konstatoi gjithashtu se kërkuesja po vepronte në mirëbesim. Megjithatë ajo i lejoi vetes një shkallë ekzagjerimi dhe përgjithësimi, zbulimet e kërkueses u çmuan të ishin përshkrime të të metave serioze në funksionimin e shtëpisë së të moshuarve. Së fundi, gjykata vendosi se interesi publik për marrjen e informacionit për kujdesin në shtëpinë e të moshuarve ishte më i madh sesa të drejtat e punëdhënësit dhe se largimi nga puna i kërkueses ishte “disproporcionalisht i rëndë”.

Në çështjen *Matúz kundër Hungarisë*, një gazetar dhe prezantues që punonte për shoqërinë shtetërore të televizionit *Magyar Televízió Zrt.*, u pushua nga puna pasi kishte zbuluar se një nga eprorët e tij censuronte pjesë të programit kulturor, për të cilin ai ishte redaktor dhe prezantues²⁸⁶. Në atë kohë, z.*Matúz-i* ishte gjithashtu kryetar i sindikatës së transmetuesve publikë, aktiv brenda sho-qërisë televizive. Në disa raste, z. *Matúz-i* kishte ftuar haptazi anëtarët e bordit të shoqërisë televizive t'i jepnin fund censurës në programet televizive dhe të lajmeve. Më pas ai kishte botuar një libër me prova dokumentare të censurës

²⁸⁵ *Heinisch kundër Gjermanisë*, 21 korrik 2011.

²⁸⁶ *Matúz kundër Hungarisë*, 21 tetor 2014.

së ushtruar në shoqërinë e televizionit shtetëror, gjë e cila çoi në pushimin e tij nga puna me efekt të menjëhershëm për shkeljen e klauzolës së konfidencialitetit të përcaktuar në kontratën e tij të punës. Z. *Matúz-i* e kundërshtoi pushimin e tij nga puna në gjykatë, por nuk ishte i suksesshëm në veprimet ligjore të tij në Hungari. Së fundi, ai bëri ankim në GJEDNJ, duke argumentuar një shkelje të të drejtave të tij sipas nenit 10 të Konventës. Z. *Matúz-i* deklaroi se si gazetar dhe kryetar i sindikatës në shoqërinë televizive publike, kishte të drejtën dhe detyrimin e informimit të publikut për censurën e pretenduar në shoqërinë e televizionit kombëtar.

Gjykata pranoi se çështja e censurës brenda shoqërisë televizive në shërbimin publik kishte të bënte me një çështje me interes të madh për shoqërinë. Gjykata theksoi gjithashtu se botimi i librit u krye vetëm pasi z. *Matúz-i* ishte ndierë i penguar nga ndreqja e ndërhyrjes së perceptuar në punën e tij gazetareske brenda vetë shoqërisë televizive, d.m.th., për mungesë të ndonjë kanali alternativ efektiv. Gjykata vendase konstatoi se fakti i thjeshtë që kërkuesi e kishte botuar librin e tij ishte i mjaftueshëm për të arritur në konkluzionin se ai kishte vepruar në dëm të punëdhënësit të tij, duke e kufizuar analizën e tij te gjetjet që z. *Matúz-i* kishte shkelur detyrimet kontraktore të tij. Si rezultat, gjykatat hungareze nuk e shqyrtuan nëse dhe si mund të kishte ndikuar subjekti i librit në fjalë në kufizimin e lirisë së shprehjes. Duke ditur rëndësinë e të drejtës së lirisë së shprehjes për çështjet me interes të përgjithshëm dhe detyrimet e përgjegjësitë profesionale të z. *Matúz-i* nga njëra anë dhe detyrimet dhe përgjegjësitë e punëmarrësve kundrejt punëdhënësve të tyre nga ana tjetër, duke matur peshën e interesave të ndryshme të përfshira në çështje, gjykata arriti në konkluzionin se ndërhyrja në të drejtën e kërkuesit për lirinë e shprehjes nuk kishte qenë “e nevojshme në një shoqëri demokratike.” Për rrjedhojë, gjykata e kon-sideroi pushimin e gazetarit nga puna me efekt të menjëhershëm si shkelje të nenit 10 të Konventës, edhe një herë duke pranuar rëndësinë e sinjalizimeve në një shoqëri demokratike.

Rëndësia e sinjalizuesve u theksua gjithashtu në rekomandimin e Komitetit të Ministrave për mbrojtjen e sinjalizuesve²⁸⁷. Në atë rekomandim, u theksua se shtetet anëtare duhet të përkrahin një mjedis që inkurajon raportimin ose zbulimin haptazi dhe që individët duhet të ndihen të sigurtë që të ngrenë lirisht shqetësime publike. U rekomandua gjithashtu se “duhet të vendosen kanale të qarta për raportimet dhe zbulimet në interesin publik dhe përdorimi i tyre duhej lehtësuar me anë të masave të përshtatshme”.

²⁸⁷ Rekomandimi CM/Rec(2014)7 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare për mbrojtjen e sinjalizuesve, miratuar më 30 prill 2014.

Kapitulli 9

Liria e shprehjes dhe teknologjitë e reja

9.1. Mbikëqyrja elektronike

Çështja *Youth Initiative for Human Rights kundër Serbisë*²⁸⁸ kishte të bënte me aksesin tek informacioni i fituar nëpërmjet mbikëqyrjes elektronike nga Agjencia Serbe e Inteligjencës. Kërkuesja, një organizatë joqeveritare (OJQ), ishte ankuar se refuzimi nga agjencia e inteligjencës për t'i dhënë asaj informacionin e kërkuar – kërkesa ishte për informacionin sesa njerëz kishte vënë nën përgjim agjencia në vitin 2005 – e pengonte atë të luante rolin e saj si “rojtari publik”.

Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 10 të Konventës. Ajo konstatoi se mosdashja kryeneçe e agjencisë për t'iu bindur një urdhri final dhe të detyrueshëm për dhënien e informacionit ishte mosbindje ndaj legjislacionit vendas dhe ishte e barabartë me arbitraritet. Duke u mbështetur në nenin 46 (forca detyruese dhe implementimi) të Konventës, gjykata shtoi më tej se rruga më e natyrshme për zbatimin e vendimit të saj në këtë rast ishte sigurimi që agjencia do t'i jepte OJQ-së kërkuesë informacionin që i kishte kërkuar në lidhje me sa njerëz ishin vendosur në mbikëqyrje elektronike në vitin 2005.

Në të ardhmen, gjykata do të duhet t'i përgjigjet pyetjes se deri në çfarë mase i prek gazetarët dhe punën e tyre përdorimi i teknologjive të reja, kryesisht interceptimi i komunikimeve, duke përfshirë internetin. Në çështjen *Bureau of Investigative Journalism dhe Alice Ross kundër Mbretërisë së Bashkuar*²⁸⁹, gjykata do të shqyrtojë sesi ka ndikuar regjimi statutor në lidhje me interceptimin e komunikimeve të jashtme mbi aftësinë e gazetarëve që të ndërmarrin gazetari investigativ pa frikë për sigurinë e komunikimeve të tyre dhe nëse ai përbën rrezik ndaj rolit të rojtarit publik të shtypit.

²⁸⁸ *Youth Initiative for Human Rights kundër Serbisë*, 25 qershor 2013.

²⁸⁹ Aktualisht në shqyrtim, e komunikuar te qeveria e paditur më 5 janar 2015.

9.2. Mendime të përgjithshme për lirinë e shprehjes dhe internetin

Interneti mbetet një fushë e re e komunikimeve për të cilën janë miratuar një numër i kufizuar rregullash në nivel kombëtar ose ndërkombëtar. Për rrjedhojë, gjyqtarët kombëtarë dhe ndërkombëtarë luajnë një rol kryesor në vendosjen e standardeve për mbrojtjen e lirisë së shprehjes në internet. Nga GJEDNJ-ja janë vendosur një numër standardesh.

Në çështjen *Editorial Board of Pravoye Delo and Shtekel kundër Ukrainës*²⁹⁰, gjykata pranoi për herë të parë se neni 10 i Konventës duhet të interpretohet se i vendos shteteve një detyrim pozitiv për krijimin e një kuadri rregullator të përshtatshëm për garantimin e mbrojtjes efektive të lirisë së shprehjes së gazetarëve në internet. Legjislacioni ukrainas dhe konkretisht ligji për shtypin, i jep gazetarëve imunitet nga përgjegjësia civile për prodhimin fjalë për fjalë të materialit të botuar në shtyp. Gjykata theksoi se:

kjo dispozitë përgjithësisht përputhet me qasjen e saj ndaj lirisë së gazetarëve për të shpërndarë deklaratat e bëra nga të tjerët.

Megjithatë, sipas gjykatave vendase, nuk ekzistonte asnjë imunitet i tillë për gazetarët që riprodhonin material nga burimet në internet të paregjistruara në përputhje me ligjin për shtypin. Në këtë drejtim, gjykata vëren se nuk ka ekzistuar asnjë rregull kombëtar nga shteti për rregullimin e medieve në internet dhe se, sipas qeverisë, ligji për shtypin dhe akte të tjera normative që rregullojnë marrëdhëniet e medias në Ukrainë nuk përmbajnë dispozita për statusin e medieve në internet ose përdorimin e informacionit të marrë nga interneti.

Gjykata theksoi:

se mungesa e një kuadri ligjor të mjaftueshëm në nivel kombëtar që i lejon gazetarëve të përdorin informacionin e marrë nga interneti pa frikën e pësimit të sanksioneve pengon seriozisht ushtrimin e funksionit jetik të shtypit si “rojtat publik”...Në pikëpamjet e gjykatës, përjashtimi i plotë i një informacioni të tillë nga fusha e zbatimit të garancive legjislative të lirisë së gazetarëve mund të sjellë vetë një ndërhyrje të pajustificuar në lirinë e shtypit sipas nenit 10 të Konventës.

Që atëherë, për publikimet online gjykata ka zbatuar parimet e përgjithshme që rrjedhin nga praktika gjyqësore për nenin 10²⁹¹.

²⁹⁰ *Editorial Board of Pravoye Delo dhe Shtekel kundër Ukrainës*, 5 maj 2011, paragrafët 61-64.

²⁹¹ Për shembull, në *Renaud kundër Francës*, 25 shkurt 2010 (vendim).

9.3. Bllokimi i aksesit

Aksesi në internet është pranuar si një nga të drejtat individuale në kuadër të nenit 10. Vendimi i parë i gjykatës kishte të bënte me bllokimin e aksesit në dy faqe interneti sepse kishin transmetuar muzikë pa respektuar ligjin për të drejtat e autorit. Kërkuesi, z. *Yaman Akdeniz*, kishte aplikuar në gjykatë si përdorues i faqeve të internetit në fjalë, duke u ankuar në veçanti për shkelje të lirisë së tij të shprehjes²⁹². Gjykata e shpalli aplikimin të papranueshëm (*ratione personae* i papajtuësëm), duke argumentuar se kërkuesi nuk mund të pretendonte të ishte “viktimmë” në kuptim të nenit 34 (e drejta e kërkesës individuale) të Konventës. Megjithëse theksonte se të drejtat e përdoruesve të internetit janë me rëndësi kryesore, gjithsesi gjykata vërejti se dy faqet e internetit që transmetonin muzikë ishin bllokuar sepse kishin vepruar në shkelje të ligjit për të drejtën e autorit. Si përdorues i këtyre faqeve, kërkuesi kishte përfitur nga shërbimet e tyre dhe ishte privuar vetëm nga një prej mënyrave të dëgjimit të muzikës ndër shumë të tjera. Gjykata më tej çmoi se kërkuesi kishte pasur në dispozicion për akses një sërë veprash muzikore pa shkelur rregullat që respektonin të drejtën e autorit.

Gjykata përdori një qasje tjetër në çështjen *Yıldırım kundër Turqisë*, ku i gjithë domeni i faqeve të kompanisë *Google* ishte bllokuar në Turqi për shkak të një faqeje të vetme që kishte përmbajtje të pretenduar fyese ndaj kujtimit të Ataturkut²⁹³. Urdhri i bllokimit të faqeve të internetit të *Google* prekte direkt aksesin e z. *Yıldırım* në faqen e tij. Gjykata pranoi se kjo nuk ishte një ndalim i përgjithshëm, por vetëm një kufizim i aksesit në internet. Megjithatë, efekti i kufizuar i kufizimit nuk e reduktonte rëndësinë e tij, veçanërisht sepse interneti ishte bërë një nga mjetet kryesore të ushtrimit të së drejtës së lirisë së shprehjes dhe informacionit. Për rrjedhojë, masa në fjalë përbënte ndërhyrje nga autoritetet publike në të drejtën e kërkuesit për lirinë e shprehjes. Gjykata përsëriti se kufizimi i aksesit në një burim informacioni nuk ishte në pajtim me Konventën nëse kemi një kuadër ligjor strikt që rregullon fushëzbatimin e ndalimit dhe ofron garancinë e kontrollit gjyqësor për parandalimin e abuzimeve të mundshme. Ligji turk u çmua të mos ishte “i parashikueshëm” në zbatimin e tij, sepse nuk ishte formuluar me saktësi të mjaftueshme për t’i mundësuar individëve të rregullonin sjelljen e tyre. Në bazë të ligjit, një gjykatë turke mund të urdhëronte bllokimin e aksesit në një përmbajtje të publikuar në internet nëse kishte arsye të mjaftueshme për të dyshuar se përmbajtja mund të sillte kryerjen e një vepre penale. Megjithatë, as faqet *Google* e as faqja në internet e z. *Yıldırım* nuk ishin subjekt i procedimit gjyqësor në këtë rast. Megjithëse vendimi i 24

²⁹² *Akdeniz kundër Turqisë*, 11 mars 2014 (vendim).

²⁹³ *Ahmet Yıldırım kundër Turqisë*, 18 dhjetor 2012.

qershorit 2009 kishte vendosur se *Google* ishte përgjegjëse për faqen e internetit që mbante, në ligj nuk kishte asnjë parashikim për bllokimin e të gjithë aksesit siç ishte urdhëruar nga gjykata. Rrjedhimisht, efektet e masës në fjalë kishin qenë arbitrare dhe kontrolli gjyqësor i bllokimit të aksesit kishte qenë i pamjaftueshëm për parandalimin e abuzimeve.

Gjykata përdori një qasje të ndryshme në çështjen e sjellë nga zotërinjtë *Serkan Cengiz, Yaman Akdeniz dhe Kerem Altıparmak*, profesorë të universiteteve në të gjithë Turqinë²⁹⁴. Në maj të vitit 2008, qeveria turke kishte bllokuar të gjithë aksesin në faqen e videove *YouTube*. Bllokimi u justifikua me një ligj që ndalonte “fyerjen e kujtimit të Ataturkut”. Faqja *YouTube* përmbante rreth dhjetë video, të cilat u konsideruan fyese për Ataturkun nga gjykatat vendase që kishin lëshuar urdhrin e bllokimit. Ndalimi mbeti në fuqi nga 5 maji 2008 deri më 30 tetor 2010, kur urdhri u hoq nga prokuroria. Kërkuesit kishin kërkuar pa sukses heqjen e ndalimit në sistemin gjyqësor vendas, duke cituar lirinë e marrjes dhe dhënies së informacionit, si dhe interesin publik në aksesin e informacionit në një faqe si *YouTube*. Gjykata përdori pikëpamjen se kjo çështje ndryshonte nga çështja *Akdeniz kundër Turqisë*, sepse në këtë rast ndalimi i *YouTube* bënte të paaksesueshme një platformë popullore për diskutim politik, që shfaqte informacion konkret që nuk mund të aksesohet lehtësisht me mjete të tjera, ndërsa në çështjen *Akdeniz* gjykata kishte treguar mjete alternative për aksesin e muzikës përballë një ndalimi përkatës²⁹⁵. Megjithëse bllokimi i *YouTube-it* nuk kishte shënjestruar direkt kërkuesit, ndalimi kishte prekur të drejtën e tyre për marrjen dhe dhënien e informacionit e mendimeve. Për rrjedhojë, gjykata çmoi se ndalimi përbënte një ndërhyrje në të drejtën e kërkuesve për lirinë e shprehjes. Kjo ndërhyrje ishte e pajustificuar, sepse ligji sipas të cilit ishte autorizuar ndalimi lejonte vetëm ndalimin e publikimeve specifike në rast se dyshohej kryerja e një veprë të paligjshme. Një ndalim i përgjithshëm i një faqeje të tërë interneti, si në rastin konkret, nuk parashikohej me ligj dhe rrjedhimisht nuk ishte i ligjshëm.

9.4. E drejta e aksesit në internet

Në rrethana të posaçme, gjykata u kishte dhënë të burgosurve akses në internet. Në çështjen *Kalda kundër Estonisë* një i burgosur ishte ankuar se autoritetet kishin refuzuar t'i jepnin atij akses në tri faqe në internet, që përmbanin informacion ligjor, të operuara nga shteti dhe nga Këshilli i Europës²⁹⁶. Kërkuesi u ankua konkretisht se ndalimi sipas ligjit estonez i aksesit në këto faqe specifike kishte shkelur të drejtën e tij për marrjen e infor-

²⁹⁴ *Cengiz dhe të Tjerë kundër Turqisë*, 1 dhjetor 2015.

²⁹⁵ Paragrafi 51.

²⁹⁶ *Kalda kundër Estonisë*, 19 janar 2016.

macionit nëpërmjet internetit dhe rrjedhimisht e pengonte atë të kryente kërkimet ligjore për procedimin gjyqësor ku ishte përfshirë. Gjykata argumentoi se kishte pasur shkelje të nenit 10 të Konventës. Ajo konstatoi në veçanti se shtetet kontraktore nuk janë të detyruara t'u japin të burgosurve akses në internet. Megjithatë, nëse një shtet është i gatshëm t'u lejojë të burgosurve akses, si në rastin e Estonisë, shteti duhet të japë arsytet për refuzimin e aksesit në faqe interneti të caktuara. Në rrethanat konkrete të çështjes së kërkuesit, arsytet dhe pikërisht implikimet e sigurisë dhe kostos, për moslejimin e aksesit në faqet e internetit në fjalë, nuk kishin qenë të mjaftueshme për justifikimin e ndërhyrjes në të drejtën e marrjes së informacionit. Pikërisht, autoritetet kishin marrë masa për përdorimin e internetit nga të burgosurit nëpërmjet kompjuterave të përshtatur posaçërisht për atë qëllim dhe nën mbikëqyrjen e autoriteteve të burgut, si dhe kishin përballuar kostot përkatëse. Gjykatat vendase nuk kishin bërë asnjë analizë të detajuar për rreziqet e mundshme të sigurisë së aksesit në tri faqet e internetit në fjalë, duke pasur parasysh se ato viheshin në funksionim nga një organizatë ndërkombëtare dhe nga vetë shteti.

9.5. Arkivat në internet

Interneti luan një rol të rëndësishëm në përmirësimin e aksesit të publikut te lajmet dhe lehtësimin e përhapjes së informacionit në përgjithësi. Materialet e disponueshme në internet mbeten aty dhe është shumë e vështirë t'i heqësh. Gjykatës i ishte dashur të vendoste për përgjegjësinë e publikuesve për arkivat në internet, veçanërisht nëse përmbanin materiale që çonin në shkelje të së drejtës së reputacionit. Në çështjen *Times Newspapers Ltd kundër Mbretërisë së Bashkuar (Nr.1 dhe 2)*²⁹⁷, gjykata vendosi se nëse një gazetë e humb çështjen e saj gjyqësore për shpifje për një artikull që mbetet në arkivat e saj, ajo duhet të shtojë një shënim të përshtatshëm në versionin e artikullit në internet, ku të thuhet se artikulli i ishte nënshtruar procedimit ligjor për shpifje. Shtypi ka një rol të vlefshëm në ruajtjen e arkivave dhe periudha e kufizimit në paditë për shpifje synon të garantojë që pretenduesit të veprojnë shpejt. Megjithatë, në këtë rast, gjykata kombëtare nuk kishte sugjeruar heqje tërësisht të artikujve dhe detyrimi për të vendosur një shënim në materialin e arkivuar kur gazeta është njoftuar se një padi për shpifje ka filluar në lidhje me atë artikull, nuk është ndërhyrje disproporcionale në kuadër të nenit 10. Bazuar në faktet, nuk lindi çështja e përgjegjësisë së pandërprerë, por procedimi për shpifje, i filluar kundër gazetës pas kalimit të një kohe të konsiderueshme, në mungesë të rrethanave përjashtimore, shkakton një ndërhyrje disproporcionale në lirinë e shtypit sipas nenit 10.

Një çështje tjetër e lidhur me arkivat në internet u shqyrtua nga gjykata nën perspektivën e nenit 8 të Konventës dhe ajo ofron udhëzime për përgjegjësinë

²⁹⁷ *Times Newspapers Ltd kundër Mbretërisë së Bashkuar (Nr. 1 dhe 2)*, 10 mars 2009.

e botuesve. Dy avokatë, z. *Węgrzynowski* dhe z. *Smolczewski*, kërkuar nga gjykatat kombëtare fshirjen e artikujve që i kishin konsideruar të ishin shpifje. Gjykata theksoi se as gjykatat kombëtare e as media nuk e kanë, e as nuk mund ta kishin pasur, detyrën e rishkrimit të historisë duke fshirë artikujt ose përmbajtjen e tyre të botuar nga interneti, edhe sikur ajo përmbajtje të shkelte të drejtat e dikujt. Gjykata konstatoi se arkivat në internet mbrohen nga liria e shprehjes brenda kuptimit të nenit 10²⁹⁸. Arkivat në internet japin një kontribut të konsiderueshëm në ruajtjen dhe bërjen të disponueshme të lajmeve dhe informacionit. Arkiva të tilla janë burim i rëndësishëm për arsimin dhe kërkimet, veçanërisht duke pasur parasysh faktin se janë lehtësisht të disponueshme për publikun dhe përgjithësisht falas. Megjithëse detyra kryesore e medias në një demokraci është të veprojë si “rojtari publik”, ajo ka edhe një funksion dytësor, atë të ruajtjes së artikujve të lajmeve të hapura për publikun. Mirëmbajtja e arkivave në internet është një aspekt shumë i rëndësishëm i atij funksioni. Për rrjedhojë, nuk është në disproporcion në vetvete të urdhërohet një media, që njëkohësisht administron një arkiv në internet, të publikojë një referencë ose korrigjim të përshtatshëm për çështjen e internetit nëse një referencë ose korrigjim i tillë lidhet me artikullin e botuar. Si rezultat, në lidhje me këtë mosmarrëveshje gjykata theksoi gjithashtu se do të kishte qenë e rëndësishme që artikulli të plotësohej me një referencë në vendimin e gjykatës.

Gjykata i ka lënë një hapësirë të gjerë vlerësimi autoriteteve në rast të shkeljeve të të drejtave të njeriut në internet. Në çështjen *Ashby Donald dhe të Tjerë kundër Francës*, dy fotografë të shfaqjeve të modës u dënuan për shkelje të të drejtave të autorit pas publikimit në faqen e internetit të një kompanie mode të drejtuar nga dy kërkuesit, pa autorizimin e shtëpive të modës, të fotove të bëra nga dy kërkuesit në eventet e modës në vitin 2003. Gjykata vendosi se nuk kishte shkelje të nenit 10²⁹⁹. Në rrethanat e çështjes dhe duke iu referuar hapësirës veçanërisht të gjerë të vlerësimit të lënë hapur për autoritetet vendase, natyra dhe graviteti i dënimeve të dhëna për kërkuesit nuk ishin të tilla që gjykata të vendoste se ndërhyrja në fjalë ishte në disproporcion me qëllimin e synuar.

9.6. Përgjegjësia për përmbajtjen e gjeneruar nga përdoruesit

Gjykatës iu desh të shqyrtonte problemin e përgjegjësisë për komentet e prodhuara nga përdoruesit në një portal lajmesh në internet. Në çështjen *Delfi AS kundër Estonisë*³⁰⁰, *Delfi AS*, një shoqëri që drejton një portal lajmesh në internet

²⁹⁸ *Węgrzynowski dhe Smolczewski kundër Polonisë*, 16 gusht 2013.

²⁹⁹ *Ashby Donald dhe të Tjerë kundër Francës*, 10 janar 2013.

³⁰⁰ *Delfi kundër Estonisë*, 16 qershor 2015 (GC).

për qëllime komerciale, u ankua se ishte bërë përgjegjëse nga gjykata kombëtare për komentet fyese të postuara nga lexuesit e saj pas artikullit të lajmeve online për një shoqëri tragetesh. Me kërkesë të avokatëve të pronarit të shoqërisë së trageteve, shoqëria kërkuese i hoqi komentet fyese për rreth gjashtë javë pas publikimit të tyre. Gjykata vendosi se nuk kishte pasur asnjë shkelje të nenit 10, duke çmuar se bërja përgjegjëse nga gjykatat estoneze e shoqërisë kërkuese kishte qenë një kufizim i justifikuar dhe proporcional i lirisë së shprehjes, veçanërisht sepse: komentet në fjalë kishin qenë ekstreme (anti-semit) dhe ishin postuar në reagim ndaj një artikulli të publikuar nga një kërkues në portalin e lajmeve të drejtuar profesionalisht për qëllime tregtare; hapat e hedhur nga kërkuesi për heqjen e komenteve fyese pa vonesë pas publikimit të tyre kishin qenë të pamjaftueshme; dhe gjoba prej 320 eurosh nuk kishte qenë aspak e tepërt për kërkuesin, një prej portaleve më të mëdha të internetit në Estoni. Një argument i rëndësishëm i gjykatës lidhej me faktin se shoqëria kërkuese fitonte të ardhura nga aktiviteti i saj në internet.

Gjykata arriti në një konkluzion të ndryshëm në një çështje që ka të bëjë me përgjegjësinë e një autoriteti vetë-rregullator të shërbim ofruesve të materialeve në internet dhe një portali lajmesh online për komente fyese dhe vulgare të postuara në faqet e tyre të internetit pas publikimit të një opinioni që kritikonte praktikën ç'orientuese të biznesit të faqeve të internetit për pronat e paluajtshme³⁰¹. Kërkuesit u ankuan për vendimet e gjykatave hungareze kundër tyre, që i kishte detyruar efektivisht ata të moderonin përmbajtjen e komenteve të bëra nga lexuesit në portalet e tyre, duke argumentuar se vendimet ishin kundër thelbit të shprehjes së lirë në internet. Në këtë rast, gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 10. Ajo përsëriti në veçanti se, megjithëse jo botues të komenteve në kuptimin tradicional, gjithsesi portalet e lajmeve në internet duhet të merrnin detyra dhe përgjegjësi. Megjithatë, gjykata çmoi se gjykatat hungareze, kur morën vendimin për nocionin e përgjegjësisë në rastin e kërkuesve, nuk kishin bërë një balancim të duhur ndërmjet të drejtave të përfshira në konflikt, pikërisht ndërmjet të drejtës së kërkuesve për lirinë e shprehjes dhe të drejtën e faqeve të internetit të pronave të paluajtshme për respektimin e reputacionit tregtar të tyre. Konkretisht, autoritetet hungareze kishin pranuar se komentet kishin qenë të paligjshme dhe të dëmshme për reputacionin e faqeve të internetit të pronave të paluajtshme. Në kontrast me çështjen *Delfi*, gjykata konstatoi se komentet nuk përmbanin fjalë urrejtjeje dhe se ofruesit e shërbimeve në internet nuk e ushtronin aktivitetin për qëllime fitimi.

³⁰¹ *Magyar Tartalomsgálgtatók Egyesülete dhe Index.hu Zrt kundër Hungarisë*, 2 shkurt 2016.

Nevoja për garantimin e lirisë në internet është theksuar në rekomandimin e Komitetit të Ministrave për lirinë në internet³⁰². Komiteti i Ministrave ka miratuar gjithashtu edhe një numër dokumentesh që lidhen me neutralitetin në rrjet³⁰³, rrjedhën ndërkufitare të informacionit³⁰⁴, udhëzime për të drejtat e njeriut për motorët e kërkimit³⁰⁵, përdoruesit e internetit³⁰⁶ dhe përmbajtjen e prodhuar nga përdoruesit³⁰⁷.

³⁰² Rekomandimi CM/Rec (2016) 5 i Komitetit të Ministrave për shtetet për lirinë në internet, miratuar më 13 prill 2016 në takimin e 1253-të të zëvendësministrave.

³⁰³ Rekomandimi CM/Rec(2016)1 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për mbrojtjen dhe promovimin e lirisë së shprehjes dhe të drejtën e jetës private përsa i takon neutralitetit në rrjet, miratuar më 13 janar 2016 në takimin e 1244-të të zëvendësministrave.

³⁰⁴ Rekomandimi CM/Rec(2015)6 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për qarkullimin ndërkufitar të lirë të informacionit në internet, miratuar më 1 prill 2015 në takimin e 1224-të të zëvendësministrave.

³⁰⁵ Rekomandimi CM/Rec(2012)3 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në motorët e kërkimit, miratuar më 4 prill 2012 në takimin e 1139-të të zëvendësministrave.

³⁰⁶ Rekomandimi CM/Rec(2014)6 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për një Guidë të të drejtave të njeriut për përdoruesit e internetit, miratuar më 16 prill 2014 në takimin e 1197-të të zëvendësministrave.

³⁰⁷ Instituti zviceran i të Drejtës Krahasuese, studim Krahasues për bllokimin, filtrimin dhe eliminimin e përmbajtjes së paligjshme në internet: Konsiderata krahasuese, Lozanë, 20 dhjetor 2015.

Indeksi i çështjeve

Çështjet citohen me datën e vendimit përfundimtar ose, sipas rastit, të vendimit për pranimin e aplikimit. Kur të dyja vendimet janë të përmendura në tekst, secila datë shfaqet në hyrje të indeksit.

Për informacion të mëtejshëm, ju lutem shihni databazën HUDOCOnline, <http://hudoc.echr.coe.int/>.

A

Adali kundër Turqisë, 31 mars 2005 92
Ahmet Yıldırım kundër Turqisë, 18 dhjetor 2012 109
Akdaş kundër Turqisë, 16 shkurt 2010 18
Akdeniz kundër Turqisë, 11 mars 2014 (vendim) 109, 110
Alvesda Silva kundër Portugalisë, 20 tetor 2009 18
Animal Defenders International kundër Mbretërisë së Bashkuar,
22 prill 2013 (GC) 37, 88
Annen kundër Gjermanisë, 26 nëntor 2015 28
Arslan kundër Turqisë 76, 77
Ashby Donald dhe të Tjerë kundër Francës, 10 janar 2013 112
Autronic AG kundër Zvicrës, 22 maj 1990 15, 34, 39, 94
Axel Springer AG kundër Gjermanisë, 7 shkurt 2012 63

B

Barfod kundër Danimarkës, 22 shkurt 1989 34
Barthold kundër Gjermanisë, 25 mars 1985 37, 81
Bergens Tidende dhe të Tjerë kundër Norvegjisë, 2 maj 2000 98
Błaja News Sp.zo.o. kundër Polonisë, 26 nëntor 2013 68
Brambilla dhe të Tjerë kundër Italisë, 23 qershor 2016 99, 100
Braun kundër Polonisë, 4 nëntor 2014 80
Bucur dhe Toma kundër Rumanisë, 8 janar 2013 102

C

Casado Coca kundër Spanjës, 24 shkurt 1994 14, 37

Castells kundër Spanjës, 23 prill 1992 11, 36, 68, 69, 88

Cengiz dhe të Tjerë kundër Turqisë, 1 dhjetor 2015 110

Ceylan kundër Turqisë, 8 korrik 1999 (GC) 80

Chorherr kundër Austrisë, 25 gusht 1993 17

Colombani dhe të Tjerë kundër Francës, 25 qershor 2002 66

Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés kundër Francës,

10 nëntor 2015 77

D

D.D. kundër Turqisë, 2 shtator 1998 92

D.I. kundër Gjermanisë, 26 qershor 1996 28

Dalban kundër Rumanisë, 28 shtator 1999 (GC) 34, 76, 78, 79

De Haes dhe Gijssels kundër Belgjikës, 24 shkurt 1997 74, 76

Delfi kundër Estonisë, 10 tetor 2013 dhe 16 qershor 2015 (GC) 113, 114

Dichand dhe të Tjerë kundër Austrisë, 26 shkurt 2002 11,14,18,76,78

Dink kundër Turqisë, 14 shtator 2010 91

Długołęcki kundër Polonisë, 24 shkurt 2009 33, 81

Donaldson kundër Mbretërisë së Bashkuar, 25 janar 2011 (vendim) 17

Dubowska dhe Skup kundër Polonisë, 18 prill 1997 (vendim) 89

E

Editorial Board of Pravoye Delo dhe Shtekel kundër Ukrainës,

5 maj 2011 108

Engel dhe të Tjerë kundër Holandës, 8 qershor 1976 19, 20

Eon kundër Francës, 14 mars 2013 18, 66

F

Feldek kundër Sllovakisë, 12 korrik 2001 79

Frankowicz kundër Polonisë, 16 dhjetor 2008 34, 36

Fressoz dhe Roire kundër Francës, 21 janar 1999 98

Fuentes Bobo kundër Spanjës, 29 shkurt 2000 92,93

G

Gafus kundër Polonisë, 15 nëntor 2011 (vendim) 89
Garaudy kundër Francës, 24 qershor 2003 (vendim) 12
Gaskin kundër Mbretërisë së Bashkuar, 7 korrik 1989 15
Gawęda kundër Polonisë, Raport i Komisionit, 4 dhjetor 1998
dhe vendimi i 14 marsit 2002 32,35,36,40,41
Gillberg kundër Suedisë, 3 prill 2012 17
Glas Nadezhda EOOD dhe Elenkov kundër Bullgarisë,
11 tetor 2007 95
Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar,
27 mars 1996 (GC) 34, 38, 76, 100, 101
Groppera Radio AG dhe të Tjerë kundër Zvicrës,
28 mars 1990 14, 18, 39, 94
Guja kundër Moldovës, 12 shkurt 2008 (GC) 103

H

Hadjianastassiou kundër Greqisë, 16 dhjetor 1999 19, 20, 53
Haldimann dhe të Tjerë kundër Zvicrës, 24 shkurt 2015 99
Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, 7 dhjetor 1976 14, 18, 34,
36, 59, 60, 76
Heinisch kundër Gjermanisë, 21 korrik 2011 103
Honsik kundër Austrisë, 18 tetor 1995 (vendim) 28
Huseynov kundër Azerbajxhanit, 7 maj 2015 90

I

I.A. kundër Turqisë, 13 shtator 2005 60
Informationaverein Lentia kundër Austrisë, 24 nëntor 1993 96

J

Janowski kundër Polonisë, 21 janar 1999 44
Jersild kundër Danimarkës, 23 shtator 1994 (GC) 26, 27, 76, 90
Jerusalemi kundër Austrisë, 27 shkurt 2001 78

K

K. kundër Austrisë, 13 tetor 1992 (raport i Komisionit) 18

Kalda kundër Estonisë, 19 janar 2016 110

Karataş kundër Turqisë, 8 korrik 1999 18, 25

Kenedi kundër Hungarisë, 26 maj 200 15, 16, 17

Khurshid Mustafa dhe Tarzibachi kundër Suedisë, 16 dhjetor
2008 17

Krone Verlag GmbH&Co.KG kundër Austrisë (Nr.3), 11 dhjetor
2003 14

Krone Verlag GmbH kundër Austrisë, vendim i 19 qershorit
2012 72

Kühnen kundër Republikës Federale të Gjermanisë,
12 maj 1988 (vendim) 26, 55

Kuliś dhe Rózycki kundër Polonisë, 6 tetor 2009 18, 71, 79

*Kurier Zeitungsverlag und Druckerei GmbH kundër Austrisë
(Nr. 2)*, 19 qershor 2012 72

Kurłowicz kundër Polonisë, 22 qershor 2010 89

Kurski kundër Polonisë, 5 korrik 2016 82

Kwieceń kundër Polonisë, 9 janar 2007 76

L

Leander kundër Suedisë, 26 mars 1987 15, 42

Leroy kundër Francës, 2 tetor 2008 24

Lewandowska-Malec kundër Polonisë, 18 shtator 2012 81

Lingens kundër Austrisë, 8 korrik 1986 11, 14, 34,
44, 64, 66, 79, 81, 87

Lopes Gomesda Silva kundër Portugalisë, 28 shtator 2000 77, 79

Łozowska kundër Polonisë, 13 janar 2015 68

M

Maciejewski kundër Polonisë, 13 janar 2015 75
Magyar Tartalomszolgáltatók Egyesülete and Index.hu Zrt kundër Hungarisë, 2 shkurt 2016 113
Mahmudov dhe Agazade kundër Azerbajxhanit, 18 dhjetor 2008 80, 81
Malone kundër Mbretërisë së Bashkuar, 2 gusht 1984 41
Manole dhe të Tjerë kundër Moldovës, 17 shtator 2009 97
Marktintern Verlag Gmb Hand Klaus Beermann kundër Gjermanisë, 20 nëntor 1989 14, 38,96
Marônek kundër Sllovakisë, 19 prill 2001 11, 14, 89
Matúz kundër Hungarisë, 21 tetor 2014 104
Meltex Ltd dhe Mesrop Movsesyan kundër Armenisë, 17 qershor 2008 94, 95
Morice kundër Francës, 23 prill 2015 73, 74
Müller dhe të Tjerë kundër Zvicrës, 24 maj 1998 14, 17, 18, 34, 36, 58, 59

N

Nagla kundër Letonisë, 16 korrik 2013 101
Najafli kundër Azerbajxhanit, 2 tetor 2012 90, 92
News Verlags GmbH& Co.KG kundër Austrisë, 11 janar 2000 34
Nikula kundër Finlandës, 21 mars 2002 18, 73
Norwood kundër Mbretërisë së Bashkuar, 16 nëntor 2004 (vendim) 25

O

Oberschlick kundër Austrisë, 23 maj 1991 18
Oberschlick kundër Austrisë (Nr. 2), 1 korrik 1997 77, 79
Observer dhe Guardian kundër Mbretërisë së Bashkuar, 26 nëntor 1991 33, 34, 35, 44, 47, 48, 51, 98
Ochensberger kundër Austrisë, 2 shtator 1994 (vendim) 28
Open Door dhe Dublin Well Woman kundër Irlandës, 29 tetor 1992 61, 81

Österreichische Vereinigung zur Erhaltung, Stärkung und Schaffung kundër Austrisë, 28 nëntor 2013 15
Otegi Mondragon kundër Spanjës, 15 mars 2011 65
Otto-Preminger-Institut kundër Austrisë, 20 shtator 1994 18, 36, 83
Özgür Gündem kundër Turqisë, 16 mars 2000 55, 89, 91, 92

P

Palomo Sánchez dhe të Tjerë kundër Spanjës,
12 shtator 2011 (GC) 93
Pentikäinen kundër Finlandës, 20 tetor 2015 (GC) 99
Perinçek kundër Zvicrës, 15 tetor 2015 29
Peruzzi kundër Italisë, 30 qershor 2015, paragraf 59 74
PETA Deutschland kundër Gjermanisë, 8 nëntor 201 27
Petra kundër Rumanisë, 23 shtator 1998 40
Prager dhe Oberschlick kundër Austrisë, 26 prill 1995 11, 76

R

Renaud kundër Francës, 25 shkurt 2010 (vendim) 108
Romanenko dhe të Tjerë kundër Ruisë, 8 tetor 2009 70
Roman Zakharov kundër Ruisë, 4 dhjetor 2015 (GC) 41
Rommelfanger kundër Republikës Federale të Gjermanisë,
6 shtator 1989 (vendim)20
Roşianu kundër Rumanisë, 24 qershor 2014 16, 17
Rotaru kundër Rumanisë, 4 maj 2000 40
RTBF kundër Belgjikës, 29 mars 2011 35

S

Sanocki kundër Polonisë, 17 korrik 2007 66
Sanoma Uitgevers B.V kundër Holandës,
14 shtator 2010 (GC) 39, 101
Saszmann kundër Austrisë, 27 shkurt 1997 (vendim) 57
Sdružení Jihočeské Matky kundër Republikës Çeke,
10 korrik 2006 17

Şener kundër Turqisë, 18 korrik 2000 11, 14, 89, 98
Skalka kundër Polonisë, 27 maj 2003 80
Société Prisma Press kundër Francës, 1 korrik 2003 (vendim) 77
Sokołowski kundër Polonisë, 29 mars 2005 66
Sosinowska kundër Polonisë, 18 tetor 2011 36
Stankiewicz dhe të Tjerë kundër Polonisë, 14 tetor 2014 80
Steel dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar,
 23 shtator 1998 17
Stevens kundër Mbretërisë së Bashkuar,
 9 shtator 1989 (vendim) 17
Stoll kundër Zvicrës, 10 dhjetor 2007 (GC) 51, 52
Sürek dhe Özdemir kundër Turqisë, 8 korrik 1999 (GC) 54, 89
Sürek kundër Turqisë (Nr. 1), 8 korrik 1999 23
Sürek kundër Turqisë (Nr.3), 8 korrik 1999 (GC) 23, 55
Sürek kundër Turqisë (Nr.4), 8 korrik 1999 (GC) 24, 25

T

Tammer kundër Estonisë, 6 shkurt 2001 44
Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë,
 14 prill 2009 15
Tekin kundër Turqisë, 9 qershor 1998 92
Tele 1 Privatfernsehgesellschaft mbH kundër Austrisë,
 21 shtator 2000 94
Tepe kundër Turqisë, 9 qershor 2003 92
The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar, 18 maj 1977,
 raport i Komisionit 33
The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar,
 26 prill 1979
 32, 39, 40
The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar (Nr. 2),
 26 nëntor 1991 34, 35,80
Thoma kundër Luksemburgut, 29 mars 2001 11,14,18,67,68,90
Thorgeir Thorgeirson kundër Islandës, 25 qershor 1992 66,76,88,89
Times Newspapers Ltd kundër Mbretërisë së Bashkuar (Nr.1 dhe 2),

10 mars 2009 111

Tolstoy Miloslavsky kundër Mbretërisë së Bashkuar,

13 korrik 1995 33, 82

Tuşalp kundër Turqisë, 21 shkurt 2012 66

TV Vest AS & Rogal and Pensjonist parti kundër Norvegjisë,

11 dhjetor 2008 37

U

Uj kundër Hungarisë, 19 korrik 2011 66, 76

V

Vajnai kundër Hungarisë, 8 korrik 2008 17

Vejdeland dhe të Tjerë kundër Suedisë, 9 shkurt 2012 25

*Vereingegen Tierfabriken Schweiz (VgT) kundër Zvicrës (Nr.2),
30 qershor 2009 97*

Verein gegen Tierfabriken kundër Zvicrës, 28 qershor 2001 96

Vereinigung Bildender Künstler kundër Austrisë, 25 janar 2007 18, 59

*Vereinigung demokratischer Soldaten Österreichs dhe Gubi kundër Austrisë,
19 dhjetor 1994 20, 57,58*

Vereniging Weekblad Bluf! kundër Holandës, 9 shkurt 1995 49, 50

Vogt kundër Gjermanisë, 26 shtator 1995 13, 20, 21

Von Hannover kundër Gjermanisë, 24 qershor 2004 64

W

Weber dhe Saravia kundër Gjermanisë, 29 qershor 2006 (vendim) 102

Węgrzynowski dhe Smolczewski kundër Polonisë, 16 gusht 2013 112

Wille kundër Lihtenshtejnit, 28 tetor 1999 21, 35

*Wingrove kundër Mbretërisë së Bashkuar, raport i Komisionit i miratuar
më 10 janar 1995, vendim i 25 nëntorit 1996 59,60*

Wizerkaniuk kundër Polonisë, 5 korrik 2011 35

Wojtas-Kaleta kundër Polonisë, 16 korrik 2009 34

Y

Youth Initiative for Human Rights kundër Serbisë,

25 qershor 2013 15, 107

Ky manual, i prodhuar nga Divizioni i Zbatimit Kombëtar të Drejtave të Njeriut i Drejtorisë së Përgjithshme të Drejtave të Njeriut dhe Shtetit të së Drejtës, është një mjet praktik për profesionistët e së drejtës nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës, që dëshirojnë të forcojnë aftësitë e tyre për zbatimin e Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut dhe jurisprudencës së Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut në punën e tyre të përditshme.

Jeni të interesuar për të mësuar më shumë në lidhje me të drejtat e njeriut? Jeni të lutur të vizitoni faqen e internetit të Programit Europian për të Drejtat e Njeriut Edukimi Ligjor për Profesionistët e së Drejtës (HELP):

www.coe.int/help

Për më shumë informacion për Lirinë e Shprehjes dhe KEDNJ-në, shihni kurset e HELP online:

<http://www.coe.int/en/web/help/help-training-platform>

<https://www.coe.int/en/web/national-implementation>

SQI: 9001 - 2015

www.coe.int

Këshilli i Europës është organizata kryesore për të drejtat e njeriut në kontinent. Ajo përfshin 47 shtete anëtare, 28 prej të cilave janë anëtare të Bashkimit Europian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Europës e kanë nënshkruar Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i hartuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

Reinforcing Judicial Expertise on Freedom of Expression and the Media in South-East Europe (JUFREX)

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe